

LINDEN SPASSE

BIBLIOTEKA

E

85H-32-4

SHTETIT

S 81

GJIROKASTER

# CUCA E PAVIONIT

(TREGIME DHE SKICA)

8SH-32-4

ILINDEN SPASSE

5.81

8SH-32-4

S

# CUCA E PAVIONIT

(Tregime dhe skica.)

2352 ~~83177~~



## NJË LAPIDAR PRANË PIRAMIDËS

Nën hapat e rënda të çizmeve të tyre, kërciste dëbora gjysëm e ngrirë. Në qafë u rëndonte kashi prej lëkure i automatikëve të varur. Në të majtë të brezit u lëkundeshin bombat e dorës, që u dukeshin si dardha dimërore. Çapitnin me ngadalë në atë çarçaf të bardhë, të pastër e të fshirë aqë mirë nga era si me fshesë të madhe dhe të padukëshme, duke lënë nga prapa gjurmë e thella të tabanëve të çizmeve. Por nuk qëndronin shumë e ato gropë të gjurmëve mbusheshin përsëri me flokët e dëndura të dëborës. Disa metra i ndanin nga piramida, nga baza e tyre, që dukej si një sfond i largët në mizërinë e shtëllungave të bardha, që shtjelloheshin nga era e fortë.

Prej së largu dukeshin si tri silueta të mbësh-tjella me pelerina të bardha. Sa lart që ishin njituri! Dhe nga ajo lartësi dukesh një panoramë e bukur dimërore e atyre greminavë të thepisura të malit dhe më poshtë, — lijeni i kredhur i tëri në mjergull.

Veç zhurmës fishkëlluese të murlanit nuk ndihesh asgjë tjetër.

— Sa vënd i bukur! — tha studenti. Ish një djali nga qyteti që posa kish mbaruar institutin dyvjeçar.

— Shumë i bukur! — ja priti mekaniku, edhe ky nga qyteti.

— T'i shikoni këta shkrepa në verë, atëherë me të vërtetë do të mahniteni! — tha djaloshi prej malësie; i cili, me sa dukej ishte në muajt e fundit të shërbimit dhe i njihte me pëllëmbë këto anë.

— Çudi si ndahet kufiri në tokë, me piramida, ndërsa në hartë vetëm me vijë!... — filloi të filozofojë studenti.

Qielli u nxi. Cingërima shtrëngoi. Furtuna filloi...

Gjurmat e lëna nga tabanet e çizmeve të rënda të të tre ushtarëve filluan të zhduken ca më shpejt. Në atë mugëtirë tre shikime luhateshin tej e tej nga piramida e treteshin në disa kthepa të rrezikshme. Duart e tyre shtrëngonin fort armët automatike.

— Pikërisht si sot ka qënë ajo ditë, — vazhdoi malësori — kur unë dola pér të parën herë. Na udhëhiqte një kapter nga Kuçi. Ishte trim i madh, edhe i zgjuar. Kishte sy të mprehtë. Ecja kështu siç jam tashti, flisja pér gjëra të zakonëshme, kur, papandehur, dëgjoj një breshëri automatiku dhe një urdhër: «barkas!» — nuk e di se si u shtriva, po mbaj mënd, që e ndjeva kokën të zhytur brenda në dëborë. Atëhere ndjeva drithmën e parë, edhe turpin e parë. Nuk e vura te aty pér aty se kush qëlloi i pari, pastaj e mora vesh nga shoku pranë, se kapteri ynë kish parë matanë diçka që nxinte. Ndërkaq nga lisi i gjatë u var si një boll e madhe, duke shkundur dëborën nga degët një trup me... fytyrë njeriu. «— Mos lëviz! Lësho armët! Duart lart!» — briti edhe një herë kapteri dhe, duke na urdhëruar që ta ruan-

nim, u derdh vetë e ia lidhi duart shkelësit të kufirit.

— Po tashti ku është ai? — pyeti studenti.

— U vra. Kjo ndodhi disa kohë më vonë. Përsëri ishim bashkë. Këtë radhë na erdhën papa-ndehur disa breshëri prapa krahëve. Dhe gjithë plumbat ranë mbi kapterin. Tashmë unë isha mësuar me të papritura... Ma plagosën dhe shokun pranë....

— Veç kësaj, ju shpëtuan edhe ata? — tha me dëshpërim mekaniku.

— Jo, asnjeri nuk shpëtoi. Ishin pesë veta...

— Po kush i asgjësoi? — pyeti përsëri mekaniku, që nuk u besonte syve, se pikërisht udhëheqësi i tyre ishte ai, që i kishte asgjësuar armiq-të, dhe pastaj kishte zvarrisur shokun e tij të vrarë deri në postë.

Ndërkokë malësori ngriti kokën përpjetë dhe, për të mos u mburrur, ndërroi menjëherë muhabetin.

%

— Sikur filluan të më kërcasin dhëmbët...!  
— ja pat studenti.

— Ama kaq i fortë qënke? — u tall mekaniku.

Malësori futi dorën në xhep, nxori një cigare, e nguli në gojë dhe me shpejtësi të madhe e ndezi me shkrepse.

— Çudi! — tha mekaniku, — sa jam munduar të ndez një cigare kur ka erë dhe s'ja kam arri-tur, kurse ti...

— Èshtë një teknikë e marinareve...

Një furtunë e fortë cingëruese, me sllogje të mëdha dëbore gjysëm të ngrira u përplas në ftyrat e tre të rinjve.

— Mos u trëmbni! — ja pat malësori, — kështu e ka dimëri këtej,... — po pastaj filloi të dyshojë. Kjo furtunë paralajmëronte një diçka më të keqe: një tufan, një ngricë më të madhe, një bllokim!...

— Mo po qoftë me kaqë, por po na erdhi edhe një tjetër, mbarova fare... — ja ndërpren mendimet mekaniku.

Malësori qëndroi në vënd. Ngriti kokën lart, e ktheu anash dhe prapa. Fytyra e tij, e cila s'dallohej mirë në atë puhi të dëndur flokësh dëbore dhe furtune bashkë, ndërroi menjëherë. Ishte e kotë që ta fshihte. U hodhi një sy shokëve. Edhe ata kishin qëndruar dhe po prisnin se ç'do t'u fliste shoku i tyre më i vjetër!

— Shikoni, djema! — e filloi ai ligjeratën, — koha èshtë e keqe, do të fillojë një të ftohtë i madh, dëbora do të shtohet akoma më tepër. Zjarr këtu nuk kemi; vënd ku të strehohemi nuk kemi. Me që èshtë akoma shpejt, ju shkon, rrugën mund ta gjeni, mbani gjithmonë nga e djaththa e përroit.

— Po ti?

— Unë do të rri vetë!

— Si na flet kështu? — ja befi studenti duke zbuar mendimet e tij.

— Pse, ç'jemi ne, kalamaj? Apo pse jemi qytetarë kujton ti se nuk e durojmë dot të ftohtit? Natyrisht, mund të kemi bërë shakara ose naze kur morëm sherbimin... po jo sa të arrijë puna deri këtu. Në vend që të na kërkosh ndihmë, ti

do të na heqësh qafet. Nuk e prisnim prej teje këtë gjë. — foli me inat mekaniku.

U'ndezën gjakrat.

Dëbora filloi të dëndësohej shumë. Temperatura sa vinte e ulej më tepër. Asnjeri s'ankohej. Tufani uturinte me tërë forcën e tij dhe herë-herë sikur i merrte me vete e i përplaste në dëborën e ngrirë. Ata ngriheshin menjëherë, nuk anko-heshin. Vigjelonin. Asnjeri s'mendonte pér veten e tij, asnjeri s'shikonte këmbët e tij. Seicili mendonte pér tjetrin. Shoku ish më i dashur se veta, dhe atdheu më i dashur se çdo gjë.

— A keni tē ftohët? Mërdhini nga pak? — u  
foli me tē butë malësori.

— Kur s'po na del ndonjë ujk përpara e...

— ... Ta vrisnim e të futeshim në lëkurën e tij. Besa të pjell shumë mëndja! — qeshi studenti.

Mundoheshin si e si të gjelin ndonjë bisedë për të kaluar kohën. Për të duruar. Por era nuk i linte të flisnin shumë. Pastaj edhe armiku mund, .. megjithë që ishte një vënd dhe një kohë, që armiku nuk të dëgjonte lehtë.

Mugëtirë! Vetém piramida qëndronte si një siluhetë e palëvizëshme. Duart e ushtarëve shtrëngonin fort automatikët e varur në qafë. Furtuna, ngrica, dëbora po bënин punën e tyre. Kush kishin ngrirë? Duart e tyre, apo armët e tyre? Ndoshata të dyja, ndoshata asnjë. Por që të dyja ishin shtrënguar aqë fort, sa nuk shqiteshin dot.

«Çuditem me käta qytetarët, sa shumë që e durokan tē ftohtit! Asnjeri nuk ankohet. Po sikur tē ankohesh ndonjeri, sa pisk do ta kisha! Ah, kjo era ma thau faqen e majtë... Kushedi si jänë bagëtia tashti. Do t'u kenë ngordhur shumë... Apo jo, se u kanë bërë stalla tē mira e tē

ngrohta... Besa kjo kooperativë e shpëtoi bagëtinë... Më shkruante vëllai se dushk kanë prerë për bagëtinë... Domethënë ato të siguruara janë... Po bujqësia? Oho, ky dimër i bën mirë bujqësisë, sidomos pemëve, nuk i lë të çelin para kohë. Edhe gruri mirë është. Nën dëborë ai rrin grohtë... pra çdo gjë në rregull qënka. Sa mirë!... Po ajo si është? Po më pret me padurim. Ja, le të presë edhe dy tre muaj e pastaj tërë jetën do të jemi bashkë...»

— Si jeni, shokë? — ja pat mekaniku.

— Mirë! — tha malësori, — po studenti si është?

— Në formë fare... — Era ja mori fjalën nga goja dhe ja përplasi diku larg, në ndonjë shkëmb.

«M'i lumtë studentit. Unë s'kisha besim tek ai, ai po na del më gjakftohtë, nuk i bën syri tër... i qetë, gjithmonë i qetë... Se si po më dukeni ju, o këmbë! Ma paçi borxh këtë që po më bëni sot. Doni të më turpëroni përparrë studentit e malësorit? Bëni sikur nuk jeni mësuar në të ftohtë... Shikoni, kemi mbrëmje në qytet këtë javë, prandaj duhet të jeni në formë. Pastaj këtë verë kemi festivalin e ushtrisë në Tiranë. Do të vete në Uzinë. Atje do t'u vete shokëve, kështu i veshur siç jam, ushtar... Do ta takoj edhe atë. Unë e di që ajo më do me të vërtetë... Po s'ka guxim të ma thotë... Apo unë s'kam guxim?... Kjo ngrica se si më duket, sikur ma thau hundën fare... Këmbë, mbahuni... Ç'bëjnë të tjerët?» — O malësor, do të më ftosh mua në dasëm? — kumboi me të fort zëri i tij.

— Po mua? — ja pat studenti, si i zgjuar nga një agoni e rëndë.

— Të dyve do t'ju ftoj një javë më parë.

— Ashtu de! ...

Përsëri një suferinë e acartë ua ndërpreu bisedën në mes.

«Ah, sa më vjen për të fjetur, sikur të isha në kapanon ... do të isha ngrrohtë ... por jo! (u shkund njëherë) duhet mbajtur vetja. Çështë ky gjumë tashti, në këtë kohë kaq të keqe, në këtë ngriçë, ... në këtë dëborë? ... Kushedi ç'mendon nëna tashti. Me siguri që do të më ketë parë përsëri në ëndërr ... Ja, edhe ca, durim ... Mos të më zerë gjumi, se ky gjumë nuk është i mirë ... duro edhe ca, me siguri do të vijë ndihma ... e aq është puna, pastaj ... do të kalojë çdo gjë. Po tjetër, ç' më shkruante nëna? «Kij kujdes mos të ikësh pa leje ... Apo sa bukur më shkruante motra e vogël. Dëgjon apo jo? ...»

Suferina tjetër ia thau faqen fare.

«Shiko!:

«I dashur vëllaçko ... Sot na erdhën disa kufitarë në shkollë e na folën për heroizmat e tyre. Po sa bukur që na flisnin se? ...» Harrova çfarë shkruante tjetër. Mblidhe mëndjen: «Na erdhi dhe ai ushtari, që ua priti bombën me dorë diversantëve, e ua përplasi në kokë duke i bërë fër ...» — Pse më shkëputen kështu mendimet? Mblidhe vreten, kujtoje deri në fund letrën: «... duke i bërë fërtle! Ai, i dashur vëllaçko, ishte më i shkurtër se ti, më i dobët se ti. Po ti a je aqë i fortë sa ai? A ke kapur ndonjë diversant? Do të më pëlgente të të shihja edhe ty në mes atyre trimave kufitarë, e tu thoshja shoqeve të mijë: — Shikoni vëllanë tim, ai ka kapur diversantë të gjallë! ...»

Ata s'lëvizën më. Asnjeri s'desh t'i tregonte shokut se ç'ndjente në atë çast, ose më mirë të themi,

se ç'pjesë të trupit nuk ndjente. Për ata s'kishte gjë më të shtrenjtë në atë kohë se detyra. Asnjeri s'mendonte për vdekjen.

Disa pelerina të bardha u dalluan larg, shumë larg. Ato po afroheshin. Po çanin me vështirësi. Po vinin.

Syri i mprehtë i malësorit mundi t'i dallonte se ata ishin shokët, që u vinin në ndihmë dhe nxori një klithmë! E vetëm kaq!

Asnjeri nga shokët nuk iu përgjegj. Asnjeri s'kërkoi ndihmë. Asnjeri s'lëvizi nga vëndi. As malësori vetë! Suferina vazhdonte të frynte më me tërbim. Qerpikët e të treve nuk lëviznin më. Tashmë ato ishin bërë gjëmba...

Si një rrapëllimë e fortë, tufani vazhdonte të shkulte nga vëndi topa të mëdhenj dëbore e t'i hidhte tej greminave, duke formuar herë-hërë ortiqe të fuqishme, që rrëkelleheshin shkëmbenjve të thepisur. Të tre vigjelonin. Kapat e tyre, të rratura thellë në kokë, ishin ngurosur. Sytë e tyre ishin të hapur. Lotët që u kishin mbetur nga cikna e fortë, kishin krijuar nga një lentë kristalini, që vështronte armikun, që vigjelonte.

Ata nuk vdiqën. Ata qenë gjallë. Që të tre shtrëngonin armët e tyre të ftohta për të mbrojtur gjënë e tyre më të shtrenjtë. I shtrëngonin për të mos i lëshuar kurrë. Dhe nuk i lëshuan nga duart deri sa krijuan një lapidar përpara piramidës.

Ata ishin tre njëzetvjeçarë. Që të tre ishin kufitarë.

## S H P È T I M T A R È T

— Doktor, shpëtoje, ai më shpëtoi mua!

— Ju lutem, doktor, kujdes, ai është shoku im më i ngushtë!

— Shpëtojeni pa tjetër, ai ka bërë shumë përmua!

— Doktor! Ai na nderoi të gjithëve, ai është shoku ynë më i mirë.

— Do ta shpëtoni pa tjetër, doktor!

I vinin dhe i shkonin këto fytyra ushtarësh, me rroba të lagura, me rroba të qullura, me fytyra të lodhura, por të gjalla. Dikush i grisur, dikush edhe i plagosur; por asnjeri s'fliste përveten e tij, asnjeri s'mendonte përveten e tij, por të gjithë flisnin, luteshin, madje edhe e urdhëronin që mjeku ta shpëtonte pa tjetër shokun e tyre.

Mos vallë kjo s'ishte detyra e tij?!

E ku donin t'ia dinin ushtarët, ata donin ta shihnin shokun midis tyre ashtu të gjallë, të qeshur, optimist.

— Eh, shpëtoje doktor, ai më hapi sytë mua!

Ushtari qëndronte i shtrirë, pa ndjenja, në tavolinën e operacionit. Ai kish një fytyrë të rrahunga dielli, simpatike, burrërore, me mjekër të ash-për. Posa e kishin sjellë në krahë disa shokë të tij,

të cilët ishin shumë të lodhur, ishin lagur e bërë quall.

Një perde e murme drite po përhapej anembanë. Po fekste mëngjezi. Rrezet e diellit dalëngadalë i jepnin dritë natyrës, dhomës.

Mjeku e kundronte në heshtje fyttyrën burrërorë të pacjentit të tij! «Doktor, shpëtoje!» — ish urdhëri i Zefit për mjekun, posa ia dorëzoit shokun e tij. «E kam shokun tim ma të ngushtë...» Dhe ky, Zefi, është ai që s'qëndronte në një vënd në koridor; ai që ngrihej e lëvizte lart e poshtë e që afrohej herë-herë pranë derës së sallës së operacionit duke zgjatur veshët se mos dëgjonte gjë, e herë-herë ulej në stol duke kafshuar fort me dhëmbë cigaren e pandezur, që e kish ngulur në gojë prej kohësh. Kish marrë edhe ai një plagë të lehtë në krah, por s'donte t'ia dinte për të. Teshat i kishte të lagura, e as për këtë nuk donte t'ia dinte.

Historia e Zefit lidhur me Markun është e thjeshtë. Një herë ai mori një letër, letër të shkruar prej dorës të së fejuarës së tij. Në ato çaste dy ndjenja i lindën: një, ajo e gjëzimit, e fejuara i shkruante letër, jo shaka! Dhe e dyta, ajo e zakonit, e kanunit, e fejuara shkeli zakonin. «Tak» — iu ngritën nervat. Gjaku i ra në hundët: «Ma mori erzin qetash nëpër kambë!» — tha dhe dridhej nga inati. Shokët e vunë re. Edhe Marku e vuri re.

— Nga e ke atë letër, or Zef?

— Me siguri nga e fejuara!

Zefit iu errën sytë.

— Sot e paskan radhën të fejuarat — sepse dhe mua, dhe Zegos na erdhën letra nga të fejuarat tonë! — tha Qaniu. Shokët qeshën. Zefi s'dinte si

t'ia bënte. E kuptoi që shokët s'ia kishin me të keq. Prandaj filloi edhe ai të qeshë.

— Mua më shkruan se do të vijë e të më shohë këtu në repart! Do t'ua tregoj të gjithëve! — shtoi Qaniu.

— S'na besohet, ti je xheloz!

— Me shokun s'kam pse të bëhem xheloz!

— Ndërsa mua më dërgoi pesëdhjetë lekë nga rroga e saj e parë! — tha Zequa, — do t'ju qeras të gjithëve.

— Po, kjo ka më tepër rëndësi!

Zefit i dridhej letra në dorë.

— Po ty, o Zef, ç'të shkruan e fejuara?

Një ngjyrë iiku dhe një tjetër i erdhi Zefit.

— Ai akoma s'e ka hapur, ai akoma me zakonet prapanike! — shtoi dikush.

— Duket, që është romantik, e nuhat njëherë me hundë nga jashtë, pastaj do t'i futet brenda! — qeshi një tjetër.

Qeshën edhe shokët e tjerë.

Zefi u shushat fare. S'dinte se si të sillesh. E s'kuptonte pse qeshnin shokët. Ishte në një dilemë të tillë, sa s'dinte se kundër kujt të hakmerrej, kundër shokëve, kundër vetes a kundër kanunit.

— Mjaft u tallët! — u foli Marku atyre që qeshnin dhe e mori Zefin më një anë:

— Mos ua vërë veshin, ata bëjnë shaka. Hape letrën dhe lexoje.

Ndërsa Marku filloi të merrej me diçka tjetër, Zefi e hapi letrën:

«Zef!» — e fillonte ajo. — Posa u ktheva nga aksioni. Atje ndeja dy muaj. Atje mësova shumë. Edhe ti në ushtri më kanë thënë se po bën gjashtë muaj. Edhe ti, atje duhet të kesh mësue shumë. Na kena gati njëzet vjet që jena fejue. Jena fejue ende

pa le. E gjatë këtyne njëzet vjetëve s'jena njoftë fare. Ma mirë! ...» Dhe padashur Zefi filloi ta ngrejë pak zërin: «Zef, po marr guximin e po të shkruej unë e para, — po të shkruej për të parën e të fundit herë. — Unë nuk due me të prekë në sedër. Ti, siç më kanë thanë, je djalë i mirë, — unë s'të njof ... po ... këtu në fshatin tim njofta një djalë, e njofta në punë, në kooperativë. Së bashku me të shkuem në aksion ... dhe ai ma fitoi zemrën! — Zef, mos u dëshpéro! Unë s'kam faj, Zef. Unë s'të kam njoftë kurrë! Edhe ti s'më ke njoftë! Ti nuk duhet të dëshpérohesh. Ti atje n'ushtri ...»

S'arriti të lexojë më tepër. Iu errën sytë. Tëm-tha<sup>+</sup> filluan t'i rrabin me të fortë. Duart filluan t'i dridhen, t'i mblidhen grusht. Sikur t'i binte vareja mbi kokë e përsëri nuk do të tronditej kaq shumë.

Marku ngriti kokën, e pa!

— C'ke kështu, o Zef?

— Pa marrë gjak, unë s'e la!

Zefi ishte turbulluar aqë shumë sa që s'dinte se ç'fiste. Brofi në këmbë e ashtu me duart grusht siç i kishte u nis!

— Zef, qëndro, c'ke?!

— Më ka koritë e fejuemja.

— Çfarë the?

— Më ka marrë erzin, kam me e vra! — dhe i zgjati letrën. Sikur u qetësua nga ky veprim dhe qëndroi në vënd për të pritur aprovimin e Markut. Marku, ashtu siç ish në këmbë, i hodhi një sy të shpejtë letrës.

— He, si po t'duket?

— Një letër mjaft e bukur!

— Si the?

— Ti je ushtar, e ti duhet ta kuptosh më mirë

se kushdo tietër këtë letër. Ty ta shkruan këtë vërtetë një cucë malësie, një burrneshë, ta shkruan pa dashur të të ofendojë, ta shkruan për të të shpëtuar jo vetëm ty, por edhe motrën tënde, edhe nderin e familjes!

— Unë jam shtëpi pushke, unë s'due me u koritë!

— Pushkën e ke për armikun dhe jo për revolucionarët, për popullin!

— Për revolucionarët, the? Për popullin?

— Po, e fejuara jote është një revolucionare e vërtetë, është me të vërtetë një burrneshë mali!

Tërë ajo hakarri hakmarjeje, që e kish push-tuar Zefin, sikur u shua menjëherë. Ai u step në vënd: «Ajo revolucionare?! Ajo burrneshë?! — Vari kokën dhe mori tatëpjetë repartit.

Marku e ndoqi pas.

Zefi e cte kokëlur, thua se numëronte hapat e tij. Marku iu afrua dhe i vuri dorën mbi sup:

— Vërtet nuk është edhe aq e lehtë, por është një diçka e madhe, një gjë e lartë. Edhe nëqoftëse ajo nuk do ta bënte këtë, ti patjetër duhet ta bëie, ashtu sic duhet të venrosh tanë me prindët e tu, me shokët e tu për raste të tillë.

Zefi ngriti kokën. Svtë i kish të skuqur.

— Kështu e kena zakon na!

— E ne duhet të ngrihem kundër këtyre zako-neve. Kështu thotë komisari ynë. Kështu thotë edhe Partia! Kështu duhet të themi edhe ne.

— Ti flet aqë qetë, se s'të ka ndodhë gja, por . . .

Marku ndërroi menjëherë fytyrë.

Zefi e vuri re:

— Po ti ç'ke?

— Eh, Zef, o Zef. Unë nuk desha të flisja për vëten time, për motrën time!... Ti je nga Dukagjini, — unë jam nga Mati. Të njëjtat zakone kemi pasur. Marku drejtoi sytë tej në muzgun e mbrëmjes, andej nga kishte filluar të vijë errësira:

— Hike e quajnë!... Është vërtet një burrneshë mali. Ishte sekretare e rinisë së kooperativës sonë. Shkonim kudo bashkë, për të përhapur dritën e Partisë. Sa e mirë që ishte, sa e çiltër, sa e guximëshme! Mbaj mënd, shpesh më thosh:

— Mark, a do të bëhen ndonjëherë cucat tonë burrnesha, që t'i zhdukin të gjitha zakonet prapanike?

— Pa tjetër! — i thoshja unë.

— Pa tjetër! — Më thoshte ajo, dhe i mëshonte gjithnjë e më fort zërit në çdo mbledhje me cucat, në çdo mbledhje me gratë. Kish dy sy zjarr! Kur fliste, ata i shkrepëtinin!

Baba im nuk e shihte me sy të mirë këtë gjë, por s'kishte q'të më bënte. Ish zënë me mua disa herë. Ajo më kish krahun e saj të djathë:

— Shyqyr që je ti, o Mark, se ç'kisha me ba unë e shkreta me babën, ai kish me më vra!

Anembanë u përhap lajmi se cucat e malësive do të shkonin nëpër aksione. Hikja rrëmbeu edhe tri katër cuca të tjera dhe një ditë... iku. Katër cuca nga fshati im. Gjë e madhe! Katër cuca në aksion. Ishin cucat e para. U ngrit kanuni kundër tyre. Po kundër kanunit u ngrit e tërë rinia. Motra ishte e guximshme, por ajo ishte e fejuar! I zunë pritë. «Më ka koritë kjo...!» — shante dhëndëri. Dhe e rrëmbeu... po i iku nga dora! E kapi dhe e goditi ...

— Kush kështu? — skërmiti dhëmbët Zefi.

— Kanuni, zakoni, i fejuari i saj!

Zefi çakërlliste sytë:

- Po ti, po ti çfar bëre, pse s'i vrave?
  - Kë të vrisja?
  - Kë të vrisje?! Atë!
- Marku buzëqeshi idhtas. Zefi shtangu në vënd:
- Po tashti si asht motra?
  - Nuk e di, se nuk kam qenë atje!
  - Pse, kur ka ndodhë kjo?
  - S'ka një javë!
  - Pse s'ke shkuar, apo s'të kanë dhënë leje?
  - Jo, s'kam kërkuar vetë, ti e di se së shpejti ne kemi qitjet!...

\*

\* \* \*

Lëvizi dorëza e derës. Kanati u hap. Sakaq Zefi u hodh përpjetë:

— Si u bë? — tha posa pa infermieren që doli nga salsa e operacionit.

Infermierja, pa folur, kokëulur, kaloi me të shpejtë koridorin e u fut diku në një dhomë.

— Do të jetë keq! — tha Zefi.

— Ashtu duket! — ia priti nga ana tjetër Kalemi.

— Sa e tmerrshme

— S'ka gjë më të tmerrshme se kjo!

Në koridor u ndjenë përsëri takat e infermieres. Kish një pako ilaqesh në dorë dhe shpejtonte drejt sallës së operacionit.

— Si është Marku, a do të shpëtojë? — ia zuri rrugën Kalemi.

— Të shohim! — tha prerazi infermierja, dhe dredhoi pak rrugë që të mos përplasej e u fut në sallën e operacionit.

— Të shohim! — pëshpëriti nëpër dhëmbë Kalemi,

— Të shohim! Po a do të shpëtojë apo jo? — u duk sikur iu hakërua Zefit, që tashmë rrinte para tij i heshtur dhe priste me ankth. — «Të shohim!» — tha edhe një herë me vete. U ul në stolin e gjatë në qoshe të koridorit dhe ngjeshi kokën ndërmjet pëllëmbëve.

Të gjithë po rrinin të heshtur; vështronin njëri tjetrit dhe nuk guxonin të hapnin gojën. Infermjerja i kish lënë në ankth, s'u kish dhënë asnje shpresë. Zefi thithte me etje cigaren duke lëshuar tym. E ndjente kokën të turbullt.

Papritur kërciti dera e sallës së operacionit dhe në koridor u duk mjeku.

Shokët, posa e panë, brofën në këmbë:

— Si është Marku? A shpëtoi Marku?

— Marku, shoku juaj, ka nevojë për gjak!

— Për gjak?! — pëshpëritën njëzëri ata që ndodheshin në koridor dhe në të njëjtën kohë përveshën mëngët dhe zgjatën duart:

— Mermëni mua, doktor!

— Mermëni mua, doktor!

— Jo, do të më merrni mua, se unë e kam grupin «zero», — ish zëri i vendosur i Kalem-it.

Mjeku i shihte të tërë që kishin zgjatur duart me llërë të përveshura. Të gjithë këta djem të lagur, të lodhur, madje ndonjeri i plagosur lehtë... Pse ishin kështu? Ku u lagën? Ku i grisën rrobat? Ku u plagosën? ...

\* \* \*

« — Kalem, Zef, kujdes të rregullojmë sa më shpejt pozicionin e zjarrit kryesor! Kujdes gadish-

mërinë! — thoshte zëvëndës komandanti i baterisë, Marku

Zefi, Kalemi, Sotiri e të tjerët ngulnin kazmat në tokë, ngulnin lopatat në tokë, sheshonin dheun, me një fjalë bënин pjacollën, vëndin, për të zënë pozicionin e zjarrit, për të vendosur në ekuilibër baterinë e topave. Për të raportuar sa më shpejt gadishmërinë.

Nga pika e vrojtimit, nëpërmjet radios vjen zëri i Lokut, i cili raporton urdhërat e komandantit të baterisë, që ndodhej në pikën e vrojtimit.

— Vini re, nëpër vënde! — urdhëron komandanti i baterisë, transmeton Loku.

«Drejtimi bazë — 37!»

— Drejtimi bazë — 37!

Dhe filluan grykat e topave të lëvizin nga e majta në të djathtë. Zefi shinjonte. Kaboçi mbushte topin. Kalemi komandonte topin. Faslliu ishte ndërlidhës.

«Shinjestra 257!»

— Shinjestra 257!

Dhe grykat e topave filluan të ngrihen nga poshtë lart.

«Distanca! . . .»

Distanca . . .!

Dhe grykat e topave filluan të drejtohen nga objektivi.

— Gati! — raporton Marku gadishmërinë.

«Mbush!»

— Mbush!

Dhe filluan të kërcasin shulat e topave, dhe filluan të mbushen topat.

— Gati!

«Zjarr!» — urdhëron komandanti, transmeton Loku!

— Shtjer! — Jep sinjalin Marku dhe Kaboqi tërheq me të fortë litarin.

Një zhurmë shurdhuese. Flakë rreth topit. U tund vendi. U tundën dhe malet! — Ankth! Pritej se ku do të binte predha. Çaste emocionante. Prisnin Lokun të lajméronte.

Diku larg u ndie një plasje, asgjë më tepër. Predha nga vija e zjarrit nuk u pa. Ata prisnin plot ankth, që Loku t'i lajméronte. Por ai heshtëtë. Më në fund, u dëgjua sinjali lajmérues. Loku jepte korigimin. Grykat e topave filluan të lëvizin nga poshtë lart, nga e majta në të djathtë.

«Zjarr!»

— Zjarr!

— Shtiu!

«Shtiu!»

«Bum!» — buçiti predha e dytë e topit të parë. Ankthe! Emocione! Një plasje e errët.

«Urra!» — bërtiti padashje nga gëzimi Loku në Radio.

— Me siguri në shenjë! — ia bëri Marku.

«Bateria, zjarr!» — transmetoi komandanti nga pikë e vrojtimit. Buçima të tmerrshme, tronditëse filluan të dalin nga grykat e topave.

«Zjarr!»

Jehonin përsëri krismat e baterisë. Djemtë punonin, shpejtonin, ishin të gëzuar se ata tashti me çdo të shtime godisnin objektivin.

«Topi i parë për marshim, nën komandën e zë-vëndës-komandantit të baterisë, Markut!» — u dha urdhëri me telefon nga komandanti i baterisë.

Ishte një formë e re qitjeje. Në kohën sa më të shkurtër, topi i parë do të shkëputet nga bateria e do të shkonte të zinte një pozicion tjetër zjarri dhe prej andej do të kryente qitje direkte.

Menjëherë, sikur të shkelje sustën, u shkëput Kalem nga komandimi i topit, ndezi automjetin tërheqës, ndërsa të tjerët bashkuani kofshët e topit dhe e lidhën pas automjetit.

Një uturimë e rëndë motori u ndie, dhe topi u shkëput nga bateria.

Po bëhej një eksperiment mjaft i bukur, por edhe i vështirë. Një top të shkëputet nga bateria e me shpejtësi të zinte një pozicion tjetër dhe që andej, prapa krahëve, të godiste armikun. Topi ishte i kalibrit të rëndë.

Pas pak minutash, rrugës, grapi i topit këndon te me zë të ulët, për shkak maskimi, këngën e artiljerit:

*Artiljeri rrugës po kalonte  
Në kufi, në pozicion,  
Shikon detin për karshi,  
Që buçet me krenari...*

Ecnin me të shpejtë, që të zinin pozicionin e dytë të zjarrit.

Rruja ishte e gjatë. Rruja ishte me kthesa. Kish dhe rrugë pa rrugë. Duhej kaluar edhe lumi. Ishte janar. I ftohtë i madh. Breshër dhe dëborë. Megjithatë artiljerët brenda në kabinë këndonin, këndonin se kishin zjarr në shpirt, se ishin të rinx, se në provën e parë kishin dalë me sukses dhe, të gëzuar nga kjo, çdo gjë që u dilte përpara u dukej shesh.

— Jepi, jepi Kalem, të arrijmë sa më shpejt!  
— Kujdes, Kalem! — thosh Marku.

Dritat i kishin të maskuara. Nuk shihesh mirë. Ishin të lodhur. Radiatori ishte nxehur mjaft e donte ujë. Kalem ishte dehur nga shpejtësia. Preu

levën në kohën e duhur. Automjeti turfulloj si një përbindësh, qëndroi në vënd, u kthyte nga e djath-ta dhe u sul në lumë. Do kalonin lumin. Kishin kaluar edhe herë të tjera në këtë vënd, po ahore ishte verë, shtrati i lumbit ishte i cekët, uji ishte i qetë; ndërsa tashti, i rrëmbyer, i thellë, i turbullt. Automjeti u fut në ujë.

— Ç'bën, Kalem? — klithi Marku.

Stërkala uji u përplasën në xhamet.

Kalemi frenoi me të shpejtë.

— Dilni jashtë! — urdhëroi Marku. Ndërsa Kalemi merrej me levat. Automjeti qëndroi në vënd, nuk lëviste dot as para, as prapa. Atë çast filloj të fundosej.

— Shpejt te topi! Ta shkëpusim topin! — tha Marku.

Marku u fut në ujë. Rryma të forta e të ftohta u përplasën në trupin e tij: «Kalem, shpejt çekiçin!

— Kaboç, dil nga ana tjetër! — Zef, shtrëngó frenat e topit! — Faslli, veru nga një gur rrotave të topit! — Kalem, bjeri spinotit!» — jepte urdhëra Marku... dhe topi u shkëput nga automjeti tër-heqës.

— Shpejt, topin në pozicion zjarri! Që këtej do bëjmë qitje direkte! Astrit, jep sinjalin e ndihmës së shpejtë!»

Shkumbini po tërbohej. Shkumbini mbarte mbi vete gurë, drurë, copa akulli.

— Automjeti po fundoset! — klithi Kalemi.

— Kaboç, merr komandën, bëj qitje direkte! Kalem, Zef, shpejt te automjeti sa të vijë ndihma!

Rryma e fortë e ujit po e gryente nga poshtë shtratin e lumbit thellë e më thellë.

Nga larg u dëgjua uturima e një tërheqësi tjetër. Po vinte ndihma.

— Shpejt, Kalem, tē nxjerrim kavon e ta lidhim pas pemēs pértej lomit.

U fut Kalemi. Ca gurë u rrokullisën nēpēr ujē. U fut Marku. Ca drurē ia çorën këmbët. Shkumbini vērshonte. Gurët pérplaseshin njeri me tjetrin e bēnin një zhurmë tē tērbuar. Ish e pamundur ta nxirrje kavon. Automjeti po fundosej e po fundosej. Ish rrezik tē batohej nga çasti nē çast. Shokët nga ana tjetër po përgatisnin topin pér luftim.

— Po vjen ndihma!

Rryma vazhdonte tē grryente kokën nga poshtë dhe automjeti sa vinte e po fundosej thellë e më thellë.

Zhyteshin njeri e tjetri nē ujē, po ç'të bēnin?! Dikush ish goditur, por dhëmbje s'ndjente. Dikujt i rriddhe dhe gjak, po gjak nuk shihte!

Uturima e automjetit tjetër tērheqës u ndie pranë, fare pranë.

— Ç'kini bërë kështu? — u çor shoferi i automjetit ndihmës, posa vuri re se ç'po ndodhë.

— Shpejt! Kavon! — klithi Marku.

Tej, nē anën tjetër, Kaboçi me shokët e tjerë, po vinin tē gjitha forcat që tē pregatisnin sa më parë topin pér luftim. Atyre u mungonin tre shokë. U mungonin Marku, Kalem, Zefi... Tre më tē rëndësishmit. Pra, Kaboçit i duhej tē bënte qitje nē konditat më tē vështira atmosferike dhe duke i munguar topit tre veta. Zëre se iu vranë ata. Detyra ishte detyrë. Ai kishte marrë komandën nē dorë dhe do tē kryente funksionin e komandantit tē topit dhe tē zëvëndës-komandantit tē baterisë. Jo vetëm ai, por edhe tē tjerët: Faslliut, Astritit, Sotirit, u duhej tani tē bēnin edhe punën e shënjusit, edhe tē mbushësit, edhe tē radistit, edhe tē

ndihmës shënjesit. Pra edhe këtu çështja ishte serioze.

Marku këtheu kokën nga topi:

— Kaboç, shpejt, duhet mbaruar detyra!

— Mos kij merak, Mark!

Shkumbini vazhdonte të turfullonte i tèrbuar.  
Automjeti po lëkundej.

— Ja kavoja tjetër!

Marku mori kavon dhe u hodh më not. Era përplasej në të. Dallgët përplaseshin në të. «Ja armiku! Jo, tèrheqësin s'do ta lemë aty!»

U fut Zefi, u fut dhe Kalemi!

— Zini me trup rymën!

Të gjithë mbanin kavon. Ia lehtësonin peshën Markut. Të gjithë zunë rrymën. Shtrati i lumit sa vinte e rritej. Duhej gjetur ganxha. Është natë! Është sterrë! Është thellë edhe ftohtë. — Mbajeni kavon! — u zhyt Marku, duke u kapur pas hekurave të automjetit. «E gjeta!» — tha me vete. Dhe një të shtyrë u dha këmbëve, të cilat iu coptuan te zinxhirat, doli në sipërfaqe dhjetë pesëmbëdhjetë metra larg. Mori ajër. U kthye barkas me not, e u afrua pranë shokëve. Kalemi po e shihte Markun si një hije, të lodhur e të copuar. Kalemi po luftonte edhe me vetveten. Kalemi po vuante.

— Lemë, o Mark, se do të futem unë! — ia pat Zefi.

— Jo, unë! — tha Kalemi.

Marku s'foli, po rrëmbeu kavon e rëndë, që e kish lënë pak më parë sa të gjente vëndin dhe u zhyt me të në dorë.

Zefi, Kalemi, ia lehtësonin peshën e kavos, ia prisnin vrullin rrymës, ndërsa Marku shtrëngohen pas hekurave, përpiquej pas hekurave duke iu për-

plasur herë këmbët e herë trupi. Ai zhytej, ajër nuk mirrte. Kish nevojë pér ajér. Kalemit s'iu du-rua, po u zhyt. Marku shtrëngohen pas ganxhës me kavon në dorë. Në atë errësirë të dy u prekën nën ujë. Uji ishte më i nxehjtë se ajri. Të dy u muarrën vesh në heshtje njeri me tjetrin. Marku e térhoqi kavon nga poshtë. Zefi ia lëshonte kavon nga sipér. Ndërsa Kalemi nguli spinotin e një t'u dhënë këm-bëve doli jashtë.

— Ku éshtë Marku? — dëgjoi zérin e Zefit.

Të gjithë kthyen kokën.

— Mark! — bërtiti Kalemi.

U zhyt Zefi, u zhyt dhe Kalemi. Në atë errësirë të kobëshme vunë re këmbët e Markut të ngatërruara midis kavos dhe hekurave të automjetit. Një të shtyrë të fortë i bënë Markut e rryma e nxori jashtë. Marku ishte pa ndjenja. Nga veshët gjaku i gurgullonte. Të gjithë u hodhën dhe e nxuarën jashtë. Këmbët i kishte të coptuara. E shtrinë barkas. I nxorën pak ujë. Filluan t'i lëvizin krahët; gjoksi nisi t'i hidhej me gulçim.

Në të njëjtën kohë u dëgjua një krismë e fortë e topit. Kaboçi po bënte qitje. Marku i hapi pak sytë e përsëri i mylli. Zefi e rrëmbeu në krahë, së bashku me të dhe Kalemi me Astritin e që të tre u nisën pér në spitalin më të afërt, që ndodhej disa metra, prapa kodrës përballë.

\* \* \*

Mjeku pati një ndjenjë kënaqësie pér këta djem, të cilët kishin zgjatur duart pér të dhënë gjak pér shokun e tyre.

Me tërsëllimë u hap dera e jashtme e brënda në koridor u fut komandanti. Nga pika e vrojtimit, posa kishte marrë vesh për Markun, menjëherë pasi mbaroi qitjet ai kish marrë me të katër tatëpjetë pikës së vrojtimit. Vraponte me të madhe. Në çdo hap që hidhte, shihte Markun e plagosur, dhe Markun e gjallë. Shihte Markun të plagosur rëndë, shihte edhe Markun, atë nxënësin e tij të palodhur që i ndodhej gjithnjë pranë, e shihte në ato çaste kur ata, me planshetë në krahë e me automatik në dorë, kalonin me vrap pengesat, kur me radion në krahë dhe automatikun në dorë vraponin me të katër për të zënë pikën e vrojtimit, kur me tamburë në krahë dhe me automatik në dorë shpejtonin të bënин ndërlidhjen e pikës së vrojtimit me vijën e zjarrit. «Ja edhe një çikë, durim edhe pak edhe pak!» — u thosh Marku shokëve gjatë kalimit të brezit të kalitjes, gjatë mësimit për të përvetësuar sa më shumë profesione gjatë një kohe sa më të shkurtër. Dhe ja sa të besueshme, sa të nevojshme iu dukën sot me rastin e qitjes të gjitha ato, që i kishte përvetësuar dhe sa të larta iu bënë figurat e Markut, Zefit, Kalemith, Kaboçit...

Mjeku mori Kalemith dhe u fut në sallë të operacionit. Menjëherë filloi t'i bëjë transfuzionin e gjakut. Gjaku i Kalemith kalonte në trupin e Markut.

Pas një copë here, fytyra e verdhë e Markut filloi të skuqej. Ai hapi sytë dhe një buzëqeshje e ëmbël i zbuluari pamjen.

Mjeku ngriti kokën i lehtësuar, kur ... pa me habi se ish rrrethuar nga shokët e Markut.

— Keni thyer rregulloren, jeni futur pa leje, u foli ai ngadalë e me dashamirësi.

Të gjithë shokët qeshën lirisht.

## U S H T A R   S E M A N I

— Kush i foli, kush? — u hakërrua i mvrejtur komisari i regjimentit.

— Komandanti i baterisë dhe disa shokë të tij!

— Hëë, komandanti i baterisë, disa shokë të tij... — përsëriti nëpër dhëmbë fjalët e ushtarit të tij. — Thirreni të vijë shpejt këtu!

— Me leje të largohem! — nderoi ushtarakisht ushtari i shërbimit duke ngritur dorën e djathtë lart e duke cikur me gishtin e mezit majën e vëtullës së djathtë, — dhe me hap të rregullt doli jashtë.

«Komandanti i baterisë, disa shokë!... hë!...»

— nënqeshi me vete komisari dhe lëvizi lart e poshtë. Pastaj qëndroi një copë herë në vend, sikur u kujtua për diçka, iu afrua tavolinës dhe s'an-dejmi mori një cigare. Nxori çakmakun nga xhepi dhe e ndezi. Një fjollë e hollë tymi e përshkoi atë dhomë të pastër e të ajrosur mirë nga dritaret e mëdha. E thithi edhe një herë cigaren me të fortë, nxori një shtëllungë të madhe tymi dhe u ul në kulltukun përbri tavolinës së punës. Çfletoi një dosje që ishte atje. I hodhi një sy kartelës që kishë të në fillim. Pa fotografinë që ish ngjitur në të. Dy sy të gjallë ia thithnin vështrimin komisarit! Pastaj e mbylli dosjen dhe u ngrit në këmbë: «Këta të marrin në qafë kur s'duhet!» — tha me vete

dhe u afrua pranë dritares. Me dorën e majtë më-njanoi pak perden e rëndë të varur në mur dhe vështrimin e tij e hodhi tej e tej nga pjata, nga aeroplanët, nga rojet, nga ushtarët që bënin stërvitje, nga...

— Tak-tak-tak! — trokitën te dera.

Komisari u kthye menjëherë nga prapa:

— Hyrë! — tha.

Dorëza e derës lëvizi ngadalë nga lart poshtë. Dera u hap. Komisari e kundroi atë fytyrë që hyri.

— Shoku Komisar i regjimentit, ushtar Semani, sipas urdhërit tuaj, ju paraqitet! — dhe uli menjëherë dorën.

Komisari e dëgjoi në heshtje edhe raportimin e tij. Ai, në fillim, vuri re se ushtari që hyri kishte një fytyrë të ndrojtur, e cila gjatë raportimit mori një gjallëri të çuditëshme dhe sytë e vërtetë të ushtarit u krahasuan në mëndjen e Komisarit me ata dy sy që pa në fotografinë ngjitur në kartelën e futur brenda në dosje; ndërsa nga fundi i raportimit vuri re, për çudi, një nënqeshje ironike.

— Domethënë ju jeni ai radisti që...

— Siurdhëron! — u përgjegj ushtari dhe në të njëjtën kohë zgjati duart përpara dhe i kryqëzoi:

— Lidhmëni, me që unë paskam bërë gabim të madh! — Në këto fjalë ironia u kthye në një sarkazëm të fortë, që Komisarit nuk i tingëlloji mirë.

Ai tha:

— Jo, ushtar Semani, ju keni kryer një akt të tillë, që rrallë mund ta bëjnë të tjerët! Ju... — s'arriti ta mbarojë dot fjalën, se ndjeu mbi vete krahët, kokën, trupin e ushtarit, i cili po e përqafonte.

Për herë të parë pas asaj ngjarjeje ushtar Se-

mani po e ndjente veten t  t   liruar nga ajo barr  e r nd  p r t  cil n akuzohej dhe syt  filluan t i njomen me lot aty mbi supet e komisarit t  tij!...

\* \* \*

Ta-ti tatataaaa! Ta-ti-tatataaa! — jehoi buria.

— Alarm! Alarm! — filluan t  b rtasin ushtar t nga ishin e nga s'ishin.

Nj  gjall ri, nj  l vizje jo e zakon shme u ndje n  aerodromin X.

Korjer t me vrap k rcenin mbi motoçikleta e zhdukeshin p r t  lajm ruar oficer t. Pilot t re dnin me sa mundnin, u hipnin aeroplan ve dhe prapa linin nga nj  fjoll  t  holl  tymi e ngri-heshin p rpjet .

— Br nda gjys m ore mos mbetet asgj  n  repart! — ish urdh ri i rrept  i komandantit t  regjimentit.

Uturinin nga njera an  autobot t, nga ana tjeter cisternat, nga pista rr shqisnin gjuajt sit Ushtar  t  ndrysh m l viznin shpejt, ngarkonin sa njer n maqin  aq edhe tjetr n e pastaj hipnin n  to sipas v ndit q  kishin dhe zhdukeshin.

Ushtar Semani, pasi kish rregulluar aparatur n n  gaz, me radion e tij n  krah po q ndronte n  spontat e makin s dhe po priste shoferin t  vinte.

Akrep t e sahatit po l viznin.

Kthente kok n her  majtas e her  djathtas se mos e shihte ashtu rast sisht, a se mos i vinte nga prapa shoferi n noficer.

«S'po vjen!» — mendonte.

— Pse, ore bëhesh merak, se mos është faji yt -a?... — i thosh një mëndje tjetër.

— Po sikur të ishte luftë?

— E, ore dhe ti me dëngla!

— Yyyyy! — dëgjonte mbi kokë uturimat e aeroplanëve që vërtiteshin mbi aerodrom.

«Për gjysëm ore aerodromi të zbrazet i téri!»

— E Seman, akoma s'je nisur ti? — i foli dikush nga një makinë, që i kaloi pranë, fare pranë.

Aerodromi po zbrazej me shpejtësi të madhe. Tiktaku i orës vazhdonte. Semani ktheu kokën nga makina. Ajo po rrinte në vënd si një bishë e mundur, e ngordhur, e turpëruar! Hodhi sytë tej se mos vinte shoferi. «Askush!» — ai kish ikur me leje dhe kish mjaf mundësi që të mos ndodhej fare në shtëpi të tij. Pa korierat që ktheheshin me oficerë të ndryshëm, të cilët jepnin me shpejtësi urdhërat dhe niseshin për në objektivin e caktuar. Tiktaku i orës vazhdonte. Në kurriz mbante radion, Lidhja e tij me grupin e parë, që ishte nisur, ishte ndërprerë.

«Asgjë të mos mbetet në repart!»

Makina e tij kishte mbetur fillikat vetëm.

«Do e marr e do e ngas vetë!»

— Je në vete!

— Do ta marr, se s'ka si bëhet ndryshe! Nuk mund ta le makinën në dorë të armikut. Nuk mund të rri pa bërë ndërlidhjen!...

— Kri, ore, ç'të duhet ty!!!

Tiktaku i orës vazhdonte.

Ushtar Semani vazhdonte të mendonte, të bënte duel me vetvete!

— Eja me makinën tonë! — i tha dikush.

— Po gazi?

— Lere!

«Jo, mos e lerë!» — i thosh një zë tjetër i bren-dëshëm. Mbeti fillikat vetëm. Tutje nga pista shikoi makinat e fundit.

— Shoku komandant i baterisë, tanë si të bëj unë?

— Të presësh shoferin.

— Po s'erdhi? — Do të vijë! — Po s'erdhi?

— Do të vijë — dhe iku.

Shoferi i makinës s'po vinte. Aerodromi u bo-shatis i téri. Sipër mbi kokë i vërshonin aeroplaniët gjuajtës: «Ç'të bëj, ta marr a të mos e marr!» Mbylli sytë. Iu duk vetja hypur mbi makinë me shoferin pranë. Shoferi duke e ngarë dhe ky duke e pyetur. Po kjo vegël përsë duhet? Si ndizet makina? Si ndalon makina? Dhe vështronte herë timonin e herë rrugën e herë-herë këmbët, lëvizjet e tyre, të duarve dhe ... ecje-ecje-ecje!» «Çdo ushtar duhet të përvetësojë dy tre e më shumë profesione, por pa tjetër ai duhet të zotërojë profesionin e shokut të tij, e atij me të cilin punon!» — ishin udhëzimet e eprorëve të tij, që i jepnin mësim gjatë kohës së stërvitjes luftarakë. Dhe ai ishte përpjekur, kishte bërë prova, kishte dalë mirë, por për patentë ishte ende shpejt.

U zhduk dhe motori i fundit dhe ushtari i fundit. Gazi me radistin dhe aparaturën po qëndronte në vënd dhe të dukej sikur ishte dorëzuar në atë fushë pa anë e pa fund.

«Do ta ngas vetë, pa të bëhet ç'të bëhet! Mjaf-ton që atë ta largoj nga aerodromi!» — tha dhe një të hapur i bëri kabinës e u fut brenda. Ktheu çelësin, shkeli gazin, lëvizi marshet dhe... makina uturiu si një dem i posaçliruar nga zgjedha dhe çau si shigjetë mespërmes aerodromit, pistës, pastaj vrapi i nëpër xhadënë e asfaltuar... Prej së

largu dukej tamam si një makinë sportive që dredhon rrugën me qëllim, që mos t'i dilnin përpara makinat e tjera.

«Mo, po i çmëndur je?»

I kalonin përpara si vizjone lëvizjet e duarve të shoferit dhe... kujtohej nga casti në cast, që të lëvizte marshet, por nga emocioni, në vënd të friksionit shtrëngonte me këmbë frenat dhe makina herë ndalonte si një hamshor dhe pastaj merte përsëri fuqi e uturinte. Të dukej sikur bënte numra shpejtësie duke lënë prapa pluhurin e rrugës, që ngrihej përpjetë nga rrotat. Rruga e drejtë dhe e gjërë e rrethuar anash nga fusha e paanë sa vinte e po ngushtohej, sa vinte e po zvogëlohej, sa vinte e po afroheshin kthesat e panumurta. Atij po i shkonin djersë të ftohta. U mundua disa herë ta zvogëlonte shpejtësinë, por më kot. Nuk dinte. Vepronte mekanikisht. Nuk kishte ngarë kurrë makinë kaq shpejt. Ndërsa tani, sa e nevojshme i dukej kjo gjë! Sa të domosdoshme i dukeshin fjalët e eprorëve të tij! «Çdo ushtar duhet të zotërojë patjetër profesionin e shokut pranë». Mblodhi tërë forcat. Përqëndroi tërë vëmëndjen te rruga e ngushtë, e cila i dukej si një vetëtimë që i afrohej deri sa makina çau përmes xhadesë automobilistike. Tej, tutje larg, shumë larg dukeshin makinat e tjera. Ja një kthesë. U ngjit pas timonit. Mbajti frymën, lëvizi shpejt dorën dhe makina vërshelleu nga fërkimi i fortë që hasën rrotat me asfaltin gjatë kthesës! Mori frymë i lehtesar. Tutje, shumë larg, i vuri re përsëri makinat e repartit të tij. E tërë vëmendja u përqëndrua tek ato. Duhej t'i arrinte! Shtrëngonte fort timonin. Kish frikë se mos i rrëshqisnin rrotat. Oh, sa gjë e vështirë. Jo, kjo nuk

duhet të ndodhë! — dhe u rregullua më mirë në sedilje, dhe shtrëngoi më mirë timonin. Distanca me makinat e tjera po zvogëlohej. Dy kthesa të vogla i mori mirë! Shumë mirë mund të themi, pér një fillestari si ky, që asnjeherë s'e kish ngarë vetë makinën pa një shofer pranë.

Aeroplanët, tutje, uturinin mbi aerodrom. Një kthesë. Shtrëngoi pak frenat. Shpejtësia u ngadalësua. «E mora edhe këtë!» Marshet i harroi fare, nuk dinte se si t'i lëvizte, ose më mirë nuk i kujtoheshin, përkundrazi, kur mendonte pér to, duart i dridheshin në timon. Kështu ish më i qetë, prandaj edhe i harroi. «Ja postoblloku, ja dhe ura! Postoblloku ishte i mbyllur. Përpara tij qëndronte një ushtar, i cili kish ngritur dorën. Semanit as që i vajti në mëndje se makina e tij kishte buri. Ushtar Semani harroi edhe të frenonte pak. E tërë vëmendja e tij tashmë ish përqëndruar te ushtari që i kish dalë përpara kërkonte që ky ta ndalonte makinën e t'i paraqiste dokumentat. Ushtari i postobllokut sikur ndjeu diçka dhe lëvizi që të ngrinte me të shpejtë trarin. Pér një moment, Semani lëvizi timonin nga e majta, pér të shpëtuar ushtarin, pastaj pak djathas pér të hyrë nën trarin tashmë gjysëm të ngritur dhe... s'arriti të veprojë më tepër, makina u përplas pas postobllokut, trarin e së cilës e hodhi tej dhe parafangot u ndeshën në murin e urës, e cila u trondit. Makina qëndroi në vënd. Semani u çorodit fare. E mbledhi veten. Doli nga kabina. Pa ushtarin të zverdhur, që mezi merrte frymë. S'i foli fare! S'kishte c't'i thoshte. Kaloi menjëherë dorën e djathtë mbi ballë! Vuri re një njollë gjaku nă mëngë. Ish goditur pak në ballë. S'e bëri të gjatë, nxori radion, u lidh me komandën.

— Kur nuk di të ngasësh makinën, pse e nget?  
— i tha ushtari i postobllokut, pasi e mori pak veten.  
Seman, pa ia vënë veshin ushtarit të postobllokut, filloi të japë koordinatat e nevojshme. Më në fund, ai raportoi edhe për gjëndjen e tij.

Pas alarmit të gjithë u mblohdhën rrëth postobllokut, rrëth makinës, rrëth ushtar Semanit. Shpejt erdhën hetuesit për të bërë hetimet. Kur ç'të shihnin: Parafangoja e makinës ishte coptuar. Trari i postobllokut përgjysmuar, një pjesë e murit krisur... Semani i plagosur në ballë, me radion te këmbët, rrinte kokëultur.

— C'bëre kështu? Kush të dha leje të marrësh makinën? — e qortoi komandanti i baterisë së tij duke lëvizur sa duart dhe këmbët.

— Ju nuk më dhatë asnje përgjigje...

— Do ta marrësh tashti përgjigjen!...

— Bobo, e piu Semani! — ia pat një shok.

Duke shtyrë turmën, u afrua kontrolli rrugor:

— Patentën! — tha ai.

— S'kam patentë!

— Si? S'keni patentë!?

— Jo.

Kontrolli rrugor ktheu kokën nga komandanti i baterisë, nga ushtarët e tjerë që kishin ardhur. Komandanti i baterisë ishte zverdhur, dhe lëvizte sa në një vënd në tjetrin.

— Ai është radist! — tha një shok i Semanit.

— Pse e more makinën?

— Që të mos ia lija armikut!

— Po shih si e dëmtove, tashti ku të futemi!

— Më mirë kështu, se sa në dorën e armikut!

— More, e kupton se ç'flet? — iu qas një ushtar tjetër pranë. — Tashti kur të lidhim, do ta shi-

kosh! Për ty s'më vjen keq, po për automjetin, për komandantin që do ta pijë!...

— Pse? Ai veproi shumë mirë!

— Se t'u mbyllshin që të dy! — i tha dikush nga fundi! — bëhesh dhe si budalla! Nuk e shikon ç'ka bërë! Do të na marri në qafë të gjithëve.

Semani kthente kokën herë maitas e herë djath-tas. Nuk dinte se si të vepronë. Komandanti i baterisë e priti me këmbët e para. Edhe disa shokë ashtu e pritën. Ktheu kokën nga makina, ajo sikur e tallte me ato xhame të thyera.

— Mirë! Mirë, do ta shohim në repart punën tënde! — u çfry komandanti dhe iku.

«Çdo të thoshte me këto fjalë ai?»

— Hiç, ore, mos çaj kokën për të! — i tha njeri nga prapa.

\*

\*

\*

Ekte rrugës i menduar. Mendime të ndryshme i vërtiteshin në kokë. «C'bëra unë? Unë s'desha që automjeti të binte në dorën e armikut! Unë s'desha që aparatura të binte në dorë të armikut! Unë ... C'bëra unë?» «Se mos ishte me të vërtetë armiku dhe...» «Po sikur të ishte me të vërtetë armiku?» Po ti e dëmtove makinën!» «Së paku ajo nuk ra në dorën e armikut!» «Po t'i s'arrite ta shpinje dot deri te vëndi i caktuar?» «Unë u mundova ta largoja nga aerodromi, sa më larg ta shpija aq më mirë! Arrita tri kilometra, mjafton aq, mjafton që unë u largova nga zona e rrethuar!» «Po ç'të duhej ty kjo lodër? Të thashë njëqind he-

rë, po ti s'deshe të vije mënd!» Për këtë që bëra, e bëra me vetëdije të plotë dhe nuk jam i penduar aspak!» «Po sikur të thyeje kokën?» «Mjafton që unë zbatova urdhërat. Largova aparaturën nga rrëthimi.» «E di ç'ke t'i, mendohu mirë se çfarë do të flasësh para atyre të mëdhenjve, pa me mua bën si bën dhe e gjen një fjalë e ma thua!» — i thoshte njera ndërgjegje. «— Unë të thashë edhe njëherë, që çdo gjë e kam kryer me vetëdije të plotë!» — ia priti ndërgjegja tjetër!

Dhe kështu kokëulur, e me mendimin top vërtitej orë të tëra duke pritur me ankth nga çasti në çast se kur do ta thërisnin për t'i dhënë dënimin e merituar. Ai kish harruar dhimbjen e xhungës që i ishte formuar në mes të ballit, apo të plagës që ende s'i ishte mbyllur mirë. «Unë kam vepruar me ndërgjegje të plotë, prandaj s'kanë ç'më bëjnë!» «Po komandanti i baterisë?...» «Ai nuk e sheh çështjen kështu siç e kam parë unë! Ai ndoshta mendon se makinën e mora unë sa për aventurë!» «Megjithatë, thellë në zemrën time jam i ndërgjegjëshëm!»

— Ushtar Semanin e kërkojnë!

\* \* \*

... Dhe ja tashti koka e ushtar Semanit isn mbështetur në supin e fuqishëm të komisarit.

## MERRMËNI DHE MUA

Çalë-çalë, plaku Selim Gjata u afroa pranë xhadesë për të bërë një copë muhabet me ata udhëtarë, që prisnin ndonjë makinë të rastit për të shkuar kush lart drejt Bulqizës, e kush poshtë, drejt Burrelit.

Era e fortë, që frynte nga Qafa e Bullit, i bën-te këta udhëtarë të ngrinin jakat e palltove e të strukeshin akoma më tepër në vetvete.

— A keni ftotë? — E hapi gojën i pari plaku, duke drejtar trupin dhe këmbën e çalë, dhe duke nxjerrë përpara gjoksin nga jeleku i shkopsitur prej shajaku që kish veshur.

Një zhurmë makine ua preu muhabetin. Ajo ishte plot me materiale dhe me njerëz. Më kot e ngritën dorën nja dy udhëtarë.

— A për lart po shkon? — pyeti përsëri plaku dhe nxori kutinë e duhanit e ua zgjati udhëtarëve.

— U, na fal, — urdhëro e merr nga duhani ynë, se ti këtu na gjete, o xha Selim! — ia bënë dy udhëtarët vëndas, duke nxjerrë kush kutinë e duhanit e kush paqetën «Partizani» — ndërsa ai udhëtarë i tretë, që rrinte si i veçuar, pa u përzier në muhabet, i vështroi një herë me bisht të syrit dhe u mbështoll akoma më tepër duke shtrënguar pardesynë pas vetes.

Një autobuz u kaloi pranë.

— Autobuzi i Peshkopisë! — ia bëri udhëtarë

i parë, — pse s'e ngrite dorën, se mos kish ndonjë vënd.

— Jo, ishte me vullnetarë nga Vlora. — tha ushtari i dytë.

— Aq më mirë! — ia priti i pari.

— A për Peshkopi po shkoni? — pyeti plaku.

— Po, or babë, për Peshkopi! Po shkojmë vullnetarë. — tha i pari.

— Ka ra tërmët i madh! — tha i dyti.

Udhëtari i tretë, ai me pardesy, lëroi pak jackson pér të dëgjuar më mirë se ç'flisnin dy udhëtarët e tjerë me plakun.

Zhurma të çjerra makinash u dëgjuan përsëri.

— Plot me dërrasa qënkan këto! — tha udhëtari i parë dhe ngriti dorën.

Makina e parë nuk ndaloi, edhe e dyta kaloi, makina e tretë ndaloi:

— Për ku? — pyeti shoferi.

— Vullnetarë, pér Dibër! — tha i pari.

— Vetëm një vënd kam! — tha shoferi.

Udhëtari i parë hypi në makinë.

— A ka ba shumë dame tërmëti? — pyeti plaku.

Udhëtari me pardesy hapi më tepër veshët.

— Rreth tremijë shtëpi të shkatrueme! — tha udhëtari i dytë.

— Paska ba shumë dame! — tha plaku.

— Rreth tremijë familje kanë mbetur pa strehë! — u fut në muhabet edhe udhëtari i tretë, ai me pardesy.

Disa «shyta» me thasë çimentoje parakaluan përpara tyre. Të gjitha makinat po shkonin lart, pér nga Peshkopia.

— Ja një makinë pér poshtë! — tha ai me pardesy dhe ngriti dorën.

Makina kaloi me shpejtësi pa u ndaluar.

— Kur do makina, nuk gjen. — tha udhëtari me pardesy.

Disa zetorë u kaluan pranë, fare pranë. Pastaj një varg skodash me trarë, tulla, tjegulla. Të gjithë shkonin për lart.

— Sikur po mbijnë nga dheu tërë këto makina, që po shkojnë për të ndihmuar njerëzit e dëmtuar nga tërmeti, — tha udhëtari i dytë.

Udhëtari me pardesy priste me padurim të gjente një makinë për poshtë, për Burrel. Kish takim me të fejuarën. E kish marë malli shumë për të.

Disa zëra të përziera me zhurmën e motorit të një makine ia tërhoqën vëmëndjen.

Ishin vullnetarë nga Berati. Ishin punëtorë. Dukeshin që posa kishin lënë punën e tyre e po shkonin për ndihmë, se i kishin çizmet me llaç.

— Eh, or bir, më dyzet e njëshin nuk shihje këmbë njeriu e jo makina! — E sa makina, e si, të mbushura plot! — tha plaku posa i kaluan disa makina të tjera me dërrasa, me kompensato, hekura, gëlqere, dollape,...

Udhëtari me pardesy ktheu kokën nga plaku.

«Shyta» të tjera rrëshqitën drejt xhadesë.

U tund xhadeja nga tërë këto makina. Kurrë kjo rrugë s'kishte ndjerë mbi kurrizin e vet kaq makinë, të ngarkuara kaq rëndë.

— E ka marrë në dorë Partia! — tha udhëtari i dytë.

— Jo vetëm Partia, po i tërë populli! — tha plaku.

— Partia dhe populli janë një! — u përgjegj i pari.

Një autobuz rrëshqiti për lart. Përpara kishte një flamur të shkruar: «Vullnetarë nga Saranda». Ish makinë e mbushur me njerëz, me specialistë.

Ja edhe një tjetër me targën BR.

— Janë të Beratit, ja edhe TR., janë të Tiranës; ja edhe KO., të Korçës; ja edhe RE, të Rëshenit, — vullnetarë nga gjithë Shqipëria. — tha udhëtarë i dytë. Makina me targën FR, Fier, ndaloi.

— Për ku?

— Vullnetar për Dibër!

— Hyp!

Në xhade mbeti plaku me udhëtarin me pardesy.

— Po ti, or bir, për ku shkon? — e pyeti plakun, udhëtarin me pardesy.

— Për Burrel, kam marrë lejen...

— Domethënë për pushime, — tha plaku nën dhëmbë dhe nxori çibukun dhe kutinë nga xhepi. E mbushi çibukun me duhan dhe e nguli në gojë, ndërsa kutinë e futi në xhep, pa ja zgjatur shokut pranë për ta ndezur, siç e kish zakon me të tjerët.

Udhëtar me pardesy ndjeu një zbrazësirë në vete: «Tani të gjithë po lenë punët e tyre më të ngutëshme e po venë të ndihmojnë vëllezërit di-branë të démtuar nga tërmeti, kurse unë... Vete për pushime, për...» — mendoi dhe qeshi idhtas me vete.

Disa skoda të tjera të targës KR. Krujë, SH. Shkodër, BR. Berat, TR. Tiranë rrëshqitën përparrë tyre.

— Eh, ç'bën Partia! — ia bëri plaku duke vështruar nga udhëtarë me pardesy, — kur s'e kam në rregull këtë këmbë, — foli përsëri dhe thithi llullën e ndezur me eshkë duke lëshuar tym duman.

Një makinë po vinte nga lart, nga Peshkopia, po shkonte për poshtë, për në Burrel.

Shoferi ndaloi vetë:

— A ka njeri për të hypur? — tha ai.

Udhëtar ynë i tretë nuk foli.

Shoferi luajti marshet dhe ia shkeli gazit. Një makinë e vetme po shkonte për poshtë. Ky vazhdonte të priste. Përsëri shyta me trarë, me hekura, me shtylla betoni, me dyer, me tjegulla, me gëlqere, me tulla, të mbuluara, me njerëz...

— Të gjithë qënkan ngritur për ndihmë! — tha udhëtarë me pardesy dhe ndjeu turp për vetveten.

Plaku thithë llullën dhe numëronte makinat.

— Pse s'hype në makinën që u ndal? — i tha ai.

Një makinë me vullnetarë u kaloi fare pranë.

— Për ku shkon? — pyeti udhëtarë me pardesy.

— Jemi vullnetarë nga Kruja! — u përgjegjën disa punëtorë nga dritaret e makinës.

«Kurse unë jam me pushime!» — buzëqeshi me ironi, — e në të njëjtën kohë ngriti zërin:

— Merrmëni dhe mua, jam vullnetar! — dhe u turr në makinë.

— Po ti je nisur për... — tha plaku, por fjalët ia mori era dhe ai vuri re me habi se makina e mbushur me vullnetarë rrëshqiti për lart, duke marrë edhe atë udhëtarin e tretë.

«Ai u kthyte nga rruga!» — mendoi plaku për udhëtarin me pardesy.

Kujtoi tërmelin që ra më 1941: «As edhe kaq njerëz nuk e kishin shkelur këtë rrugë, e jo makinë! — tha dhe shtriu këmbën e çalë: «Ai la pushimet!» — «Ai u kthyte nga rruga!»... Era vazhdonte të frynte nga Qafa e Bullit: «Ai s'iу trëmb erës, të ftohit, ai u kthyte nga rruga!» — duket sikur i foli erës dhe ashtu si ishte, çalë-çalë, mori tatëpjetë monopatit duke u vikatur berrave që ruan te e duke përsëritur: «Ah, kur s'e kam këmbën e mirë!».

## PLAKA NUSHË

Asnjeri s'e kishte mëndjen tek ajo. Të gjithë gëzoheshin me shtëpinë e re, me dhomën e rregulluar bukur e bukur, me nipin e vogël të posalimbur, dhe tashti me dritën elektrike, që erdhi dhe u fut edhe në këtë shtëpi të këtij fshati të largët malor. Ajo ishte një plakë në moshë të shkuar. Ishte afër të nëntëdhjetave, por mbahej mirë, bile shumë mirë. E dobët, pak e kërrusur, me fytyrën tërë rrudha, me syze nga ato të rëndat, me xhame të trasha. I nipi, Pjetri me të shoqen nuk i kërkonin asgjë, vetëm të rrinte e të kalonte sa më mirë pleqërinë. Por, që kur erdhën dritat, kjo plakë, Plaka Nushë, nuk qëndronte një çast në një vënd, po vërtitej sa andej këndeja, aq sa të tjerët të mendonin se gjëndeja në punë.

Kur dhoma u zbraz dhe ajo mbeti e vetme me foshnjën e vogël të Pjetrit, të cilën posa e kishte zënë gjumi, u ngrit dhe krrusur-krrusur, duke ngjeshur më mirë syzet e rënda mbi hundë, iu afrua dritareve. I preku perdet e gjata prej damasku, i pa me sy: «Sa të bukura!» — tha, dhe i uli poshtë. Dhoma u errësua. Ajo çap-e-çup, ngadalë e ngadalë, si të kryente ndonjë faj të vetëdijshëm, iu afrua murit pranë derës së hyrjes. Qëndroi një copë herë ashtu në këmbë, vështroi anembanë,



«Plaka Nushë».

pastaj zgjati dorën lart dhe, me gishtat e saj të thekur e të hollë preku çelësin e dritës elektrike. E shtypi atë fort për nga lart dhe «hop» drita u ndez. Dhoma u ndriçua. Plaka ngriti kokën lart. Drejtoi trupin. Sytë prapa syzeve me lente të trasha iu zmadhuan shumë: «Dritë! — pëshpëriti dhe «fap» mekanikisht e uli dorën poshtë. Drita u shua: «iku drita!» — tha. E ngriti përséri çelësin lart. Drita erdhi përséri. Plaka, si ta kishte zë-në korenti, e hoqi dorën menjëherë. Sytë i mban-te nga poçi i ndezur elektrik: «Çudi, si ndriçon pa gas! Llambë pa gas, fener pa gas e të ndriçojë kaq shumë?!» — bënte çudi me vete. Padashje, zgjati dorën dhe uli çelësin. Drita u mbyll. Sytë, nga që iu vranë prej ndriçimit të llambës njëqind qirish, iu errën fare dhe nuk panë asgjë. «Fap» e hapi dritën. Dhoma u ndriçua. Buzëqeshi. «Fap» — e mbylli. U mvrejt. Dhe përséri e ngriti çelësin lart. Qeshte me vete. Gëzohej me vete tamam si një çilimi që arriti të shohë në shtëpinë e saj të bardhë edhe dritë. E hoqi dorën nga çelësi i ngritur lart dhe e futi në xhepin e përparëses. S'andejmi nxori një shami të madhe dhe filloi ta fshijë anës çelësin, ku kishin rënë ca pika të vogla sherbet gëlqereje. I pastronte me aq kujdes ato stërkala të bardha gëlqereje, sa më tepër mund të mendoje se e lëmonte, e përkëdhelte atë pjesë vëndi, që e bënte të shkëlgente tërë dhomën.

«Ishin kohëra të errëta atëhere. Në atë errësirë ka jetuar ajo. Në atë errësirë kanë jetuar njërejzit.

Plaka Nushë ishte e re, fare e re. Në moshën 15-16 vjeçare ajo u martua. Ose më mirë të themi e martuan. Si e qysh? Fare e thjeshtë. E nxorën nga një kuvli, ku kishte katër vjet, që rrinte e

mbyllur, dhe e futën në një kuvli tjetër, po të mbyllur, me mure të nxirë, që ndriçohej nga një bish-tuk, i cili lëshonte një dritë të errët me shumë tym. «Prit burrin këtu, se do të vijë, ka shkue me ruejtë berrat!» — i thanë dhe e lanë brënda. Ndoshta përjashta bëhej dasëm, ndoshta jo. Nusha nuk e din-te, ajo e kishte humbur fare. Çdo gjë i kishte ardhur papritur. Një natë më parë e lajmëruan që të bëhej gati, se të nesërmen do ta martonin. Po me kë? — Ajo s'kishte të drejtë të pyeste. Atë e din-nin të tjerët. Tërë atë natë qau në shtëpinë e saj: «Mos qaj, bijë e nënës, se ata të tutë na dhanë një lopë të mirë!» — i thosh e ëma e mbytur në lot, — «Do të jesh më mirë atje... ata janë në gjëndje më të mirë...» Edhe dy motrat më të vogla me vëllaçkon e mezit qanë, tamam sikur të ishin në ditë zie. Ndërsa i ati përdridhë mustaqet. «Pak, shumë pak, pér një lopë? Të na kishin dhënë edhe dy pëlleja, do ishte më mirë!... Kam cucë të mirë unë...» — dhe thithë llullën me etje të madhe. Sa të poshtëruar e ndjeu veten në ato çaste Nusha. Iu duk vetja tamam si një leckë që e hidhje nga të doje, dhe e shitje sa të doje. Ju neverit atë çast i jati. Por më tepër s'kishte q'të bënte. E martuan, e sollën këtu, tek dhëndëri, në këtë dhomë të errët. Ndenji pér një kohë të gjatë ashtu e huttuar siç ishte. Pastaj sikur e mbledhi pak veten. Kujtoi edhe një herë nënën, motrat, vëllanë, — u mallëngjye. Orët kalonin e njeri s'po dukej. Nusha kujtoi hajdutët, që qarkullonin shumë atyre anëve, u tmerrua. Pastaj... kujtoi dhëndërin... Si do të ishte ai? «Kukuuuu! ditën e dasmës me ruejtë berrat! Qenka i ve!...» — u mallëngjye pér vajzërinë e saj, — «Kushedì se si ka me kenë?...»

Po errej. Gjithnjë e më tepër po bëhej natë.

Nusja Nushë ishte shumë e lodhur, por edhe shumë e shqetësuar. Ajo ishte e ndrojtur... desh ta shihte të shoqin. Prit-e-prit, prit-e-prit, kur vonë, shumë vonë, kishte kohë që dielli kishte perën-duar, kishte kohë që nga kthinat e tjera dëgjohe-shin të gërhiturat e njerëzve që i kishte zënë giu-mi, kërciti praku dhe dalëngadalë u hap dera. Një siluetë e gjatë me gunën hedhur krahëve dhe pushkën në dorë u fut brenda. Zemra e nuses Nushë filloj të rrahë me të fortë. Iu duk vajzës sikur ajo siluhetë që hyri brënda, e ndriti dhomën. Hapi systë të shihte më mirë. Po rryma e ajrit, që vërshoi me t'u hapur dera, e shojti flakën e bishtukut prej pishe të ndezur. Errësirë. Në atë errësirë ai hodhi gunën më njerën anë, pushkën në anën tjetër dhe iu afrua asaj. E preku atë. Hoqi velenxën... Ajo e ndjeu: Ai ishte i ri, i pashëm, me mjekër të parruar...

Tej, jashtë shtëpisë, u dëgjuan të lehura qeni, këmborë, blegërima bagëtish... Dikush po i fuste në strangë. U dëgjuan të bërtitura dhe të shara njëriu...

Djaloshi i ri, që posa ishte futur ke nusja Nushë, i dëgjoi këto: u ngrit menjëherë, pa thënë asnjë fjalë, hodhi gunën krahëve, mori pushkën dhe u zhduk si era në atë errësirë. Lehën përsëri qentë. Bariu i shau rëndë.

C'po ndodhte?

Ende nusja Nushë s'po kuptonte asgjë. Asnjë fjalë s'kishte dëgjuar prej tij. Ashtu në atë gjysëm errësirë iu duk i ri, i pashëm, i bukur, — por... asnjë fjalë. Ai iku. «Ku shkoi? Pse s'ndenji?»

Dera krisi përsëri. Nusha po dridhej e tëra në rrobat e gjumit. S'po kuptonte asgjë. U mbulua shpejt-e-shpejt me velenxën me lesh dhije.

— Pse, moj nuse, pa dritë? Pse ke fikur bishtukun moj? — dhe «kaf-kuf, kaf-kuf» — filloi të kolej silueta që hyri brënda.

Nushën e zunë të ngjethura të forta. Hapte sytë. Asgjë nuk shihte. Asgjë nuk kuptonte. I dridhesin leqet e këmbëve, trupi, nofullat. Dridhej e tëra në shtrat. Nuk po kuptonte asgjë.

Silueta e dytë që hyri brenda ndezi bishtukun. Dhoma u ndriçua. Nusha hapi sytë. Pranë saj qëndronte në këmbë një burrë i kërrusur, i rruar, i veshur mirë, që queshte . . . : — U vonova pak,-a,-si thua, — më humbën dy berra! — dhe ashtu siç ishte, pa u xhveshur fare filloi të afrohej. Drita e bishtukut i binte pas kurrizit. Sa më tepër që afrohej pranë Nushës, aq më tepër fytyra e tij zmadhohej dhe nxihej. Ato dhëmbë të rralla dhe të dala jashtë, në atë errësirë, i dukeshin tamam si të ndonjë lugati imagjinar.

Nusha e shkretë e kuptoi që ishte martuar me një burrë të ve, me një plak. Filloi të qajë. Kujtoi hajdutët që qarkullonin atyre anëve dhe qau me dënësë.

— Mo qaj, mo qaj, do jetojmë mirë bashkë! — e përkëdhelte.

Po Nushën s'e mbante vëndi. S'e mbante dheu.

— Errësirë! Ah, errësirë! — kishte bërtitur atëhere. Errësirë, që mos goftë.

Shtrëngoi dhëmbët fort. Mbylli veshët me duar. Platiti dhe qerpikët. Nuk donte as të fliste, as të dëgjonte as të shikonte. Jo, nuk donte! «Jo, jo, mallkuar goftë kjo ditë që u martova! Mallkuar qofshin ata që më martuan! Mallkuar qofshin . . . !»

— Ua, ua-ua! — vikati foshnja e vogël, aty në krevatin pranë. Plaka Nushë u trëmb. Hapi dritën. Sytë e plakës ishin njomur nga këto kujtime të ko-

hës së shkuar. U zgjua nga ai gjumi i rëndë, nga ai kujtim i ethëshëm.

Shpejt e shpejt, ajo e mbloindi veten. Iu afrua krevatit të vogël dhe të ri filloi ta përkundë dhe t'i këndoje ninullën e vjetër foshnjës, atë ninullë që ia këndonte dikur Markut, birit të saj, që e rriste me aqë mundim. Ua nguli sytë pelenave të bardha dhe të buta, që kishin mbështjellë foshnjën e vogël, zgjati dorën e saj të thekur, që i dridhej nga pleqëria, dhe e mbuloi me kuvertën e vogël dhe të butë. Pastaj rrëshqiti vështrimin drejt asaj fytyre të vocër-e-të-vocër, pa e ndërprerë ninullën e saj të vjetër, ndërsa foshnja e vogël hapi dhe mbylli nja dy herë sytë, platiti nja dy herë buzkat e vogla dhe e zuri gjumi.

Plaka Nushë, humbi përsëri në kujtimet e kohës së shkuar:

«Ndonëse i shoqi pak i shkuar nga mosha, pak i çalë, Nusha vendosi të jetonte me të. S'kishte ç'të bënte. Duhej t'i nënshtrohej kohës, kanunit. I shoqi nuk ishte aq i keq. Ai ishte një bari i thjeshtë dhe i mirë, që s'ngatërronte punë. Flinte më tepër në mal se sa në shtëpi. Vinte nga një a dy herë në javë në shtëpi. Vinte natën dhe natën ikte. Vetëm në dritën e bishtukut e kishte parë Nusha atë. Vetëm në dritën e bishtukut e niihë. Atij të gjorit i kishte vajtur ters me gratë. Ishte martuar me dy, dhe të dyja giatë lindjes i kishin vdekur. I vdiqën me gjithë fëmijë. E para para dymbëdhjetë vjetësh, e dyta para tre vjetësh.

Edhe Nusha mbeti shtatzanë. Erdhi dita që e futën brënda në qilar dhe e lanë vetëm. I filluan dhimbjet e mëdha, të prerat e forta të barkut. Arriti sa të mos lëvizë dot nga vëndi. Filloi të bërtasë me të madhe, të kërkojë ndihmë. Ishte e vetme

në atë qilar të zymtë e të errët. Tej, në kthinat e tjera, sikur të ishin të zbruzura fare, qëndronin burrat e tjerë të shtëpisë, me gojën kyçur, duke mos i lënë gratë e tyre t'i vinin në ndihmë Nushës lehonë. U errësua, u bë natë. Nusha përpëlitez e vetme në atë dhomë të errët, të palyer kurrë, në atë qilar bagëtish. Përpëlitez nën flakët që lëshonte bishtuku. Nga dhimbjet e mëdha filloj të shkulë edhe flokët, filloj të bërtasë, të cirret, të kërkojë përsëri ndihmë. Por më kot, njeri në ndihmë nuk i vinte. Ata që ishin pranë, që e dëgjonin, rrinin të heshtur si sfinks, me gojën e kyçur, në kthinat e tjera.

Më në fund, pas disa orësh, pushuan klithmat therrëse, u dëgjuat vetëm dënesa e vazhdueshme, më tepër nga dëshpërimi, që ishte fillikat e vetme, se sa nga dhimbjet e mëdha. U dëgjuat një e virrur fëmije. Flaka e bishtukut vazhdonte të nxirrte tym gjithnë e më tepër.

Nusha lindi. Ajo s'ishte më në vete. Foshnia qanë. Njerëzit në kthinat e tjera dëgjonin, heshtnin dhe thithnin llullat e tyre të gjata.

Fëmija vazhdonte të qante. Lehona e mbledhi veten. Lëvizi pak nga vëndi. Ktheu kokën nga foshnja. E preku atë me dorë. «Dialë!» — pëshpëriti — dhe nië ndjenjë gëzimi pëershkoi fvtvrën e sai. U zvarris edhe pak dhe e mori foshniën në duar. Po ku ta vinte? Me se ta mbulonte? Ajo s'kishte asgjë përt të. Flaka e bishtukut tvmoste cilarin sa andei këndet. Ajo u ngrit, e me mundime shumë të mëdha, mori ca gjethe të thata, që i ruanin përi një dhi me këmbë të thyera, dhe ia shtroi mbi rrogoz fëmijës, ndërsa me gjirin e saj e mbuloi.

Të lehura qeni, tinguj zilesh, të kollura, ca të shara, — u dëgjuan në oborr.

— Erdhi, shyyqyr që erdhi! — u gëzua Nusha.  
Do t'i jepte sihariqin të shoqit, se kishte lindur  
djalë. Se i shoqi i saj deshte, si të gjithë të tjerët,  
djalë.

Kur, ... një krismë, një pushkë ... një klithmë:  
«Më vranë të mallkuarit!» Nusha, ndonëse me dhimbje  
të forta dhe me fëmijën në gjji, u ngrit menjëherë  
e doli te dera. Ç'të shihte? Një hije me gunën he-  
dhur krahëve dhe pushkën në dorë po hidhte çapet  
me të shpejtë, po ikte. Ndërsa pranë hyrjes, në stru-  
ngë, ndodhej i shtrirë, i zhytur në gjak, i shoqi i saj.  
Hasmi e kishte qëlluar prapa krahëve në shtëpi të  
vet.

Dhimbje të tjera. Lot të tjerë.

Lehona Nushë mbeti e ve.

Koha dhe kanuni i thanë Nushës, që të martohet  
me nipin më të madh, pasi tre kunetërit e tje-  
rë, që kishte kjo grua, ishin vrarë si edhe i shoqi  
për punë giaku. E kishin trashëgim prej tre bre-  
zash hasmërinë.

— Jo! — tha Nusha. — Vetë do ta rris djalin tim.  
Vetë do ta ruaj nderin tim. Vetë do ta marr hakun  
e burrit tim.

Rrëmbeu pushkën e të shoqit në njerin krah dhe  
foshnjën në krahun tjetër e filloj të punojë. I vu-  
ri gardh kthinës së saj. U nda nga nipërit dhe kuna-  
tat e tjera.

Atëhëre njerëzit, kohët, zakonet e quajtën atë  
«grua të përdalur».

Me dhimbje të mëdha Nusha e duroi edhe këtë  
nofkë të ndyrë. Ajo rrropatej natë e ditë duke pu-  
nuar për ta rritur djalin e saj, duke mos e lëshuar  
për asnjë çast edhe pushkën. Edhe kur i këndo-  
nte ninullën djalit të vogël, ia këndonte me pu-

shkën në krahë, sepse me të donte ta ruante djalin e vogël, me të donte të mbronte nderin e saj, dhe më vonë me të donte të merrte gjakun e të shoqit.

Një natë, në mes të natës, kur nënën dhe birin i kishte zënë gjumi, u dëgjuan këmbë të lehta dhe kërkëllima e derës që u hap. Rryma e ajrit që hyri brënda e shoiti menjëherë flakën e bishtukut. Errësirë. Nusha dëgjoi. Hapi sytë. Në atë errësirë silueta hodhi gunën në njérën anë, pushkën në anën tjetër dhe iu afrua. Ajo e ndjeu atë: ishte i ri, i pashëm, me mjekër të parruar. E njuhu. U drodh. «Ah, përsëri erdhe, o i poshtër, edhe tashti, pas vdekjes së tim shoqi do të hakmerresh?...» Priti dhe pak, mos kushedi i dëgjonte zërin... Por, jo! Ai u përkul dhe zuri të tërheqë velenxen me lesh dhije... dhe ... një krismë, një pushkë. Silueta ra thes në tokë.

Ishte krisma e pushkës së Nushës. Nusha që-lloj dhe vrau hasmin e të shoqit, por më parë hasmin e saj, i cili desh ta poshtëronte që natën e parë të martesës. Njerëzit e quajtën burrmeshë, burneshë të maleve, sepse ajo kishte vrarë hajdutin më të tmerrshëm, hasmin më të ndyrë.

Megjithatë, ajo nuk u gjëzohej këtyre lëvdatave. Ajo shikonte Markun e saj të vogël, se si ta rritëte sa më parë e sa më mirë. Ajo nuk e linte për asnjiçast vetëm. I mësonte parmëndën, sqeparin, pushkën. E ruante atë, sepse përsëri ia kishte frikën hasmit, djalit të hasmit të parë Nik Markut, që ishte moshatar me Markun e saj. Dhe Marku hidhte shtat më tepër. Baluket filluan t'i bien nën sy. Sa vinte bëhej më i gjatë, më i bukur, më punëtor. Erdhi dita dhe Nusha u gjëzua. E martpoi

Markun e saj me një vajzë shumë të mirë, ashtu siç ia donte e bardha zemër. U gjëzua akoma më tepër kur nusja e Markut mbeti shtatzane. I bu-zëqeshi fytyra, kur mori vesh se nusja i lindi djalë, dhe s'mbahej dot sa t'i jepte sihariqin Markut e ta gjëzonte. Rrinte së bashku me lehonën dhe, nga çasti në çast, hidhte vështrimin nga dera, se mos vinte Marku, ndërsa lehona, nga humbja e tepërt e giakut, ndodhej në agoni. Kur ja, prej së largu çatisi dhe Marku. Po vinte me të shpeitë për të marrë sihariqin. për të parë frutin e tij, foshnjën e vogël. për të puthur nënën dhe nusen e tij, por... nië krismë, një pushkë dhe Marku ra i vrarë përtokë.

Nik Marku s'kishte harruar. Ai ishte rritur me urrejtiën ndai Nushës. që i kishte vrarë të iatin. Dhe ai priti rastin më të volitshëm për t'u hakmarrur kundrejt Nushës. duke e qëlluar të birin nikërisht në castin më të volitshëm, kur Marku e kishte humbur mëndien pas gruas, pas foshnjës...

Dhimbje dhe lot. Nusia e Markut ca nga humbia e tepërt e giakut. ca nga dhimbiet për të shocin, ca nga që s'e kishte mëndien njeri tek aio. vdiq, vdiq duke lënë fëmijiën në duart e Nushës. Përsëri Nusha mbeti e vetme. E vetme, vetëm me Pjetrin e vogël.

Nusha vazhdonte ta rritëte dialin. Vazhdonte t'i mësonte parë mëndën, saëvarin dhe pushkën. Pushkën... por jo për t'u mbrojtur. por për t'u hakmarrë, për të vrarë hasmin. Nik Markun, ose të birin e tii. Dhe Pietri filloi të rritej, të hidhte shtat, të bëhei i bukur. punëtor...

Vitet shkonin. Nusha dalënsadalë no thvhei. Aio kulla e Nik Markut. maië atii shkëmbi, ia nxinte, ia steroste gjithnjë e më tepër jetën.

«Hakmarrje!» — thërriste zemra e Nushës. Desh tē hakmerrej dhe me këtë frymë po e rriste Pjetrin e vogël. Të hakmirrej, ta shuante fare atë farë. Ta mbyllte fare atë derë!

— Nënë Nushë, do tē dal kaçak! — i tha një ditë Pjetri.

— Po gjakun pa marrë kujt do t'ia lesh?

— Jo, nënë, gjakun nuk e harroj unë, pér tē do tē dal kaçak. Do tē dal e t'i vras tē gjithë hasmit, me qëllim që tē mos kemi më gjak midis nesh, mos jetojmë më me frikë, mos...

Gjyshja Nushë habitej nga këto fjalë. Këto gjëra nuk i kuptonte shumë. Por mëndja ja mirte, se i nipi, Pjetri, po u përgatiste ndonjë kurth tē madh atyreve tē Nik Markut, që t'i çfaroste me soj e sorollop. Do t'i çfaroste tē gjithë, sepse i nipi kishte tē drejtë; ai do tē mirte hak pér babanë, që s'arriti ta shohë, pér nënën, që s'arriti ta gëzojë, per gjithë vuajtjet e gjyshes së tij...

Dhe ja, Pjetri filloi tē vijë rrallë e tek në shtëpi. Kur vinte, vinte i lodhur, i uritur, i grisur, sikur vinte nga ndonjë betejë. Gjyshja Nushë i ndizte zjarrin, e arnonte, e ushqente dhe e përcillte. Kur dilte te dera e yshtëte: — Akoma s'e more gjakun?

— Së shpejti, nënë! —i thosh i nipi.

Në ato çaste sikur ngrohej më tepër zemra e Nushës — dhe e përcillte Pjetrin me lot ndër sy, duke i uruar rrujan e mbarë.

Vitet ndiqnin njëri tjetrin. Toka po shkundëte kurrizin e saj. Djemtë e kësaj toke nuk mund tē duronin më. Krisma pushkësh oshëtinë maleve. E tërë djemuria e fshatit u ngrit në këmbë e doli malit. U ngrit dhe doli malit edhe i biri i Nik Markut.

— Atje ka me ja marrë gjakun ma mirë! — u gëzua Nusha.

Filloi të vijë më dëndur Pjetri në shtëpi. Kur vinte tani, nuk vinte më vetëm, por me disa shokë që kishin kapa me yll në ballë. Vinin natën në shtëpi dhe natën iknin. Zemra e Nushës rrihte më tepër:

— Kanë thanë, se ai i Nik Markut ka dalë malit, — a e ke pa? — ia hidhte si anash fjalën Pjetrit.

— Mos u ban merak, nanë, edhe pak dhe s'do të jemi ma hasëm me asnjeri.

Nusha qetohej dhe e puthte nipin.

Një natë tjetër në shtëpinë e Nushës erdhën disa njerëz të çuditshëm me qylafe në kokë, dhe në qylafe kishin rrasur nga një zhgabë të zezë. Ata kërkuan Pjetrin. Po atë nuk e gjetën. Se si, ndërmjet këtyre njerëzve, Nushës iu duk sikur vuri re edhe atë të bajraktarit, se i shëmbëllente shumë fytyrës së tij. E kishte fytyrën të skuqur si lafshë gjeli kaq i egërsuar ishte tamëm si i ati dikur, kur i rrëmbeu në shtëpi të nënës lopën e vetme dhe dy gicat, nga që s'kishin para të paguanin tak-sën që u takonte... Pasi s'e gjetën Pjetrin, se po ta gjenin do ta vrisnin, siç dëgjoi Nusha nga ata, rrëmbyen c'gjetën brënda dhe ikën.

Nusha afrohej pranë frëngjive të kullës së saj dhe dëgjonte krismat e pushkëve, se mos kushedi dëgjonte atë të Pjetrit të saj. I shëmbëllente shpesh, si krisma e pushkës së tij dhe menjëherë zgjatte kokën nga frëngjia të shihte andej nga kulla e Nik Markut. Por asgjë. Filloi të ndjejë se toka po ziente nga poshtë. Shikonte të nipin, Pjetrin, kur vinte në shtëpi, që nuk e mbante më atë dyfekun e gjatë, por një më të shkurtër, më ndryshe. Krahëqafë kishte hedhur gjerdanët e mbushur me fishekë. Në

brez i vareshin bombat. Pjetri këto vitet e fundit kishte ndryshuar shumë. Qimet e faqeve i ishin nxirë. Zëri i ishte trashur. Shokët, me të cilët ai vinte në shtëpi, nuk i flisin më në emër, por «shoku komandant». Para syve të gjyshes nipi rritej e rrитеj, aqë sa ajo nuk guxonë më ta yshtëte: « a e vrave hasmin?», tashmë ai e dinte vetë këtë punë.

Një ditë, ditë të bardhë, kur dielli ndriçonte si një saç i madh tërë vëndin, gjyshes-Nushë i vjen Pjetri në krye të një çete.

— E vramë hasmin, nënë! — i tha, — dhe e përqafoi, e puthi, gjyshen e tij. — Tani fli e qetë.

Nusha e shihte Pjetrin, dhe desh dhe s'desh t'i besonte, dhe gëzohej dhe qante. Qante nga gëzimi. Me siguri i nipi në krye të kësaj çete do ta kishte çfarosur tërë farën e hasmëve të saj. Prej sa kohësh e kishte pritur këtë ditë! Me të shpejtë hyri brënda në dhomën e sipërme për të marrë diçka për miqtë. Dhoma e nxirë, bishtuku i varrur në mur sikur i diktuani diçka. Zgjati kokën nga frëngjia drejt kullës së Nik Markut, s'pa asgjë atje që t'ia gëzonte shpirtin. Akoma s'e ka marrë gjakun!» — pëshpëriti me vete dhe u trondit thellë.

Nusha qëndroi në vënd e menduar. U kthye. Vajti në dhomën ku pinin burrat. Në krye qëndronte Pjetri. Pranë tij, një djalosh i pashëm, i bukur, me cullufet e rëna mbi ballë... — Po pinin e po trengonin qyfyre.

— Hajde, teto Nushë, hajde këtu, jemi miq tashtri. Kemi pirë gjak nga njeri tjetri në luftë, së bashku me Pjetrin. — I foli ai djaloshi që rrimit te pranë nipi të saj.

Nusha kishte shtangur në vënd. Hasmi i kishte ardhur në shtëpi. Ndërsa Pjetri i kishte thënë se e kishte vrarë atë me soj e sorollop. Nusha qëndroi

si një statujë merméri në këmbë, pa folur fare. E vështroi djaloshin e Nik Markut në sy: «Ky e ka radhën tashti!» — mendoi, — «Po ç'ti bëj, se më ka ardhur këtu!»

Ndërsa djaloshi i Nik Markut ishte aqë i qetë, pinte e bënte bromp me të gjithë, e sidomos me Pjetrin, tamam sikur të ishin miq për kokë.

Dikush iu afrua Nushës:

— Nëna Nushë, e çliruam atdheun. I dëbuam armiqtë. Tashti zotër të kësaj toke jemi vetë! Si thua?...

Nusha, pa folur, e pa në sy, pastaj e heshtur ktheu kokën nga djaloshi i Nik Markut.

— Eh, moj nënë, sa shokë na janë vrarë në luftë, sa të afërm kemi humbur! U tundën malet, po ne fituam. Fituam gjithshka, fituam lirinë. Edhe ai bajraktari na e mori të keqen.

— Po, bir, po, — dhe sytë i mbante nga ai djaloshi i ri i Nik Markut, — që qeshte dhe gëzohej së bashku me Pjetrin e saj.

\* \* \*

Pjetrin e bënë të madhin e fshatit. Njerëzit vinin nga vëndet përreth dhe mirnin mëndjen e tij. Plaka Nushë çuditej. Pjetri ende nuk kishte marrë gjakun e të jatit dhe njerëzit e nderonin, nuk e shanin, nuk i mbanin mëri.

Një ditë, Pjetri mori sqeparin, mori ca drurë, i gdhëndi mirë e mirë ato, bëri katër këmbë, mbi to vuri katër dérrasa. «Tani fli në krevat, nënë!» — i tha asaj. Iu duk gjë e madhe Nushës ky krevat prej dérrase dhe ky dyshek i mbushur me

kashtë. Iu shkrinë kockat në të, por megjithatë Nushës nuk i ngrohej zemra.

Dalëngadalë Pjetri bëri një shtëpi të re, me dhoma të bardha, me dritare të mëdha dhe të shndritëshme, në vënd të bishtukut vuri llambën me vajguri, por të gjitha këto nuk ia ndrisnin shpirtin Nushës. Hakmarrje kundër hasmit donte ajo. Prandaj dhe dhoma i dukej e nxirë. Kjo zbrazësirë në shpirtin e saj ia kishte cfilitur zemrën.

Erdhi dita që Pjetri u martua. Mori një vajzë shumë të mirë, të sjellshme, që i rrinte në këmbë Nushës. Por Nushes ftyra nuk i queshte. «Nuk mori hakun Pjetri, jo ta marrin nipërit!» — thosh me vete dhe prandaj nuk i gézohej shumë, nuses. Dhe këtë ajo nuk do t'ia falte kurrë Pjetrit. I vinte maraz, pse ai i Nik Markut të shkonte e të vinte në shtëpi të saj si pa gjë të keq; të dilte e të bridhë te rrugeve pa frikë sa të donte e kur të donte!

«Do ta marr gjakun vetë!» — iu tipos në mendje Nushës. Vajti në dollap, s'andejmi mori pushkën e Pjetrit. «Sa e rëndë është e mallkuara!» — Ajo kishte harruar se ishte plakur shumë. Me vështirsi e hoqi nga dollapi dhe, duke u driahur, u afroa pranë dritares. Hapi dritaren dhe e vuri në pozicion. Vuri syrin në shinjestër dhe mati... Sytë iu errën, nuk shihte gjë. Nuk shihte dot nëpërmjet shinjestrës kaq larg. Turbull i dilte përpara. «A» — tha, — u verbova. Nuk mund të rrinte. Nuk mund të shihte. Iu tipos në mendje që me të vërtetë u verbua. Harroi dhe pushkën në dritare e filloj të bërtasë: «Nuk shikoj, u verbova!» — «Bëni derman për mua!» Kur kishte ardhur Pjetri dhe kishte parë pushkën në dritare, ishte trëmbur: «Ç'do këtu kjo?» E kishte parë se ishte e zbruzur, e mby-

llur. Mori çelësin, vajti në dollapin e vogël, ku i kishte fshehur fishekët, i numëroi. I dolën tamam. Pastaj, ktheu kokën nga plaka dhe qeshi me vete:

— Nuk shikoj nga sytë, bëm derman! — kishte bërtitur plaka në atë çast.

Pjetri i solli doktorin. Doktori e pa plakën. I dha gjyslyke. Plaka nuk i besonte doktorit, po gjyslyket i mbajti se me to shihte shumë mirë.

Një ditë, kur Nusha ngjitej nga qilarë për në dhomën e mirë, veshët i dëgjuan një lahitë mësue, dëgjoi një rapsodi për kaçakët e dikurshëm. Hapi veshët të dëgjonte më mirë. Pjetri me nusen s'po i flisnin fare. Plaka i nguli sytë në atë valixhe të vogël nga dilte zëri.

— Ç'është kjo? — pyeti.

— Radio, nënë!

— Radio? — përsëriti ajo duke vështruar me habi duart e Pjetrit që lëviste herë sumbullat, e herë shtypte sustat — dhe radioja herë këndonte, e herë fliste... Pjetri kishte blerë një radio me bateri. Kur plaka mbetet vetëm, i afrohej radios dhe shtypte fort sustën e mezit. Radioja fillonte të këndonte, të fliste. Plaka dëgjonte herë muzikë, herë këngë dhe kur dëgjonte daullen apo piskamën e çiftelisë, atëherë hapte veshët më tepër, si një njeri i etur për diçka.

Kaluan vitet. Rruga automobilistike hyri brënda në fshat. Pjetri e shpuri plakën Nushë edhe në lokalitet. Atje ajo ishte habitur: Sa njerëz që kishte! I ishte marrë mëndja. Dhe kishte kërkuar të ikte menjëherë. Po ama kur mbeti për të tretën herë shtatzënë nusja e saj, ajo vetë vendosi ta shpinte në maternitet. Dhe vetë e shpuri. Kur po kthehej me makinë, së bashku me Pjetrin, në sediljen pranë

ishte ulur një burrë i moshuar me ca mustaqe të mëdha:

— E, teto Nushë, si dukesh, a mbahesh nga pakë! Edhe me makinë u bë fshati ynë!

Nusha ktheu kokën nga ai. Sikur i shëmbëlleu me dikë.

— Mos je ti Nik... Marku...?

— Po, teto, ai i téri jam!...

Nusha u thartua dhe u kthyë nga ana tjetër e sediljes.

Shoferi po shikonte me bisht të syrit.

— Ah-ha-hahaha! — kish qeshur Nik Marku, akoma s'i ke harruar ato, teto?

— E, o Nik Marku, teto Nushën e kemi me të vjetrat...

— Me të vjetrat, me të vjetrat, po sot vetë e shpuri nusen në maternitet.

Plaka Nushë e gjeti veten ngushtë.

Kur arritën në shtëpi, plakës iu hodhën dy fëmijët në qafë, njera pesëvjeçare dhe i dyti trevjeçar.

— Erdhi gjyshja, erdhi gjyshja nga materniteti! Ç'na ka sjellë gjyshja nga materniteti! — gëzohe-shin fëmija.

Plaka i mblođhi të dy fëmijët si një klloçkë e mirë dhe u dha nga dy karamele. Ata i muarrën, e puthën gjyshen dhe filluan të lozin. Kur shihte ni-përit e saj të vegjël se si luanin, i kujtohej Marku i saj i vogël, jo i qeshur, por i menduar, që i rrinte mëndja te hasmi, te gryka e pushkës, te frika.

Ditët e fundit, pasi kishte ardhur lehona në shtëpi, plaka Nushë kishte vënë re, se të gjithë njerëzit ishin mobilizuar shumë, punonin shumë. Ngado që të ktheje kokën në fshat, do të shikoje shtylla betoni që ngriheshin sa në njerin vënd në tjetrin. Erdhën disa njerëz në shtëpi me vegla në dorë dhe shpuan

tavanin. S'andejmi varën një lëmsh të vogël. Plaka Nushë vetëm shikonte dhe heshtëte. Kur ai lëmsh i vogël u ndez dhe ndriçoi tërë dhomën, plaka Nushë u habit fare dhe harroi t'i heqë sytë nga llamba elektrike. Në ato çaste mollëzat e faqeve filluan t'i njomen. Njeri nga elektriçistët bëri shaka me të. Por ajo në këto çaste nuk ua kishte ngenë shakave. Ajo kujtonte ditët në mes të errësirës. Nuk, dinte kujt t'i gëzohej më parë: fëmijës së posaardhur nga materniteti apo dritës?»

\*

\* \*

Foshnjën e kishte zënë gjumi prej kohësh. Plaka Nushë nxori shaminë e madhe nga xhepi i përparrëses dhe fshiu sytë. U ngrit përsëri, u afroa pranë çelësit. E uli poshtë: u mbyll drita. «Errësirë!» — tha ajo.

U hap dera. Hyri Pjetri me nusen.

— Pse s'ka dritë? — pyeti Pjetri.

Plaka Nushë ndezi dritën vetëtimthi.

Pjetri me të shoqen u vështruan sy më sy. Vështruan edhe plakën, atë fytyrë të dashur tërë rrudha dhe pa gjak, me syzet e rënda ngjeshur mbi hundë. Qeshën njeri me tjetrin.

— Gjithë jetën e saj ka jetuar në errësirë, dhe tashti drita për të është revolucion, — tha Pjetri dhe shkoi të hapë perdet.

## UNË JAM E LIRË

— Mirëse rrini, bre burra, a jeni si jeni? — i përshëndeti një grua, që hyri brenda në dhomë.

Të gjithë u ngritën në këmbë dhe e përshëndetën, duke i dhënë dorën dhe duke i zgjatur kokën sipas zakonit për t'u qafuar.

— Urdhëroni, uluni këtu! — e ftoi të ulet arë-simtari, që ishte në krye të vëndit.

— Ou, paskeni ardhur edhe juve sonte këtu?

— Ashtu menduam, ... urdhëroni e uluni këtu ... — përsëriti mësuesi.

— Jo, ai është vëndi i miqve ...

— Po ju jeni më e vjetër, pastaj jeni grua dhe gratë ...

— Kush thotë, që unë jam grua, unë jam burrë. Jua kam thënë disa herë që jam burrë!

— Merreni radion e shpjereni nga dhoma tjetër, që ta dëgjoinë gratë e fëmijët! — desh të shpëtonte nga kjo situatë arësimtari.

— Jo, bre burra, duem me e ndëgjue edhe na ...

— tha ajo, posa zuri vënd jo në krye, po përballe vatrës.

— Arësimtari ka të drejtë, muzika po na e prish muhabetin, kur të vijnë lajmet, ahtere u themi që ta sjellin prapë radion! — e përkrahu arësimtarin

i zoti i shtëpisë, një plak rrëth të shtatëdhjetave —  
dhe në të njëjtën kohë urdhëroi një fëmijë që ta  
shpinte në atë dhomë radion.

Lica e pa atë, plakun, i shkeli syrin dhe tha:

— Mirë, po qe ashtu, ashtu e lamë! — dhe ia  
shkeli përsëri syrin plakut. Pastaj pasi u rregu-  
llua mirë në vënd, nxori kutinë e duhanit dhe fi-  
lloji të dredhë me radhë disa cigare, duke cakari-  
tur sytë, duke buzëqeshur dhe duke hapur veshët  
me qëllim që të mos i shpëtonte asnijë fjalë.

Të tjerët vazhdonin muhabetin.

— Urdhëro e merre një duhan Shkodre! — dhe  
ia hodhi cigaren arësimtarit të parë, të dytë. dhe  
pastaj miqve të tjerë me radhë, që kishin ardhur.  
Ndërsa vetë nuk e ndezi.

«Tamam burrë, me brez të kuq, me shallvare,  
me kuti duhani, me lëvizje të shkathëta, brisk nga  
goja!» — mendoi arësimtar i ri pasi mori cigaren.

— Urdhno e ndize! — ia zgjati dorën ajo me një  
çakmak prej gëzhoje plumbi, që u ndez me një të  
shkrehur.

— Ndizeni më parë vetë!

— Unë nuk e pi!

— Pse? Ju mbani...

Ajo u pre në fytyrë. E pa me vërejtje arësim-  
tarin. Ai u drodh. «Mos fola keq?» — mendoi.

— Silleni atë radio këtu, se tash vijnë lajmet!  
— e ndryshoi aty për aty fjalën ajo dhe nxori orën  
e xhepit nga qosteku si qëmoti.

Sa dha urdhër ajo, radioja u ndodh në dritare.

— Pse, or mec, s'ma dhe në dorë, arësimtarët  
nuk na shajnë po e preka unë, ata prandej e kanë  
sjellë, me e ndëgjue na, — dhe u ngrit me shkathë-  
si e u afrua që ta marrë. Po në këtë çast kumbuan  
tingujt e radios për të treguar orën e saktë.

Ajo përsëri e nxori orën dhe hapi kapakun:

— Tamam sipas radios e kam, — asht orë e mirë kjo! — dhe ngriti kokën për ta marrë radion. Po sytë i ndeshën në një pasqyrë të madhe, të varur në murin pranë dritares.

— Ej, sa përpëra paskan shkue këta nipnit e mij, edhe pasqyrë paskan ble, e çfarë pasqyre se?! — e filloj të shihet në të.

Në atë çast filluan të jepen lajmet:

«... Jam një malësore matjane, që kam ardhur e po flas këtu nga tribuna e kongresit të gjashtë! Desha të vija ndryshe, — si të them — e veshur ndryshe, — ashtu siç visheshin dikur burrat, burrat tonë malësorë, — se ashtu desha të bëhesha edhe unë! — Mund të pyesni ju, se ç'gjë të keqë ka këtu? — Po ju përgjigj! Desha të vija edhe unë brezin e kuq, desha edhe unë të qethja kokën, desha edhe unë të mbyllesa në shtëpi, të bëhesha djalë i shtëpisë, burri i shtëpisë, pasi prindërit e mij nuk kishin djalë. Pra unë të mbyllja vajzérinë time në shtëpi! Të mbetesha virgjëreshë e pérherëshme! Por... unë...»

Lica mbylli sytë. Fjalët, tingujt e radios e goditën në kokë, në zemër. Ajo, Lica, se ç'kujtoi në këto caste. Mësuesi e vuri re. Të tjerët dëgjonin lajmet. Çdo tingull i zërit të asaj malsoreje nga tribuna e kongresit të gjashtë të grave i zbulonte Lices diçka, e shpinte Licen diku vite e vite më parë. E shpinte në ato vite kur ajo ishte e vogël, ishte e re. E shpinte në atë moshë kur ajo ishte dhe s'ishte e zonja të thoshte fjalën e saj, të shprehte dëshirën e saj. Në atë moshë kur ishte niomzake e bukur; në atë moshë, kur nga frëngjité e një kulle pranë rrugës ku kalonte, dëgjonte diçka, një zë djaloshi.

Ajo ultë kokën dhe shpejtonte hapin, se kishte turp.

— Licë, këtheji një herë sytë këtej, se ma more shpirtin! — i tha një herë ai.

Tëk-tëk bëri zemra e Lices, kur dëgjoi zërin e tij, e Limit.

Lica i ktheu sytë nga ai.

Licës i mbeti zemra te ai.

Lica u dashurua me atë.

Dhe fshehurazi të tjerëve, kjo vajzë dhe ky djalë filluan të thyejnë zakonet, të takohen dhe të thurrin plane, plane për të ardhmen.

Por yshta të ndryshkura filluan t'ua coptojnë zemrat këtyre të rinive. Limin, pa dashjen e tij, e fejuan me një vajzë shtatë vjet më të madhe se vetja e tij, e fejuan me një vajzë që ai s'e njih-te fare.

Lica ishte vaiza më e vogël e shtëpisë. Ajo vëlla nuk kishte dhe prandaj «djalë i babës» — e quante i ati. «djalë i nanës» — i thërriste e éma.

Erdhi koha për martesë.

Limi desh të thyente zakonin, kanunin, desh të rrëmbente Licens dhe të iknin.

Ndërsa Lices prindërit i thonin:

— Ty të kemi djalë, ty të kemi vajzë, ty të kemi burrë! Ti s'do të na lesh vetëm si qyqarë!

Lices iu nda zemra më dysh.

Më njerën anë prindërit, në anën tjetër Limi. Më njérën anë «Mec i babës!» dhe «Mec i nanës!», në anën tjetër përsëri Limi. Më njérën anë zakoni, kanuni, në anën tjetër dashuria, Limi.

Limi i bëri shenjë Licës. Meci me cucën u takuan në një natë të kthjellët, me qiellin plot yje.

— Eja të ikim, Lice!

Atë çast Lices iu kujtua baba, iu kujtua nana, se dhe babën ajo e desh, se edhe nanën ajo e desh.

— Jo, nuk mundem, nuk mundem me lanë babën, nuk mundem me lanë nanën, unë jam meci i shtëpisë!...

— Ti nuk më do, Lice!

— Unë, Limi, unë...

Lica uli kokën dhe qau.

\*

\* \* \*

Anembanë lajmi mori dhenë se Lica preu flokët, theu zemrën e saj; se Lica vuri brezin e kuq në mes; se Lica u bë djali i shtëpisë; se Lica nxiu jetën e saj.

Limi e deshi shumë Licen. Limi kursesi nuk e desh atë që nuk e njinte. Prandaj ai u ngrit më të fortë. që të hakmerrei, po kundër kuit?

I dukej sikur të gjithë pleqtë e fshatit po e përpinin, po e futnin në dhe të gjallë. I dukej sikur edhe prindërit e tij ishin të tillë, sikur edhe prindërit e Lices ishin të tillë, se ia nxinë jetën asaj. I dukej sikur ata zgjatnin duart me ato gishta të thekura e thonj të paprerë dhe po ia ngulnin në grykë.

Desh të kërkonte drejtësinë, po ku? Desh të merrte pushkën e të vriste, po kë? Prindrit e tij?! Prindrit e saj?! Të gjithë katundin ?!

E la edhe pushkën. E hodhi pushkën Desh të bënte dicka tjetër. Në atë vënd, me ata nierëz, me ato zakone, jo, kurrsesi ai nuk mund të rrinte, nuk mund të naitohei. Ç'të bënte? Rrinte dhe mendonte. Ç'të bënte? Licen e humbi. Jeta për të

s'kishte më kuptim në atë vënd. Ai nuk mund ta shihte atë, t'i kalonte përpara dhe t'i fliste sikur ajo të ish djalë. Jo, jo! Dhe një ditë prej ditësh lajmi mori dhenë se Limi u zhduk, se ai iku nga kulla e tij, nga fshati i tij, nga Lica e tij.

Iu duk Licës sikur edhe gurët qanin për atë me, për Limin e saj.

Qau në heshtje Lica. E lavdëruan në log të burrave Licens, se ajo ish bërë me i babës, burrë i shtëpisë, ish bërë ashtu e ish bërë kështu.

Lica doli përjashta. Pleqëria filloi ta nderojë shumë. Djemuria kundronte fytyrën e saj, trupin e saj, gjoksin e hedhur — dhe mallkonin fatin e tyre, që s'e kishin shtënë dot në dorë atë cucë.

Ndërsa Lica, nga që s'kishte ç'të bënte, qeshte. Dufin e saj e nxirte me të qeshur, me të tallur. Qeshte se s'mund të qante, qeshte se duhej të qeshte, qeshte se ishte bërë «burrë»!

Filloi ta ndreqë vetë kullën. Filloi të vejë vëtë me berrat, vetë në nulli, vetë për dru, ndërsa prindrit sa vinin e plakeshin.

Në brez vuri nagandin. Në sup vari pushkën për të ruajtur nderin e saj, nderin e shtëpisë së saj.

Ndodhët ngadonjëherë që ndonjë djalë ta ngacmonte. Ajo i tregonte tytën e nagandit.

— Pa-pa-pa! S'bahet llaf me te! — thonin djemuria.

— Ajo asht e egër si bisha e malit! — ia bënин tjerët.

I ati i saj, daja i saj, kur dëgjonin këto, përdridhnin mustaqet duke zbardhur dhëmbët.

Kështu Lica në sy të botës u bë djalë, burrë; ndërsa me zemër mbeti edhe mjaft kohë vajzë.

Vitet kalonin. Plaga e Lices sa vinte e mbyllej. Filloi tē hyjë e tē dalë nēpér dyert e botës, si një burrë, tē bëjë muhabet si një burrë; ta nde rojnë tē tjerët më tepér se burrë. Filloi tē bëjë shaka. Në fillim bënte shaka nga e keqja, nga që s'shprehej dot ndryshe, por më vonë, nga që u mësua, nga që iu bë shprehi. Filloi tē vejë nē lojë burrat, gratë, pleqtë, rininë. — Tē tjerët qeshnin, zgërdhchin dhëmbët. Disa që e kuptionin edhe prekeshin, por me që fliste Lica, ata nuk i zemë roheshin. Licen e ftonin kudo. E nderonin tē gjithë. Në ahengje, nē dasma e lindje kudo ajo nē krye tē vëndit do tē ishte.

Një ditë u bë një dasëm nē fshatin e saj. Për çudi tē Lices, kjo dasëm iu duk si e parë, si e èndëruar dikur. Tamam iu duk si dasma e saj, ashtu siç i kish thurë planet me Limin e saj. Aty nē krye tē vëndit zemra filloi t'i rrähë me tē fortë. Tē gjithë e vunë re. Në këtë dasëm Lica nuk ishte më ajo e para, e dasmave tē tjera, e ahengjeve tē tjera. Ajo nē këtë dasëm ishte shumë e menduar. Ajo vetëm shikonte dhe habitej. Kishte èndërruar dikur ajo vetë për një dasëm tē tillë, por ahere ishte e pamundur.

Dhëndëri me nusen po flisnin gojë më gojë me tē gjithë. Dhëndëri me nusen kërcenin para tē gjithëve. Dhëndëri nuk skuqeji. As nusja nuk skuqeji. Dhëndëri s'kish turp nga vjehëri. Por as nusja nuk kish turp nga vjehëri. Ajo vajti i puthi dorën atij dhe vjehrës, pastaj filloi tē kércejë me tē gjithë. Sa e bukur që dukej nusja pa duvak, duke buzë qeshur me dhëndërin bashkë.

- Eh, ky është çift! — dëgjoi një zë burri.  
— U lumtë, vallahi u lumtë, e bënë si burrat.

U dashuruan, luftuan me të gjithë dhe ja sot! Besa të fortë! U lumtë! — ia bëri një tjetër.

Lica vetëm shikonte. Diçka iu kujtua si në mjergull.

Po me atë vullnetin e saj e zboi atë mendim. Vuri re një plak atje tej, që i kish ngrysur vetullat. «Pse?» — ia bëri me vete. Shihte këtej rininë, gazin, dëgjonte lodrën, tëk-tëk ia bënte zemra. Nga ana tjetër, shihte atë plakun, që i kishte varur buzët dhe fap e hiqte atë mendim që i sillte zemra.

Filluan t'i venin e t'i vinin mendime të ndryshme.

— E pse të mos e kujtoj Limin? — ia bëri këtë pyetje vetes.

Dhe atë natë, tinës të tjerëve, ajo qau.

Por, se ç'iu shkrep atyre, arësimtarëve, e filluan ta ngacmojnë këtë, Licen. Lica merrte për shaka fjalët e tyre, kur ata i përmëndnin rininë, jetën. Por një ditë ajo u zu me këta arësimtarë. Atë ditë kur ata i folën për Limin. Ajo u drodh e tëra.

— E, or bij, mue doni me ma mbushë zemrën!

— u pat folë ajo atyre.

— Jo, ne duam t'ju bindim se keni vepruar shumë keq!

— Mjaft ma! Mos më folni për të tilla gjana!

— ishte nxehur Lica.

Të gjithë u çuditën. Ishte hera e parë që zemërohej ajo, që u foli kaq ashpër arësimtarëve. Ajo ata i donte shumë, por tashti ajo nuk u fliste më. U bënte bisht çdo takimi me ta.

Një mbasidite, nga makina zbriti një burrë me një fëmijë. I pari njeri që takoi ai ishte Lica. Lica, sa e pa atë, e njobu. Edhe ai e njobu Licen. Lica u trëmb, u zverdh. Edhe Limi, kur e njobu atë,

u tremb, u zverdh. Ai kish ardhur shpesh herë, por asnijëherë s'ishin takuar. Dhe ja tashti... që të dy kujtuan diçka të largët, nga e kaluara.

— Si je, Lim? — e përshëndeti ajo e para.

— Ti je, Licë? — ia këtheu ai.

Që të dy heshtën.

— Akoma e ke mbajtur brezin, moj Licë?

— Kështu e don Kanuni!

— Ç'dreq kanuni!

— Po prindët?

— T'i merrje me vete!

— Është e kotë me folë tashti! — tha Lica dhe ngriti hopa vogëlushen që mbante një kukëll në dorë.

— Hajde te xhaxhi! — i tha ajo.

— Po ti s'je xhaxhi, je teta!

— Si të quejnë?

— Mua më quajnë Lice!... Po ty si të quajnë?

— pyeti fëmija.

— Si, Lice?!...

U trondit pér një hop, pastaj e mblodhi përsëri veten. E lëshoi fëmijën:

— Po më hikin berrat! — tha dhe iku pa përshëndetur.

Edhe atë ditë Lica qau. Qau në heshtje dhe fshe-hurazi të tjerëve. Atë ditë ajo numëroi vitet e saj. Ishte bërë dyzet vjeçë. Nxori kutinë e duhanit dhe drodhi një cigare. Pér herë të parë pinte duhan. Ajo kurrë s'e kishte vënë më parë në gojë. E mbante kutinë e duhanit me vete me qëllim që të dukej sa më tepër si burrë. Pasi e ndezi cigaren me çak-makun prej gëxhoje plumbi, e thithi një herë me të fortë. E zuri kolla.

— Në djall të vejë! — mallkoi dhe e hodhi poshtë cigaren.

Ashtu siç ishte e mërzitur, shkoi tek daja i saj, te ai plaku pranë buxhakut, ku i kishin vajtur edhe arësimtarët, për t'ia shpënë radion me bateri me qëllim që ta dëgjonte plaku fanatik, i cili e deshte kaqë shumë Licen.

Sa i pa arësimtarët, ndryshoi mendimin. Me-qënëse ishte në shtëpinë e dajës së saj, si në shtëpinë e saj, e ktheu brengën e zemrës në humor dhe filloi të bëjë shaka me njerëzit, me arësimtarët, me radion, po kur radioja filloi të fliste ajo u mvrejt, kujtoi tërë historinë e saj. Veshët i bëri pipëz që të dëgjonte më mirë:

«... Por... unë... u thashë prindërve të mij fanatikë: — ta marrim djalin në shtëpi dhe të jetojmë bashkë me të dhe burri im të jetë për ju djali juaj! — Kështu u fola prindërve të mij duke mposhtur me forcën time, me forcën e Partisë, atë zakon të keq ashtu si i mposhtën zakonet e vjetra, zakonet prapanike qindra e qindra shoqe të mia!»

Kumbimi i zërit të malësores në radio pushoi. Për një hop u bë qetësi. Lica hapi sytë.

— Po unë ç'kam bërë për veten time? — pësh-përiti me vete duke parë nga pasqyra.

— E nxive jetën tënde — iu duk sikur foli, ajo, Lica tjetër nga pasqyra.

— Ala s'u pe në pasqyrë, mbylle atë dreq radio, se na i mori mendtë! — urdhëroi plaku nga buxhaku.

Lica ktheu kokën. Për herë të parë të tjerët i vunë re sytë e përlotur. Ajo ia nguli vështrimin plakut.

— Edhe ti, or dajë, më ke marrë në qafë!

— Mbylle atë dreq radio, se na i mori mendtë...

— Jo, dajë. Unë atë cucë e njof, është prej X. E kisha ndëgjue këtë histori, po s'u besoja të tjetërve. Tashti ajo vetë me gojën e saj foli, — dhe pa nga arësimtarët. Ata i buzëqeshën. — Sa e ngjashme jeta ime me jetën e saj dhe sa e ndryshme jeta ime me jetën e saj. Ajo nuk e nxiu jetën e vet. Ajo ishte më e fortë se unë. Por edhe unë... — dhe filloj të zgjidhë brezin...

Flaka e zjarrit në vatër kish marrë përpjetë.

— Ç'po ban kështu? — ndërhyri plaku.

Ajo heshti. Pasi e mblodhi kutullaç brezin, e hodhi në zjarr. Kutinë e duhanit, sahatin me gjithë qostekun ia hodhi në prehër plakut:

— Merri, se ti m'i ke dhanë! — iu shkreh atij.

Hoqi lahurinë nga koka. Flokët i kishte të shkurtëra:

— Megjithatë, do të më rriten! — e flaku edhe atë mbi gjuhëzat e flakës që ngriheshin lart e më lart dhe doli nga dhoma. Era e freskët e asaj nate të kthjellët ia përkëdheli flokët, fytyrën, zemrën.

— Unë jam vajzë! — Ndonëse dyzetvjeçare, unë jam vajzë! — tha dhe iu duk vetja e lirë, sikur të ish çliruar nga disa pranga, që e kishin mbërthyer shekuj me radhë.

— Unë jam e lirë! — pëshpëriti. — Unë jam e lirë! — pëshpëriti përsëri dhe hapi krahët drejt qiellit të pastruar nga retë e të mbushur me yjet që xixëllonin dhe që dukej sikur cicëronin nga zëri i shpendëve të natës.


## C U C A   E   P A V I O N I T

Ajo zbriti nga mali, ose më mirë të themi, atë nga mali e zbritën kaluar. E shoqëronin dy veta, dy malësorë me mustaqe deri te veshi. Njeri nga ata tërhiqte kalin pas kapistre, ndërsa tjetri e ruante se mos rrëzohej; e ruante shumë, mendjen vetëm tek ajo e kishte. Ajo luhatej mbi kallë duke u shtrënguar fort pas samarit. Në atë çast nuk kundronte hënën e plotë, që ua zbehte të gjithëve fytyrën, nuk dëgjonte as edhe cicërimat e zogjve, madje as trokëllimat e qarta të patkojve të kalit. Herë-herë mbyllte edhe sytë, por... nuk mund të mendonte asgjë, se turbullohej, pastaj anohej e gati sa s'rrëzohej. Menjëherë ndjehej në duartë forta dhe mblidhët veten e përsëri hapte sytë e shtrëngonte duart akoma më tepër pas samarit.

— Hej, taksirat, kështu paska kenë shkruejtë për ne, me vuejtë e gjithmonë me vuejtë! -- foli burri i parë, ai që tregonte rrugën.

— S'ke çka me i ba, kur të zen e keqja, hapi derën, ... kështu asht shkrue nga zoti... — ia priti i dyti, ai që vinte pas tij.

Heshtën. Në atë heshtje të rrugës së gjatë të dukej sikur yjet cicëronin, sikur trokëllimat e patkojve të kalit po sillnin dalëngadalë agimin e ditës sé



«Cuca e pavionit».

re. Dalëngadalë yjet filluan të shuhen. Dielli ia përkëdheli sytë vajzës. Ajo e lëvizi kokën.

— Mbërritëm! — ia bëri burri i parë.

— Ku asht spitali? — ia priti tjetri.

Filluan të duken njerëzit në rrugë. Për herë të parë ajo po shihte një qytet. Për herë të parë ajo po shihte kaq njerëz. Kishte dëshirë të pyeste përnjerëzit, për qytetin, për gjithshka. Ishte kurestare të dinte, por përsëri ajo s'e hapi gojën. Përsëri ajo s'i lëvizi buzët.

— Ky asht spitali! — tha i pari.

I dyti drejtoi sytë nga vajza.

Vajza u rënqeth.

\* \* \*

Dy iurrat mustaqemëdhenj dhe vajza e njojmë po rrinin përballë mjekut dhe infermiereve.

— Çfarë ka vajza? — pyeti mjeku.

— Është pa qejf, nuk mundet, është sëmurë!

— Çfarë e keni ju?

— Jam i ati, e kam cucën teme!

— Cucën tuaj, po ju? — iu drejtua tjetrit.

Ai tjetri u mbillaçit, seç pëshpëriti s'e mori veshnjeri, se u dëgjua një rënkim. Vajza sa s'u rrëzua.

Të tërë u alarmuan. Mjeku me gjakftohtësi urdhëroi infermieren që ta xhvishte.

Të dy malësorët u vështruan sy më sy. Mjeku vuri stetoskopin në qafë dhe iu afrua pacientes: «Sa e dobët!» — mendoi, kur pa eshtrat e vajzës. I vuri stetoskopin. Krisma të çjerra ia morën mendjen. Dëgjoi zhurma të tilla që e tronditën: «Ç'e kanë

mbajtur deri tani?» — mendoi përsëri. Ia ngriti më lart këmishën:

— Merr frymë fort! — i tha.

Ajo gulçoi. Sa s'po i dilnin lot nga sytë. Mjeku e vuri re. I uli pak këmishën, që t'ia lëronte grykën, kur dora i preku diçka të fortë. I kapi me të dy duart, i këputi, i shqeu! Vajza mori frymë lirisht. Mjeku hapi dorën. Dy hajmali i qëndronin mbi pëllëmbë. Ai u ngrit në këmbë, ose më mirë, brofi në këmbë dhe u drejtua tek burrat të cilët kishin zgjatur qafën dhe me mustaqet e tyre të ngritura e të zgjatura deri te veshi dukeshin sikur diç nusnës.

— Ç'janë këto, përse nuk e keni sjellë vajzën më parë? Ku kini qënë më parë?... — filloj të çirrej mjeku. Ishte mjek i ri. Medi e quanin. Ishte i sjellshëm, por kur e donte puna, edhe të shante.

Të dy malësorët u vështruan sy më sy.

— Po mirë, si i bahet hallit tashti? — pyeti malsori i dytë.

— Vajza do të rrrijë këtu!

— E pamundun! — ia priti përsëri malsori i dytë.

— Ahere pse e sollët, pse s'e latë të vdiste atje me duvatë e hoxhës, pse s'ia shtrënguat më fort grykën me hajmalitë tuaja?...

Një copë herë mbizotëroi heshtja në atë dhomë të vogël e të pastër, pastaj, papritur, këtë heshtje e theu i ati i vajzës:

— Sa ka me ndejtë? — pyeti ai.

— Sa të shërohet! Një, dy, ndoshta edhe tre muaj! — iu përgjegj pak i zbutur mjeku.

Të dy malësorët u panë përsëri sy më sy. Dukej

sikur me atë vështrim merreshin vesh njeri me tjetrin.

— Jepi dorën babajt! — i tha infirmierja vajzës.

\*  
\*      \*

Vajza kishte hequr dimitet e poshtë tyre kishte zbuluar këmbët e saj kërthi, kishte hequr jelekun me xhubenë e trashë dhe kishte zouluar një trup të hollë, një trup të njomë, që mezi sa mbahej në këmbë.

Kur hyri mjeku, ajo qëndroi e shtrirë në krevat. Flokët e gjata i vareshin mbi jastëkun e bardhë. Vetullat e zeza me sytë gjysëm të mbyllura i jepnin hijeshinë e një vajze shumë të bukur.

— Si je sot?

Vajza hapi mirë sytë e përgjumur. U ngrit pak nga krevati. Buzëqeshi.

— Ma mirë, doktor!

— Jo më mirë, po shumë më mirë. Sa të mbarosh këto gjilpëra e do të ngrihesh nga krevati, do të vesh në dhomat e tjera, të njihesh me shokë e shoqe të reja, do të vinë ato këtu të të shohin ty...

— A thue, doktor, se unë do të çohem në kambë?

— Patjetër, q'janë këto fjalë që thua, ti je cuçë malsie, s'ke turp që trembesh?!... — dhe filloj të qeshë, të qeshë me të madhe. Kaq shumë qeshi doktori, sa vajza u hutua dhe u turpërua. I erdhi rëndë që bëri një pyetje të tillë.

— Doktor Mediu, doktor Mediu! Një urgjencë! Mjeku menjëherë ndërpreu të qeshurën e tij.

— Mos u mërzit, moj cucë, se së shpejti do të shërohesh! — i tha dhe doli nga dhoma.

«A thue fola keq?» — ia bëri vajza këtë pyetje disa herë vetes, posa doli mjeku nga dhoma.

Ndërsa nga prapa derës filluan të dëgjoheshin zhurma, taka këpucësh. Filluan të dëgjoheshin pëshpëritje nga pacientët, nga të sëmurët:

— Është shumë rëndë!

«Paska më keq se unë!» — pëshpëriti vajza dhe si një vegim i lindi dashuria për jetën, dëshira për të jetuar.

\* \* \*

— Si të quajnë ty?

— Fetije, po ty?

— Mue doktori më thërret «cuca e pavionit», po në të vërtetë më quejnë Lumturi. Më vjen turp ta pyes, pse më thërret cucë.

Fetija filloi të qeshë. Pastaj edhe t'i shpjegojë:

— Sepse të do fort, sepse je më e vogla këtu, në këtë pavion, në pavionin tonë dhe sepse babaj yt këshfu të quante, cucë, apo jo?

— Nga i di ti këto? Ti s'e njef babën tim:

— Ehu, unë t'i di të gjitha ty! — dhe nxori shtizat nga një çantë e filloj të punojet.

— Ti nuk thua të vërtetën, ti s'di asgjë përmua! — menjëherë e humbi fillin e mendimit, kur pa Fetijen të punonte me ato gjilpëra si shtiza.

— Cfarë po bën ashtu me ato gjilpëra?

— Perde.

— Cfarë janë ato perde, përsë duhen?

— Si, nuk e di ti?

— E ku ta di unë, e shkreta!

- Për t'i varë' në dritare, ja si këto këtu.  
— E përse t'i varësh?  
— Që dhoma të duket e bukur.  
— A vërtet me këto e zbukuron dhomën?  
— Po edhe me këto zbukurohet dhoma, pse ty s'të pëlqen kjo dhoma e spitalit?  
— Jo, jo, më pëlqen shumë, po... a do të më mësosh edhe mue?  
— E pse jo?  
— A vërtet do të më mësosh edhe mue?  
— E pse çuditesh, bile do të të mësoj që të bësh edhe gjëra të tjera më të bukura, që kur të shkosh tek shtëpia e burrit, t'i habisësh të gjithë, kur t'i shtrosh në tavolinë, kur t'i varësh në dritare, kur të t'i shohin jastëkët e qëndisur!...  
— Rri, mos ma përmend shtëpinë e burrit!  
— Pse, a mos je e fejuar?  
Vajza tundi kokën në shenjë pohimi dhe lëvizi pak buzët:  
— Po!  
Në koridor u dëgjuan disa hapa.  
— Erdhi doktori, shtrihu shpejt në krevat, se mos të të shajë! — tha Fetija.  
— Doktori nuk më shan mua, ai është shumë i mirë. — tha vajza me dlirësi.  
Hyri i qeshur doktori.  
— Hë, si është cuca jonë sot? — pyeti ai në vënd të përshëndetjes.  
— Ma mirë, doktor, shumë ma mirë jam!  
— Hëde, ashtu të dua, — Po ti ç'do këtu? — iu drejtua mjeku Fetijes.  
— Fetija po më mëson punëdore! — ndërhyri me të shpejtë vajza.  
— Ashtu! Shumë mirë po bëni! Po tashti çohu

me ngadalë e shko takohu, se të kanë ardhur prindërit.

— Vërtet?! — I shndriti fytyra vajzës. Sa e kishte marrë malli për njerëzit e shtëpisë! Brofi në këmbë si pendë e lehtë dhe u zhduk me të shpejtë prapa derës.

Ndërsa e sëmura tjetër me doktorin qeshën.

Vajza doli nga pavioni. Sa shkeli në oborr, u step. Ngriu në vënd. Përpara saj qëndronte Ai. Ai me mustaqe të gjata deri te veshi, që e ruante mos të rëzohej kur e sollën në spital. Kishëtë marrë edhe kalin me vete. Ai, sa e pa ashtu në këmbë, të shëndoshur e të zbukuruar, përdrohhi mustaqet, buzëqeshi e desh të hapte gojën... Por ajo shtangu në vënd, klithi, u kthyte prapa e u fut menjëherë brënda.

— Ç'pate? — e pyeti doktori.

— Ç'pate? — i tha Fetija.

— Kush ishte? — ndërhyjnë të tjerët nga jashtë.

Vajza ishte e tmerruar, gulçonte. Nofullat i kërcisin. I tërë trupi i dridhej si purtekë. Ishte shumë e tronditur. Mezi mbahej në këmbë.

— Kush ishte ai?

— Ai, ai!... e s'fliste dot, nuk përqëndrohej dot, nuk e kthente dot as kokën nga dera.

Mjeku e mblođhi veten. Doli me të shpejtë jashtë, që ta takonte atë njeri e ta pyeste se ç'ishte, kush ishte, ç'e kishte vajzën, përsë e kërkoi, çfarë i tha? Kur ç'të shihte: ai, burri me mustaqet deri te veshi, që e kërkoi vajzën, tanë kishte kthyer kurrizin dhe po shkonte kaluar andej nga kishte ardhur.

\* \* \*

«...Mjerë ai që shkel ligjin e shenjtë të Partisë mbi të drejtën e grave...» — vazhdonte radioja të komenton te mbi letrën e kooperativës «31 Korriku» të Burrelit drejtuar shokut Enver.

Lumtëria dëgjonte me aqë vëmëndje, sa që kish humbur edhe fillin e punimeve të punës së dorës, që tashmë kishte filluar ta përvetësonte më së miri.

Ndërsa dy shoqet e saja, Hatija dhe Fetija, që i kishte dërguar vetë mjeku në dhomën e saj, e vunë re këtë gjë:

— Me sa vëmëndje po e dëgjon radion! Ç'përshtypje të madhe po i bëjnë këto fjalë! — pëshpëriti njera.

— E si mos t'i bëjnë! — ia bëri tjetra. — Radioja sot vetëm e vetëm për të po flet — vazhdoi përsëri ajo.

Nga ana tjetër, radioja vazhdonte të komenton te akoma, ndërsa mollëzat e faqeve të vajzës kishin filluar të lagen me lot.

— Pse qan, moj cucë e pavionit? — e pyeti Fetija.

— Ah, jo, jo, se ç'm'u kujtua!... — dhe heshati. Filloi t'i fshijë lotët.

— Edhe mua vërtet më preku radioja sot, sidomos ajo letra e kooperativës «31 Korriku». Sa mirë, të gjithë ishin ngritur kundër zakoneve prapanike, kundër fejesave të pabarabarta.

— Ashtu thotë radioja, po s'ka si të ngrihen të gjithë...

Fetija dhe Hatija qeshën.

— Jo, moj cucë, radioja nuk gënjen kurrë! Gjithshka është e vërtetë.

— Po qe e vërtetë, do të thotë se ata të gjithë janë të mësuar, janë shumë më përpara. Sa larg është fshati, ynë nga ata!...

— Edhe ata fshatarë si ne janë.

— Ehe, i di unë ata, ata janë kooperativë e përparuar, pa le të ngrihet ndonjeri tek ne ashtu, pa e shef ai...

— Ti je e vogël, moj cucë, pa pyete një herë Fetijen se ç'ka hequr nga këto zakone prapanike, pyete një herë pse ka ardhur këtu në spital.

Pa pritur cucën kureshtare, Fetija filloi:

— E ç'm'i kujtuat hallet e mijë, përsë t'ju flas më parë, për atë që më bëri im atë, atëhere kur unë isha akoma foshnjë, që më fejoi me një budalla?

Vajza hapi më tepër sytë.

— Apo për atë që baba desh më vau, siç e dini edhe ju, si erdha këtu?...

— Pse, si ndodhi? — psherëtiu vajza.

— Ja, fare thjeshtë, m'u mbush mëndja se im atë kishte gabim për mua, se im atë kishte vepruar keq me mua, që më kishte fejuar që në djep, dhe ja, tashti që u rrita e kuptova që ai burrë nuk bënte për mua...

Vajza hapi më tepër sytë.

— Pse, e paske lënë burrin ti? — pyeti padashje ajo.

— Uj të lënë, e çfarë të lënë se!

— Po s'pate frikë?

— E ç'frikë, Ja, u ngritën babaj i tërbuar, dhëndëri i marrosur e më rrähën. Ju më patë se si erdha këtu në spital, madje ata deshën edhe të më vrisnin, sepse jam e para që e prisha këtë zakon aty në fshatin tonë, por do ti që puna ime u pël-

qeu të rijnje të fshatit, ata erdhën dhe më mbrojtën, më shpëtuan. Ata gjithmonë vinë e më shohin këtu në spital.

— Të fejuarin e le ti?!

— Po, po, thashë që e lashë!

— Besa e fortë je ti! Unë një gja të tillë s'do ta baja dot kurrë!

— S'e bën, se je frikacake, dhe e quan veten malsore!

— Po të vret baba. Ai ka marrë pare nga dhandëri...

— Domethënë yt atë të paska shitë me pare, si kafshët!

Vajza u skuq. Si i shpëtuan këto fjalë? E humbi fare!

— Mirse rrini! — tha doktori, posa hyri brenda.

— Ç'kini kështu, sikur ju janë mbytur gjemité.

— Kurgjë doktor, po flisnim për këto fejesat e martesat e pabarabarta, por... siç duket, cuca jonë s'është e një mendjeje për ato, për prishjen e tyre.

— S'është e mundur, cuca jonë është më përparimtarja se ju të gjitha këtu, apo jo, moj cucë?

Vajza uli kokën e dëshpëruar. Ishte vërtet e dëshpëruar, e turpëruar. Si t'u kthente këtyreve përgjigje. Si t'i kthente përgjigje doktorit, atij që e shëroi, që e ngriti në këmbë, që i ndeji aq afër ato ditë të vështira të jetës së saj?

— Ju nuk e dini, — vazhdoi mjeku, — se cuca jonë, nuk i besoi hoxhës, por iku andej nga ajo folle e mykur e fanatizmit dhe erdhi këtu në spital që të shërohet. Ajo pati besim tek mjekët, tek infermieret, në veten e saj. Ajo këto tre muaj që ndeji këtu ka parë shumë, ka mësuar shumë dhe

tashti, kur të vejë në fshatin e saj, do të jetë një nga të parat aty që do të luftojë me ngulm për ngritjen e mirëqenies në kooperativë, për zhdukjen e zakoneve prapanike, për të vajtur edhe vajzat në aksione! — apo jo, moj Cucë? Cuca jonë do të dijë të punojë me mësuesit e shkollës, me rininë e fshatit. Ajo tashmë nuk do të rrijë e veçuar nga ata, ajo nuk do të rrijë e mbyllur në shtëpinë e saj! Ajo tashmë do të dijë të jetojë!

Vajza i kishte dëgjuar këto fjalë. Ajo kishte jetuar ditë të tëra me këto fjalë që i tingëllonin në vesh orë e çast, madje edhe kur hante bukë, edhe kur flinte, madje edhe kur fliste me të tjerrët. I analizonte fjalët. Sa shumë ngjisnin me ato që fliste radioja, me ato që shkruante gazeta. Dhe, padashje, në vetvete ishte mbushur me një revoltë që priste çastin të shpërthente kundër të jatit, të fejuarit, kundër shitblerjes, në përgjithësi kundër zakoneve prapanike. Po këtë revoltë nuk ia tregoi asnjeriut, e mbajti të fshehur.

Dhe puna e saj filloj, që ditën që doli nga spitali, kur i tha doktorit: — Shoku doktor, s'është nevoja të lajmëroni shtëpinë për të më marrë. Unë vetë do të shkoj në fshat. Rrugën e di. Kam nja dy shoqe këtu, e me to do të shkoj! — Kështu i pat thënë. Dhe kështu filloj.



Pas një kohe të gjatë, doktorit, i erdhi në spital një letër. Në këtë letër midis të tjerash, shkruhesh:

«... shoku doktor! e ndjej të nevojshme me ju

shkrue diçka të zemrës: Ju në spital shpesh më keni lavdue: «Ja shikoni cucën e pavionit sa shumë që ka ndryshue! Cuca jonë, cuca e pavionit tonë do të jetë e para aty në fshatin e saj, që do të luftojë kundër zakoneve prapanike, ajo s'ka me na korritë kurrë, apo jo cucë?»

«Dhe vërtet, shoku doktor, unë s'ju korita. E ndjej të nevojshme me ju shkrue për këto: — Kur mori vesh i fejuemi im, se Lumturia, ose ma mire cuca e pavionit lufton zakonet prapanike, tha: kam me i marrë shpirtin! Kur mori vesh ai se e fejuemja e tij ka qejf me vazhdue shkollën, u tërbue fare dhe erdhi në shtëpi me më kërkue. — Po, kur mori vesh se unë e kisha lanë ate, u xhindos e desh më vran. Po kur t'iua ngritën të rrijtë e të rejat, madje edhe pleqtë e plakat, madje edhe fëmijët e tij, ata që i kishte me gruen e parë, se e dyta i pat ikë nga shtëpija me gjithë fëmijë, e pati pisk. Shau babën tim dhe erdhi me ia lypë paret, që i kishte dhanë për mue. Të «fejuemin tim» ju e patët njoftë. Ishte ai që më solli në spital bashkë me babën.

«Shokët e mij të fshatit, shokët e rinisë të fshatit u çuditën me mue. Ata vetëm tashi më njoftën.

«Po të shkruej edhe diçka: Jam regjistrue në shkollë, në klasën e pestë, natën. Disa thonin se më ka kalue mosha, kurse unë u thashë se tashti nisi jeta për mue.

A e dini se me kë shkoj në shkollë? Me të fejuemin tim. E njofta në punë, në brigadë.

Fal me shëndet!

Cuca e pavionit!»

Mjekut i kaluan nëpër mënd me dhjetra e dhjetra të sëmurë, e ja përpara syve sikur i doli ajo e veshur me dimi të dhe xhube, me hajmalitë e va-

rura në qafë, e shoqëruar nga dy burra mustaqemëdhenj. Pastaj, trupi i saj skelet, pastaj sëmundja e saj, flokët e zez, sytë e zez, fytyra e bukur, pastaj dëshira e vajzës për të mësuar, për të pyetur, për të jetuar. «— Po ajo është!» — Mjeku mori frymë thellë, si i lehtësuar. Kurrë në jetën e tij s'e kishte ndjerë veten kaq të gjëzuar. As edhe kur kishte marrë diplomën e mjekësisë. Rrëmbeu letrën, ashtu siç ishte plot gaz, u ngrit dhe vajti t'ua tregonte gjithë të sëmurëve, personelit, madje edhe gruas së tij.

## NË ORËN E HARTIMIT

Nuk mund t'i harroj kurrë sytë dhe fytyrën e saj në orën e hartimit, kur ajo shkruante temën: «Shoku Enver, udhëheqës i madh dhe njëri i dashur për ne!» — Lëvizjet e duarve plot ner-vozizëm, njomja e bebëzave të syve dhe tërë përqëndrimi i qënies së saj në atë fletë të bardhë të fletores, më binte në sy. Më binte vetëm mua në sy, pasi Shqipja rrinte në bankën e fundit. Rrinte e vetme. Ndërsa nxënësit e tjerë ishin kredhur në fletoret e tyre.

Kur ra zilja, mblodha hartimet dhe, si përcoilla nxënësit, fillova të çfletësoj fletoren e saj.

Të them të drejtën, nuk më erdhi mirë, kur pashë atë shkrim të shpejtuar dhe njolla në fletore. Atë grua e kisha një nga nxënëset më të mira.

U pendova që tregova një interes të veçantë për atë fletore... Por se si kureshtja më detyroi që ta lexoja përsëri, të shoh frazën e saj të shkurtër dhe të analizoj domethënnien e çdo fjalie, që ajo kish shkruar:

«...Shoku Enver ka thënë: T'i flakim tutje zakonet prapanike...» Tri fjalët e para të kësaj



«Në orën e hartimit».

fraze i kish shkruar bukur, pastër, pastaj e kishte pri-shur shkrimin e, në fund, kishte një njollë. Më têr-hoqi njolla. M'u kujtuan sytë e saj të skuqur e têrë lot... dhe... rilexoj përsëri: «... Shoku Enver ka thënë...», shoh njollën e bërë nga boja ende e patharë me një pikë loti të saj. Shoh njollën dhe, prapa asaj njolle të bërë me lotët e saj, lexoj një pjesë të historisë, historinë që më ka treguar ajo vetë me gojën e saj:

«Shqipja tashmë është njëzet vjeçë, por përkë-dhelitë e të jatit nuk i ka ndjerë kurrë. Jo se nuk ka pasur baba, ai jeton edhe sot. Jo se ai ishte mërguar diku jashtë shtetit, jo, ai është në shtëpi. Mos ndoshta ka qënë i ashpër, i keq? Për këtë nuk mundem të flas: «Im atë është gjallë. Im atë jeton në shtëpi. Im atë tashti është nëntëdhjetë vjeç!» — më tha kur e pyeta. Ajo veç rënkimeve e kollës së tij nuk ka ndjerë gjë, pasi ai, i ati i Shqiponjës është martuar me nënën e saj kur ai ishte shtatëdhjetë vjeç. «— U martua me nënën time njëzetvjeçare se kishte para. U martua me nënën time se ashtu e desh zakoni!»

Kështu, Shqipes iu desh, që në moshë të vogël, të mbartë vuajtjet e së jëmës, barrën e rëndë të jetës, drurin që e ëma hante jo më nga i shoqi, se ai ishte i vjetër e s'kish fuqi, por nga i biri, që ishte më i madh edhe se vetë njerka e tij, — e ëma e Shqipes, — domethënë nga druri që hante nga vëllai i Shqipes me nënë tjetër. Ndërsa i ati, duke zgjatur qafën tërë rrudha si të breshkës, pinte duhan dhe bënte sehir. Herë-herë jepte edhe urdhëra, që i biri të qëllonte akoma më tepër mbi nënën e Shqipes.

Qante nëna nga dhimbjet, nga puna e rëndë,

qante dhe për fatin e saj të keq. Qante dhe Shqipja e vogël. Qante, vetëm e vetëm se qante e ëma e saj.

Shpesh e ëma ishte matur të ikte. Të merrte dhe Shqipen me vete dhe të shkonte. Po ku? Kjo ku-ja e mundonte. Pastaj... fjalët e botës! E kush do ta besonte?! Do quhej femër e përdalur. Ndërsa Shqipja, fëmija e saj, një fëmijë... Dhe vendosi të qëndrojë dhe të heshtë. Të heshtë para të tjerëve, dhe të qajë tinës të tjerëve.

Ia vunë tërkuzën e gjatë në qafë edhe Shqipes. Nënë e bijë, që të dyja me tërkuzën e gjatë në qafë punonin e rrropateshin tërë ditën. Ndonëse Shqipja s'i kishte mbushur të nëntë vjetët, ajo punonte së bashku me nënën, lodheshin, dërsinët së bashku, ndërsa plaku gulçonte, shante, mallkonte!

Mos vallë edhejeta e Shqipes kështu do të vazhdonte?

Struktur në qoshe të vatrës rrinte plaku. Filluan të venë e të vinë njerëz. Të bëhen pazarllëqe. Atëherë Shqipja ishte dhjetë vjeçe. Bëheshin pazarllëqe për kokën e saj. Ajo s'dinte gjë, vetëm se ndjente se diçka po luhej prapa krahëve për fatin e saj, sepse e ëma qante, sepse e ëma e shtrëngonte më fort në gji sepse e ëma desh të thoshte edhe ajo fjalën e saj, se s'ish më puna për veten, por për fëmijën, për gjakun, për fatin e Shqipes së saj.

Dhe, njëherë, kështu, si qau shumë, si e pa mirë Shqipen, si e puthi dhe e shtrëngoi fort në gji, nuk duroi dot më, ndonëse e kishte të ndaluar nga zakoni, hapi derën dhe doli në kthninë tjetër, atje, ku e kishin vëndin burrat.

I ati i Shqipes, posa e pa të shoqen brënda dhomës, u mvrejt. Vëllau i Shqipes çakariti sytë.

Ai burrë me mustaqe spicë dhe me kokën e vogël si të miut, u habit kur e pa brënda atë grua dhe, pasi e kuptoi, buzëqeshi duke zbardhur dhëmbët e mprehta si të ujkut, — futi dorën në xhep dhe nxori diçka, — nxori para, që t'ia jepte nënës, që t'ia blente të bijën...

Nëna u step një copë herë nga ato vështrime të pamëshirëshme. Ajo u hutua fare nga buzëqeshja e atij kokëmiu, të cilit i kishte vdekur e shoqja para ca kohe e desh të merrte të bijën e saj për...

— Jo, jo! Në asnjë mënyrë nuk e jap bijën time, nuk e shes vajzën time! — ishte klithma e fundit e nënës, se plaku befas rrëmbeu mashën dhe, me tërë fuqinë që kishte, e qëlloi gruan prapa koke.

Ajo vdiq. Shqipja mbeti jetime.

Pas kësaj, si do të ishte fati i Shqipes?

«Si i nënës sate!» — i dukej asaj sikur i përgjigjej një zë. Një zë sa i njohur aqë dhe i panjohur. Një zë i dalë nga përzierja e zérave të të jatit plak, të vëllaut me nënë tjetër dhe të burret të panjohur. Një përzierje zérash të dala nga ai vënd i zi, nga ai vëndi i errët, i nxirë nga bloza shekullore, nga gufa e vatrës.

— Jo! Jo! Në asnjë mënyrë jo!»

Për një copë herë e mblodha mëndjen dhe vazhdova leximin:

«... Shoku Enver m'i di plagët e mia, sepse ai është ngritur me të fortë kundër plagëve me fjalën e tij të 6 shkurtit, e cila është një fjalë e shënuar për jetën time, që më mbushi me një besim të madh për të parë e sigurt të ardhmen time. Sepse shoku Enver ka thënë në atë letër t'i djeqim me zjarr zakonet prapanike dhe t'i këputim

kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave...

Shqipja filloi të rritej. Filloi të thithë aromën e jetës së re.

Çdo ditë shihte një djalë dhe, për çudi të saj, sa herë që e shihte, do t'i ndërronte fytyra. Sa herë që ai fliste në fshat, në mbledhjet e rinisë, zemra fillonte t'i gufonte me të madhe, sa herë që ai këndonte, kërcente ose së paku edhe emrin t'ia dëgjonte, dridhej e tëra, — atëherë ajo harronte që ishte e fejuar, që ishte e shitur në atë gufën e errët të vatrës dhe vetëm për të mendonte. Çfarë? «— Jo! Nuk mund ta them kam turp!... Por, jo! Pse të kem turp? Unë Petritin e dua. S'kam pse ta fsheh! Ne së bashku do të shkojmë në aksion dhe pas aksionit do ta shpallim fejesën!» — Më tha kur doli nga zyrat e kooperativës, ku kish shënuar emrin për të vajtur në aksion.

Duke thurur me mëndje plane për të ardhmen, për aksionin, ajo doli nga zyrat e kooperativës plot gaz dhe u drejtua për në shtëpinë e saj. Herë-herë duke ecur, e herë-herë duke kërcyer arriti deri te Qafa e Dhoksit. Atje qëndroi për një çast dhe duke përkëdhelur me vështrimin e saj shtëpitë për rrëth fshatit, grykat, mezhdat, duke ndjerë përkëdhelitë e erës që lëshonte Qafa e Bullit, ndërsa gjoksi i hidhej përpjetë nga gjëzimi, kur kujtonte të nesërmen, aksionin, Petritin... Do të shkonin me të në aksion... Disa trokëllima patkojsh ia ndërprenë mendimet. U trëmb pak. Ktheu kokën dhe pa atë. Kë atë? As ajo nuk e dintë, as ajo nuk e njihte. Pa një burrë me kokën e vogël sa të miut e me mustaqe spicë. Ndërsa tutje, tre kalorës kishin qëndruar në vënd.

Ai, kokëmiu e mustaqespica, i buzëqeshi vajzës, duke zbardhur majat e mprehta të dhëmbëve.

Edhe kjo e përshëndeti.

— Tprrruuu! — i foli ai kalit, dhe bëri të kërcejë si një maçok, po u pengua në yzengji, e sa s'theu qafën.

Shqipja për një hop u trëmb, pastaj iu dhëmbs, por kur vuri re që ai u ngrit menjëherë, si një cjak i penguar në ndonjë shkëmb, e pyeti:

— A u vratë, xhaxha?

Burri bëri sikur nuk e kuptoi fjalën e fundit «xhaxha!»

— Për ku shkonit kështu? — e pyeti ajo.

Fytyra e tij u mvrejt.

— Tek ti! Kam ndëgjue do fjalë të pahijshme për ty...

Shqipja pa me çudi, pastaj u kujtua që ish e fejuar me dikë. Por kjo s'e njifte atë. U drodh e tëra. Ndjeu diçka të tmerrshme në zemër. Me zor mundi të shqiptojë.

— .... Po pastaj?

— Pastaj? Pastaj kam ardhë me të marrë! Ti je gruaja e eme!...

— E pamundur!

— Të kam blemun me pare!

— Jo, kurrë! Ti, ti je...

— Ejani, bre burra! — vikati ai dhe vetë u hodh mbi të. Desh ta kapte, ta lidhte e të ikte. Po ajo e shtyu me sa fuqi që kishte duke bërtitur:  
— Ndihmë!

Vajza luftonte me dëshpërim. Tre «hajdutët» ishin trëmbur aq shumë në çastin vendimtar nga klithma e vajzës, sa që harruan paratë, që kishin marrë nga mustaqespica, e në vend që të bënин

punë, me të dëgjuar ca zëra që po vinin nga larg, ia krisën vrapi.

Por, ai, kokëmiu e mustaqespica, si një hamshor i tërbuar, nuk e lëshonte vajzën. Ajo po lo-dhej, por edhe ai po lodhej. Një shpresë e madhe e mbante vajzën: «Duro, duro edhe pak, ata po vijnë, po vijnë!»

— Të kam blemun me pare! Për ty kam har-xhue njëqind e pesëdhjetmijë lekë! Gjallë a vdekun nuk të le në dorë të huej.

Filloi të gulçojë, sytë iu errën, veshët i buçitën. Pranë, fare pranë dëgjoi të bërtiturat dhe atëhere u kujtua...

— Jo, jo nuk të lë të më shpëtosh kollaj — dhe ia nguli dhëmbët e tij të mprehta si të ujkut.

Ajo bërtiti fort. I dhëmbi shumë. Gjaku filloi t'ia mbulojë fytyrën. Ai nuk e lëshonte: — Tashti le të të marrin të tjerët! — u duk sikur desh të thoshte, po s'arriti, se një dorë e fortë e përfshiu dhe e përplasi tutje.

Nga fytyra e vajzës rridhete gjak. Faqja e majtë ishte dërmishë si nga dhëmbët e një kafshe të egër.

U rrënqetha dhe vetë nga ky kujtim i hidhur. Ngjarja Shqipes i kishte ndodhur disa muaj më parë.

Vazhdoj të lexoj hartimin:

«... Bift e Partisë, bift e shokut Enver janë ata, që, pa marrë parasysh asnjë vështirësi, bile pa marrë parasysh as...» Ishte një fjalë e prishur me penë, por që unë e deshifrova. Ajo fjalë desh të thosh: «As për shëmtirën time» — dhe vura re shenjën e një pike loti.

M'u kujtuan çastet e fundit kur ai djalosh, Pe-

triti i saj, me të dëgjuar zërin e Shqipes, doli vrik nga kulla e tij dhe kaptoi shkurre, ferra e gropat:

— Shqipe! — bërtiti ai.

— Petrit!

— Shqipe, kush të ka bërë kështu?

«— E duam ne gratë e malësisë shokun Enver, pasi ai jo vetëm na shpëtoi, por na dha mundësi, që fjala jonë të dëgjohet kudo... Prandaj shoku Enver është njeriu më i dashur përmua...»

E mbyll fletoren e hartimit duke përfytyruar Shqipen me Petritin e saj krah për krah të dy, në punë e në jetë. Dhe më vjen mirë, që unë jam mësuesi i Shqipes. Dhe e kuptoj akoma më mirë se përpara jetës jam një nxënës.

## DITËLINDJA E DËSHPËRIMES

Ashtu siç ishte i lodhur nga puna e rëndë, me mjekrën të parruar, po me shpresë të madhe, u drejtua për në kullën e tij: «Do të ketë ardhur apo jo? Me siguri djalë do të jetë!» — pëshpëriti dhe u var brënda në dhomë.

Vajzat e tij, që prisnin me ankth, u ngritën menjëherë në këmbë. Tri më të mëdhatë e panë të jatin me shpresë që edhe ai t'u sillte ndonjë lajm. Asnjeri s'foli.

— Akoma?! — tha pasi vuri re qetësinë e jash-tëzakonëshme që mbretëronte, — dhe vajti u ul pranë zjarrit. Nxori kutinë e duhanit nga xhepi dhe drodhi një cigare:

— Sill pak ujë të laj duart! — urdhëroi.

Fatmira, vajza më e madhe, si një konkë e bindur, solli me të shpejtë ibrikun dhe legenin dhe filloi t'i hedhë ujë të vakët duke vërejtur me kujdes rrudhat e thella në fytyrën e tij, duart e ashpra dhe të plasaritura.

Që të dy heshtnin. Vajzat e tjera, ato që ishin më të vogla se Fatmira, edhe kuptionin, edhe s'kuptionin ngajeta. Megjithatë edhe ato ishin të shqetësuara. Edhe ato prisnin diçka.

Kërcisti dera. Hyri plaka me një plaçkë në

dorë. Ishte një plakë nga ato të moçmet, e mbajtur mirë. E shkathët shumë. Por edhe pak e egër.

— Cucë përsëri! — tha, dhe e flaku në djepen pranë plaçkën që kishte në dorë.

U dëgjua një e virrur foshnjeje. Plaka i hodhi foshnjës një leckë të vjetër dhe vajti hapi kamarën për të nxjerrë paguren me raki. Pas kësaj, duke u zvarritur, hyri lehona, nëna e kësaj foshnjeje.

Xhezoja, posa dëgjoi fjalën «cucë», u zbeh e ubë si mermer! Kur pa lehonën që mezi mbahej në këmbë:

— Xhins femrash paskëshe qënë! — i skërmitti dhëmbët dhe doli nga dera duke zvarritur këmbët me zor e duke varur kokën pa ditur se ku shkon-te:

— Gjashtë vajza kam për të rritur! Gjashtë havalera! Xhins femrash! — shau nëpër dhëmbë.

Pa kuptuar as vetë, Xhezoja hyri në klub. Hodhi dy dopjo. U ngrit. Iu muarrën këmbët. Megjithatë vazhdoi. U kthyte në kullën e tij. Hyri në dhomë, por as foli e as hëngri. Ra për të fjetur.

— Ua, ua, ua! — qante foshnja.

Nuk duroi. Nxori kutinë e duhanit dhe drodhi një cigare, e ndezi dhe filloi të lëshojë me të fortë shtëllunga tymi.

— Çfarë emri t'i vemë? — pyeti plaka.

Xhezoja thithë me afsh cigaren dhe me sytë e tij të hapur ndiqte fjollat e tymit, që përhapeshin në tavanin e zi, të palyer kurrë me gëlqere.

Çfarë emri t'i vemë? — e ngriti më tepër zërin plaka.

Tymi i duhanit, në atë vënd të ndriçuar nga një llambë me fitil gjysëm të ngritur, sikur errësonë më tepër atë dhomë.

— Mortje! — oshëtiu papritur kjo fjalë.

— Çfarë thua kështu?

— Mortje, them unë! — dhe në të njëjtën kohë iu çakaritën sytë e u ngrit nga vëndi. Tymi i duhanit, që qëndronte pezull në dhomë, u rrrotulla rrreth trupit të tij.

— Mos, Xhezo, edhe ajo është gjaku ynë!

Ai ia hodhi sytë e tij të përgjakur lehonës, desh t'i thoshte diçka, por përsëri e mbajti veten dhe doli. Vajti të flerë diku jashtë. Ëndërra të këqija pa atë natë. «Gjashtë femra kam mbi vedë! Gjashtë dasma! Gjashtë varre!» Po oxhakun tem kush ka për ta mbajtë? Asnjë djalë!»

Yjet ndriçonin natën. Një hije me një plackë të vogël doli nga dera e shtëpisë. Tutje, tej, dallgët shkumbëzonin në mes të detit dhe shkumët dukeshin si pulëbardha, që ndiqnin njera tjetren. Xhezoja nuk donte t'ia dinte se kush doli nga shtëpia e tij dhe me se doli!

Në mëngjez herët u kthyte plaka me foshnjën në dorë.

— Dëshpërime e pagëzova! — tha ajo.

— Pse, nënë, ashtu?

— Atë e dimë ne! — shtoi plaka dhe hodhi vështrimin e saj krenar drejt të birit.

Xhezoja qëndronte shtrirë dhe fytyra e tij nuk tregonte as më të voglin shqetësim. Pesë vajzat rrinin rrreth e rrrotull së jëmës.

— Dëshpërime! — pëshpëritën tri më të mëdhat, ato që s'kuptonin e kuptionin nga pakë. Ndërsa nëna atë natë qau. Qau shumë.

Xhezua harronte të hiqte mjekrën, kish varur kokën dhe ashtu ecte gjithnjë thua se i kishte rënë mbi kokë i tërë mali i Shashicës.

— Ç'ke, o Xhezo, kështu? — e pyesnin.

— Lere, lere mos më ngani, ç'më ka gjetur mua, me se do të jetoj tashti, kush do të më mbajë, kush do të ma ruajë nderin?... Ojhak pa mashkull!

— Si gjithë të tjerët! Ashtu si të kanë rritur ty...

— Po unë kam gjashtë vajza!

— Të tjerët kanë edhe më shumë!

— Po ata kanë edhe djem!

— Edhe vajzat, secila do të ketë fatin e saj! Nuk janë më ato kohërat e para!

Së shoqes nuk i fliste fare, sikur ajo të ishte fajtore, madje kishte frikë edhe t'i afrohej, se mos kushedi lindnin përsëri «cucë». Dhe vajzat me radhë rriteshin. Edhe Dëshpërimja ajo më e vogla, ajo me sy të shkruar e me vetulla të zeza, me ato flokë të zeza sterrë e me ato faqe të kuqe si mollë rritej, e rritej e shëndetëshme! Të gjashta ishin të bucura. Kur buzëqeshnin aty pranë vatrës a kur bënин ndonjë lojë, Xhezos i ngrohej zemra, por kur ndonjera zinte e qante, e sidomos ajo më e vogla — atëhere vetëtinte dhe bubullonte zemra e tij:

— Mjerë ne ç'halle na kanë zanë!

— Eh, more burrë, secila do të ketë fatin e saj!

— Po, po, mbi kurrizin tim!

— Vetë i bëre!

— Desha djalë!

— Po ja që kështu qe e thënë, ç't'i bëjmë, ta hedhim vajzën e vogël? Si thua ti?

Në atë çast, vajza, sikur ta kishte kuptuar këtë bisedë, tha:

— Babi, unë e rrafa maçokun, se hëngri këlyshët e maces!

— Ashtu?! — foli pér herë tē parë Xhezoja me vajzën e vogël, pa e kuptuar as vetë se ç'ndjeu në ato çaste, kur pa se e bija po i drejtohej atij. I hodhi sytë nga e shoqja:

— Babi, pse nuk na tregon ndonjë përrallë tē bukur, si babi i Cezit? Iii, ç'përralla tē bukura që tregon ai, — dhe çakarati sytë e lëvizi muckat e e fytyrës kaqë bukur, saqë, së bashku me ato fjalë, e ngrohën shumë Xhezon.

— E, Xhezo, si thua ti, ta hedhim këtë vajzë?

Xhezoja u trondit, sikur ndjeu një shuplakë tē fortë nga këto fjalë, i hodhi një sv fëmijës dhe, pa i kthyer përgjigje së shoqes, zgiati dorën mbi kokën e vajzës e filloj ta ledhatojë. Ajo, si një mace e bindur, u tulit pranë tē jatit.

— Babi, pse i ke kaqë tē ashpra duart?

— Nga puna, shpirt i babit!

Flaka e zjarrit në vatër kishte marrë përpjetë dhe ndriçonte dhomën.

— Moj, qënka e zgjuar kjo?

— Çupat i kemi tē zgjuara!

— Po ç'e do, s'janë tonat! — i shpëtuan padashur këto fjalë tē bëra shprehi prej kohësh.

— Babi, kur tē rritem unë, do tē punoj shumë, shumë!...

Ku i kishte mësuar tërë këto fjalë kjo vajzë e vogël pesë-gjashtë vjeçë?

Trokëlliu dera dhe brënda u dhanë dy vajzat e mëdha, njera dymbëdhjetë vjeçë, tjetra trembëdhjetë, me kovat e mbushura me ujë. Shpejt e shpejt i zbrazën enët dhe filluan tē pastrojnë dhomën. Pastaj muarrën librat dhe filluan tē lexojnë.

Dëshpërimja u shkëput nga prehëri i tjet **dhe**  
**vajti pranë motrave.**

— Beti më trego një përrallë?  
— Po të rrish urtë, Beti do të të tregojë një  
përrallë të bukur, të bukur...

— Atë që ma tregove nesër!  
— Jo nesër, po dje!  
— E, dje, se harrova atë: ishte një baba e një  
mama...

— Po: «Ishte një mama e një baba. Këta kishin  
gjashtë vajza — dhe më e vogla quhej Dëshpëri-  
me. Babaj i kishte duart tërë kallo, se punonte shu-  
në në punë, mamaja i kishte duart tërë rrudha,  
se lodhej shumë në punë!...»

Xhezoja ktheu kokën nga ato:  
— Po ku i mësojnë këto! — ja bëri dhe u ngrit  
e doli nga dhoma. E ndjeu veten më të lirë, më  
të lehtë! — Për herë të parë mendoi për gjashtë  
vajzat. Për herë të parë u pendua që vajzën më  
të vogël e kishte pagëzuar Dëshpërime. «Pse Dësh-  
përime? Pse të jem i dëshpëruar me të?»

Njëra pas tjetrës vajzat po rriteshin, po mbaro-  
nin shkollën shtatëvjeçare.

Xhezoja shikonte: — Shtëpia, sa hap e mbyll  
sytë, pastrohej, lahej, fshihej:

— Ti shko për ujë, ti fshi xhamet, ti mëso  
mësimet, se na turpërove; t'i bëj drekën! — jepte  
urdhëra Fatmira, goca më e madhe.

— Po unë q'të bëj?  
— Ti, Dëshpërime, të pregatisësh mirë rolin që  
të kanë caktuar, dhe shih, sot duhet të këndosh  
bukur, sot do të vinë nga qyteti të të shohim; do  
të vinë nga qyteti e ne do t'u japim fjalën për  
të vajtur të gjithë në aksion.

Xhezoja po dëgjonte e s'po kuptonte asgje: «Në vënd që të mendojnë për të vënë ndonjë plaçkë, se nesser do të martohen, vënë e më merren më punët e fshatit, do të na turpërojë ndonjera...»

— Po ç'ke ti, or Xhezo, ti kaq kishe keq, sa t'i rritje, tashti ato vetë le të mendojnë për vete. Po të punojnë, do të venë plaçka, po të mos punojnë...

— Po turpin ama e ha unë!

— Baba, — e ndërpreu nga biseda me të shogen, Fatmira, — sot së bashku me mamanë do të vini në çfaqje. Jepet një çfaqje e madhe dhe e bukur, do të shohim në skenë Dëshpërimen tonë. Do të luajë si aktore, do të këndojojë.

Desh dhe s'desh të vinte. Xhezoja s'para i kishte për zemër këto lodra. U kundërshtoi, i shau vajzat, si dikur, kur i propozuan për Vikon, vajzën e dytë, që të bëhej infermiere, mami, se e mirrte për keq profesionin e mamisë, sikur do t'i mirrej nderi nëpër këmbë, por ama nuk tentoi të qëllojë, siç ishte matur atëhere për Vikon, se i tillë ishte prej natyre. Si të thuash edhe u mësua me këto propozime. Më vonë, kur Gjeraqina, vajza e tretë, kishte vajtur së bashku me katër shqipe në malësi të Dukagjinit për shkëmbim eksperience, pa dashjen e tij, rrahu poshtë e përpjetë si një kalë i trullo-sur! Pastaj, kur ata të Dukagjinit u dërguan fletë-lavdërimi, dhe kur kryesia e kooperativës organizoi një mbledhje të posaçme për këto, ku lavdëruan në mënyrë të veçantë Gjeraqinën, për shkathësinë dhe për eksperiencën e pasur që kishte shpënnë aty dhe që kishte marrë prej andej, ai ishte zbutur. Kur dëgjonte nga njeri e nga tjetri ndonjë fjalë të mirë për to, i bëhej zemra mal. Mirëpo pasi

mendohej pak dhe futej në ato mendime të mbe-tura nga koha e shkuar, dyshonte: Të tjerët ia lav-déronin pér interes çupat, se i kishte të bukura, ose që t'i lejonte të shkonin në mbrëmjet e vallzimit... Po tashti puna ishte ndryshe, e bija do të kë-ndoka në skenë. Do të vijnë nga qyteti e ta shikojnë. Do të bëhet një mbledhje e madhe fshati... Dhe në atë mbledhje do të marrën pjesë të gjithë. Të bijat ngulnin këmbë, që edhe ata të venë aty:

- Le të vemi njëherë! S'kemi vajtur kurrë!
- Baba, mos i folë me «moj», mamasë!
- Vemi e shohim ç'bëhet, si këndon vajza jonë!

— Të vemi, po si të vemi, do të na qeshin!  
— E pse t'ju qeshin, baba, kush do t'ju qeshë?  
Dhe Xhezoja u lëkund.

— Sa bukur që këndon dhe luan Dëshpërimja jonë. Keni pér të parë dhe keni pér t'u habitur. Ti, baba, s'e ke parë asnëherë, s'e ke dëgjuar asnëherë! — Çohu e ta shohim, do të rrimë të gjithë së bashku në një radhë, në një vënd, — e ngac-moi Vaideja, vajza e katërt.

Tërë familja e Xhezos u ngrit që të shkonte e të shihte çfaqjen, që do të jepte vatra e kulturës së fshatit, dhe do të merrnin pjesë në mbrëmjen, ku të rinjtë e të rejtat do të jepnin fjalën pér të vaj-tur në aksion.

Xhezoja me të shoqen, të shoqëruar nga të bijat, u drejtuanc pér në sallën e mbledhjes...

— Shiko, shiko, paska dalë edhe Xhezoja sot!  
— Po shyqyr, o Xhezo, shyqyr që të pamë su-ratin...

— Vallahi, s'kisha ç'u bëja gocave, pa ku janë pér ne këto mbledhje, këto mbrëmje...

— Jo, Xhezo, e ke gabim, ne që s'kemi parë duhet të shohim, pa këta rinia, jetën e kanë përpara.

— Po, po! — dhe vazhdoi të ecë ashtu në mes të tufës së fëmijëve të tij të hutuar.

— Brigadiere, nesër ku do të punojmë? — e pyesnin Fatmirën!

— Merushe, do të vish në aksion?

— Pa tjetër! — u përgjegj ajo.

— Përse ju folën në seminarin e shëndetësisë, dje në qytet? — E pyeti sekretari i partisë Vikon, vajzën e dytë.

Ashtu, në mes tyre, dhe nga fjalë që dëgjonte herë këtu e herë aty, herë për veten e tij dhe herë për vajzat, Xhezua u shastis fare dhe i dukej sikur për herë të parë po dilte në fshatin e tij.

— O, mirse na erdhët, mirse na erdhët, sot do të dëgjojmë Merushen se si do të na flasë për aksionin, do të shikojmë edhe Dëshpërimen në skenë.

— e priti përgjegjësi i sallës.

— Ashtu themi!

— Urdhëroni, urdhëroni, ju kemi ruajtur vëndet më të mira.

Mbledhja filloi. U ngritën shumë veta dhe folën. U ngritën dhe Merushja me Sadeten, vajza e katërt dhe e pesta. Që të dyja shprehën dëshirën e madhe për të shkuar në aksion që në turnin e parë, në turnin e dytë do t'u linin radhën motrave të tjera.

Xhezoja vetëm dëgjonte. Ai e dinte që do të shkonin në aksion. Por që të bëhej një ceremoni kaq e madhe për në aksion, këtë gjë s'arrinte ta kuptonte. Dhe as që desh ta kuptonte. Ato fjalë që dëgjoi aty, ai i kishte dëgjuar qindra herë nga

të bijat, aty pranë vatrës, ose kur mblidheshin të gjithë së bashku dhe hanin drekë a darkë.

Grumbuj të rinjsh dolën në skenë e, në mes të tyre, u duk edhe Dëshpërimja. Në skenë Dëshpërimja! Xhezos filloi t'i rrahë zemra me të fortë. Ai shikonte. Kur pa Dëshpërimen në skenë, s'e mori vesh fare se ç'folen ata të tjerët, shokët e saj, veç kur dëgjoi prapa krahëve dhe anash duartrokitjet nga ana e spektatorëve. Se si nga ai grumbull aktorësh nga fundi i skenës çau në mes tyre e para skenës doli vajza çapkëne, me leshra të derdhura, me faqet buçkë, pak ezmere — Dëshpërimja, — dhe prapa saj një djalosh me çifteli. Xhezoja filloi ta humbasë, nuk e kishte ndjerë veten kurrë kaq të emocionuar sa sot, — Dëshpërimja e tij në skenë! Ajo rrrotulloi njëherë sytë rreth salles dhe pastaj i ndali te i jati. I buzëqeshi.

Pastaj, heshtje. Telat e çiftelisë lëvizën shpejt nën gishtat e shkathët të djaloshit. Befas u dëgjua zëri i kulluar i Dëshpërimes. Ajo këndonte një këngë të vjetër, një këngë trimërie, që e këndonte dikur populli i shumëvuanjtur, që e këndonte dikur edhe ai vetë, Xhezua.

«Urра! Urра! Dëshpërimja, Dëshpërimja! — edhe një herë në skenë!» — dëgjoi prapa krahëve breshërimën e hareshme, kurse vetë, i shastisur, harroi t'i lëvizë duart; rrinte i shushatur. Në krahët e shtrëngonin fort të bijat:

— E, baba, e shikon, Dëshpërimja na nderoi, do ta bëjmë artiste, — si thua?

Atë natë, ndaj të perënduar të diellit, Xhezua u kthye në shtëpi së bashku me Sekretarin e Partisë, me Kryetarin e Kooperativës dhe me një grup të rinjsh e të rejash.

I kishte ftuar ai vetë, të bënин një copë muhabet.

Kur sosën në shtëpi, Xhezua u gjallërua, ftoi miqtë të zinin vënd, pastaj, duke mbajtur pranë Dëshpërimen, thirri tërë gaz:

— Mirë se na erdhët në konak!

— Grua prejau kokën dy gjelave të bardhë! Çupa, na bëni gati mezetë! Viko, sillna raki! Sot do të festojmë ditëlindjen e Dëshpërimes.

## «BURRNESHË E NANËS!»

Në vatrën e kulturës, në këtë ndërtesë kaq të bukur, ishin mbledhur njerëzit në kuvënd pér të akuzuar, pér të dënuar një grua...

Flakë ishin ndezur kokët e akuzuesve, të popullit. Tym ishte bërë mëndja e asaj që akuzohej. I dukej një gjë e çuditshme, e padrejtë, e pér më tepér, e tmerrshme, se ajo po akuzohej se atë po e dënonin, e pér kë thoni? Pér të bijën e saj, pér gjakun e saj... E akuzonin atë, se ajo akoma s'e kish kuptuar që e bija tashmë i përkiste së resë, gjithë popullit.

Akoma më e tmerrshme i dukej akuza se ajo ishte femër dhe dënohej sikur të ishte burrë — si dikur në log të burrave. Akoma më e tmerrshme ishte se atë po e akuzonin jo vetëm burrat dhe gratë, po edhe fëmijët, edhe pleqtë. I dukej sikur ishin ngritur edhe malet përreth, edhe fushat përreth. Ajo i shikonte këto, megjithëse s'dukeshin. Ajo i ndjente akuzat. I dukej sikur gjithë këto male, këto fusha turfullonin, duke mbytur vëndin rreth-e-rreth në mjergull.

Po ndeshej e reja me të vjetrën.

Atje s'kishte gong që të ipej sinjali i fillimit të ndeshjes. Atje s'kishte as zile të gjykatësve pér të ndaluar zhurmën.

- E kam bijën teme, s'keni pse të hyni në punët e mijë!
- E ligë, e poshtër, po shkel gjakun tand...
- i dukej sikur e breshëronin fjalët si shkëndija flake. Nuk mund të fliste.
- Ç'kish bërë ajo, përse akuzohej?

\* \* \*

«— O nënë më ka dalë bursa, do të shkoj në shkollë!

— «Ku-ku, qe m'u prish cuca, qe i dolën fare mendtë» — mendoi. — Ti je e fejueme, moj bijë, si guxon e qit helme të tilla nga goja?

— Unë, moj nanë, due me mësue në shkollë!

— Jo! — kish kundërshtuar e ëma.

Dhe këtë vendim të saj as topi s'e kishte lojtur. «Nu, dhe nu!» «Jam burrneshë mali dhe fjala ime asht ligj!» — mendonte ajo — dhe harronte se e bija po dilte më burrëreshë, po dilte burrëreshë me shkollë.

Afroi viti shkollor. E ëma e Dritës mori masa. E mylli të bijën te dajllarët e saj. Dajllarët e mbajtën, e ruajtën sipas të vjetrës, — ndërsa ajo — Drita Hoxha — e vetme do të thoni ju? Jo, me të gjithë, po thurte plane për...

... Dhe një ditë i ra rrufeja plakës në shtëpi. Shkolla kishte dy muaj që kish filluar. Plaka e kishte fjetur mëndjen. — Plaka me vjehrini e së bijës po thurnin disa plane fshehurazi, që mos ta merrte vesh bota. — Por edhe malet e morën vesh...

Pra e bija iku. Fshati e strehoi. Dhe pastaj ajo

ja mbajti drejt e në seksionin e arësimit të Burrelit.

Plaka u hakërrua kundra fshatit të tërë. Plaka mallkoi të bijën. Plaka u ngrit të kërkonte të drejtën. Drejtësinë.

— Ma kanë rrëmbyer cucën! — ankohej.

Dhe drejtësia e ballafaqoi vajzën me nënën.

Nëna qante! Vajza jo! Vajza doli më burrë reshë.

Dhe plaka ishte e zgjuar.

— S'të vjen keq për mue? S'të vjen keq për familjen që korite, që e bane gazin e botës?

Drita vetëm shihte. Shihte t'ëmën në sy! Shihte edhe gratë edhe burrat që ishin në zyrë.

Ajo nuk i njihet ata, vetëm inspektorin e zonës së saj, atë djaloshin ezmer që kish parë dikur, kur kish ardhë për inspektim, dhe tashti iu duk si vëlla, madje më tepër edhe se prind, si mprojtës i saj.

— Jo, nëne, unë s'ju korita! Pse ju dua fort, prandaj dua të vazhdoj shkollën. Dua t'ju nderoj!

— dhe pa nga inspektori i zonës së saj. Ai i bu-zëqeshi.

— O bisha të ndyta, ju ma morët cucën në qafë! Prandaj vijshit në katund, që të ma rrëmbenit! Tani po e mësoni që të flasë kështu!

— Jo, nëne, këta s'më kanë mësuar! Ti vetë më ke mësuar të jem burrleshë! Të mos trembem, të mos tutem! Dhe unë vetë vendosa të mos tutesha, të shkoja në shkollë.

— Mallkuar qofsh dhe helm t'u bëftë qumështi i gjirit tim! — bululloj me zërin e saj të fortë të hakarritur. Dhe u zhduk.

Kishte vendosur të mos e pranonte më të bijën

në shtëpi. I kishte hedhur mallkimin më të rëndë. Prandaj ishte ngritur i tërë fshati! Prandaj të gjithë bashkëfshatarët e saj e akuzonin atë, nënën. Prandaj edhe nënës tanë i ishte bërë tym koka duke parë tërë zemëratën e stuhishme të bashkëfshatarëve të saj.

«C'kam bërë? Mos nuk kam vepruar drejtë, që u ngritën të gjithë kundra meje?» — mendonte me vete duke dashur të arësyetonte.

Po çfarë ndodhë?

- Na prishe zakonet tonë!
- Na turpërove kuvendin e burrave!
- Kur s'të përpjua dheu më parë!
- Moj, a je në vete? Si flet kështu kundra cuçës sate?!
- A ke kryet në vend, apo...

E mallkonin, i bërtisin, e shanin gjithë ai popull.

Asnjeri nuk e përkrahte! Asnjeri nuk i tha «të lumtë!»

«A jam në vete, apo jo? A jam burrëreshë, apo jo? C'po ndodh me mua? Duhet të fitoj pa tjetër!»

— Burrëreshë e vetme në këtë log burrash, në këtë kuvënd, ku ka ardhur i madh e i vogël, nuk mund të jesh! — dëgjoi prapa zérin e një gruaje.

— Burrëreshë, kur janë ngritur të gjithë të të gjykojnë, e të të akuzojnë, nuk mund të jesh! Cucha jote ka të drejtë! — i foli një moshatare e saj, që ishte përballë, që mbante bile edhe kobure në brez. Ajo ishte vërtet burrëreshë, se kishte kapur me dorën e saj hasmin e katundit, kur po u vinte zjarrin stallave të kooperativës.

Dhe filloi të kujtojë dikur burrat e katundit të

saj, me tytat e pushkëve nxjerrë nga frëngjité e kullave.

I tërë populli i Fullqetit ishte ngritur kundër saj. — Ajo kundër kujt të shtinte më parë?!

E vetme po ngrihej kundër të gjithëve.

«Kanunit ja kishin marrë erën prej kohe!» — këtë e dinte. Po nderi i saj, po sedra e saj? U pendua! Iu kujtua e bija në atë sallë, në atë ballafaqim, në atë kohë kur ajo e mallkoi.

E bija qëndroi burrëreshë, ajo nuk qau, ndërsa kjo, e ëma, derdhi lotë!

«A jam burrneshë? ... Jo!» — Një mendim i dyfishtë filloi t'i vejë e t'i vijë në kokë.

— Bija jote, pjella jote doli burrneshë dhe jo ti. — ajo na nderoi femrën matjane, ajo e gjeti lirinë dhe e çfrytëzoi atë, se ishte burrneshë, se deshte të nderonte prindërit e saj, fshatin e saj, tërë rrëthim e Matit — prandaj është burrneshë. — foli një djalosh i ri.

Ia morën mendjen këto fjalë që dëgjoi. Në kokë sikur filloi t'i zhdukej ai tym, — tymi i zi. Filloi t'i kthjellohej e t'i kthjellohej koka, dhe ta shihte të bijën, Dritën, të parën ndër të parat nxënëse atje në Tiranë, atje në teknikumin ekonomik. Zemra filloi t'i gufojë me të fortë.

«Ajo është burrneshë dhe jo unë që e akuzova, që e mallkova!» — mendoi me vete dhe ngriti kokën për të parë turmën që po e shihte, për të parë malet, fushat që prisnin të dëgjonin jehonën e zërit të saj dhe atë jehonë ta përhapnin anembanë dhe t'ia shpinin në vesh edhe së bijës.

I erdhi turp nga vetja që ndodhej si e akuzuar në atë kuvënd. Mundohesh. Filloi të mundohesh, të kërkonte fjalë për të shpëtuar nga ajo gjëndje, por më kot.

Sytë filluan t'i lagen me lot, buzët filluan t'i dri-dhen:

— Burrneshë e nanës! — pëshpëriti me një grahmë të fortë dhe... asnë fjalë më tepër. Pikërisht në atë heshtje, në atë pipëtitje të buzëve të saj shpërtheu një vullkan zérash e duartrokëtjesh. Nga dhjetra sy që i ishin ngulur asaj u dukën sikur shpërthyen qindra shkëndija, që u bashkuan dhe formuan një flakë të tillë, e cila e zhduku atë njo-llë tymi, që pak më parë përdridhej si gjarpër në kokën e kësaj gruaje.

## G J Y S H I   D H E   N I P I

Atë ditë ata prisnin. Prisnin ndenjur përjashta që të ndodhte nga çasti në çast ajo hataja e madhe, që të pllakoste ata që ishin futur brenda.

— Oh, sa do të më bëhet qejfi! Ta shohin edhe një herë vetë me sy ata; ta pësojnë një herë mbi kurrizin e tyre hatanë e të marrin vesh pastaj se ç'domethënë të shash Allahu, se ç'do të thotë të shkelësh vëndin e shenjtë e ta quash... vatër kumture a kulture! — çfryhej plaku Qato Lala i struktur n'atë qoshe aty me llullën në gojë. Në prehër mbante nipçen e vogël katërvjeçar. I vogli, që s'kuptonte as allah e as perëndi, me sy të çakërdisur, priste të shihte kuçedrën, që do të rrëmbente ata të tre vetët e futur brenda e t'i kallte në një gjëmë flakësh përcëllonjëse, ashtu si pat dëgjuar nga përrallat e gjyshit. Plaku priste edhe diçka tjetër: Piste të dérgonte Allahu rrufenë nga qielli e t'i bënte shkrumb e hi ata hairsëzët e rinj që e kishin rrrethuar xhaminë nga jashtë me kazma e me lopata në duar...

Dielli kish kohë që ishte ngritur, por retë e dëndura dhe të nxira ja kishin fshehur rrezet, sikur t'ja kishin thithur tërë dritën.

— Shih si po vjen e keqja! Allahu nuk len pa marrë hak! — pëshpëriste plaku, ndërsa fëmija i hodhi sytë tej e tej nga malet e Thelapatës e të Mollës. Një shtëllungë e madhe resh, resh të zeza

sterrë, shoqëruar me një fërshëllimë e rrapëllimë ere të fortë, po drejtohej këtej nga plaku, këtej nga vëndi i shenjtë, këtej nga ishin ngritur ata të rinx të qëmëndur me shata e lopata!...

Fémija, me fantazinë e yshtur të gjyshit, po shihte i llahtarisor se si po afrohej lubija kaluar mbi retë me erërat e forta për të dënuar... Kë?

— Ikim te mëma, babagjysh! Ikim te mëma! — filloi të dënesë e pastaj të qajë me zë.

— O trim i gjyshit! Ne jemi me Allahun! Asgjë s'na bën lubija! Jemi njerës të Allahut! — e ngushëllonte ai.

Kurse të rinxjtë e tjerë nga jashtë prisnin që të dilnin ata që ishin futur brenda, prisnin të sillnin ndofta edhe thesarët e Ali Babait! Edhe këtë e kishin dëgjuar nga pleqtë!

Rëtë e zeza, si një çarçaf mjergulle pa fund, mbuluan xhaminë. Për një copë herë Allahu sikur kishte vënë perden e zezë midis atyre që ishin jashtë e prisnin me ankth dhe atyre që ishin futur brenda.

— Ja edhe pak, ja edhe pak dhe hataja e madhe do të ngjante! — ngushëlløhej e shpresonte plaku me nipçen struktur në prehërin e tij.

Retë e zeza kaluan mbi kryet e të rinxve, që prisnin me kazma e lopata; kaluan edhe mbi plakun e struktur dhe të nipin dhe, pastaj, si për çudi, u duk përsëri xhamija në këmbë si ishte e, përmes llamburitjes së rrezeve të diellit, që feksën sakaq, duallën nga dera e xhamisë tre vetë, që u dukën në fillim si siluheta, pastaj, në rrezet e diellit, fëksi pluhuri në fytyrat e tyre, në xhaketat e tyre. Njeri mbante diçka në dorë! Po çfarë se?!

Fërkoi sytë e mjekrën: a ishte e mundur të dilnin gjallë ata ashtu të qeshur e të gëzuar?!

— Oho, oho! Duallën! Duallën! — brohoritën të rinjtë sa i panë e dikush pyeti:

— Çfarë është ajo që mbanë në duar?

Asnjeri nga të tre vetët nuk e hapi gojën.

— O shoku mësues! O Shqipe e Hysen Kolës! O Sali i Mollajve, ç'paskeni gjetur aty në xhami? — vazhdonin pyetjet.

Por të tre të rinjtë iu afroan plakut fanatic, i vunë përpara atë që mbante mësuesi në duar duke i thënë:

— Ja kujt i je falur denbabaden! — dhe ia vu-ri përpara këmbëve.

U grumbulluan të gjithë rreth plakut fanatic.

Të gjithë panë se si plaku me majën e shkopit trazoi plackën e çpalosi dhe... për habinë e të gjithëve, e sidomos të plakut, u ndeh përpara tyre një leckë e vjetër me disa brima plumbi e një e çarë prej...

— Bajrak osmanllijsh... — psherëtiu thellë plaku!

— Si, flamur osmanllijsh! Tamam flamur osmanllijsh! — shtoi me zë të lartë mësuesi i fshatit.

— dhe filloj ai t'u shpjegonte të rinjve të fshatit për atë sundimin shekullor më të zi, që e pat mbajtur popullin tonë në skullavëri e për luftën heroike shekullore të popullit tonë për të shpëtuar nga ky sundim.

Qato Lala dukej sikur nuk e dëgjonte mësuesin e fshatit, por në të vërtetë, atij një ngjyrë, i vinte, një ngjyrë i shkonte. Të rinjtë u vërsulën dhe, me shpejtësi, e pastruan xhaminë nga brenda, e rregulluan nga jashtë. Zëri i urrejtjes ngrihej në kuptë të qellit bashkë me këngën e punës për ta bërë atë kënd një vatër kulture.

Kurse në këtë aksion të madh e të hareshëm të rinisë së fshatit, vetëm Qato Lala zhytej thellë e më thellë në një kujtim të largët, shumë të largët:

«Po, po: po ai nishan, po ato vrima, po ajo e çarë, veçse... shumë të vjetëruara.» — mendonte plaku duke u dridhur e me një qëndrim të çuditshëm të fytyrës, të duarve, të trupit. Ja, ja, iu errën sytë. e si atëhere, si në kohën e grahamës së fundit të osmanllijvet, po i kalonin shtëllunga të zeza sterrë e po sulmonin çetën e kësaj malësie. ku bënte pjesë edhe vetë ai, Qato Lala njëzetyjeçar. Iu kujtuan momentet kur ata sokolë mali kishin dalë nga pritat i qenë sulur asaj lubije që dredhonte së largu, por që, kur iu afroan, u duallën halldupë shallvaregjërë me callma të ngjeshura në kokë. U kacafytën trup me trup e grykë më grykë me ta. Thikë më thikë e dhëmb më dhëmb u përleshën me njëri tjetrin. Bajraku osmanlli i printe përpara hordhisë së çakërdisur. Flamuri dykrenar u printe çetave shqiptare.

— Bjeri, Qato bajrakut të halldupit! — e pat porositur komandari i çetës. Dhe Qato Lala iu sul këmba-këmbës halldupit me çallmë në kokë e me bajrakun në duar. Dy herë e qëlloi bajrakun me dy plumbë! Pastaj me kamë xhveshur iu derdh halldupit, që më ishte majë kalit. Bjerë ai, e bjerë ky! E halldupi u rruckullis nga kali e Qatoja i kërcëu mbi shpinë. Por... disa nga turqit i vajtën në ndihmë halldupit me bajrak. Komandari i çetës i vajti në ndihmë me trimat e tjerë Qatos. Ai s'pa më s'e ç'u bë më tej, veçse duke u rrokullisur i plagosur rëndë, vuri re komandarin që pat tërhequr edhe bajrakun osmanlli, që i kishte ngulur kamën e vet.

— Po vdiqa, këtë lëvere të osmanllijve të digjni mbi varrin tim! Ky është amaneti që ju lë! — dëgjoi Qatoja zërin e këputur të komandarit të vet; dëgjuan edhe trimat e tjerë.

— Ruaje, Selim, bajrakun, sa t'i çporim halldupët! — i patën thënë trimat Selim Mustakut, që hiqej si hoxhë i fshatit!

... Dhe lufta u bë e ashpër, më e përgjakë-shme! Lubia u rrëkellye ku me kokë ku pa kokë, ku me bisht e ku pa bisht e ndjekur nga çetat shqiptare!

Trimat u kthyen të nderonin komandarin e tyre dhe të plotësonin amanetin e tij. Aty mbi Qafën e Bullit e varrosën: breshërima e plumbave oshëtiu anembanë malësisë si shenjë nderimi. Mbi varrin e tij, për hakmarrje, u dogjën dy bajrakë osmanlinjsh të kapur. Por bajrakun që e kishte zënë vetë komandari dhe për të cilin kishte lënë amanetin, nuk e dogjën mbi varrin e tij, sepse Selim Mustaku-hoxha i fshatit bëri be e stërbe se atë ja kishin rrëmbyer përsëri halldupët! Besuan e s'besuan trimat e komandarit, por u ngushëlluan se i kishin djegur edhe ata dy bajrake!

Mirëpo... ja ku na qënka ai bajrak halldupësh! Të jetë e vërtetë?!

— Ku, ku e gjetët? Në xhami vërtet? — pshereëtiu plaku Qato Lala me dhimbje të madhe.

— Ku e gjetëm? E gjetëm të varur në ytbé. Gjysmëhënën e kishin mbuluar me ato shkaravina arabe sa për t'ua zënë sytë besnikëve! — e sqarroi mësuesi i fshatit.

— Jo, s'është e mundur t'i jem falur këtij... Ah, Hoxhë, ç'na paske mashtruar, ç'na paske gënjyer dhe ne, qorrët, të kemi besuar!

U përkul, zgjati duart e tij të thekura, e rrëm-

beu me neveri e urejtje atë lëvere të hedhur përtokë e filloi të bërtasë me të madhe: «Këtu qënke futur — a? Kush të ka futur? Kush? — gjirresh duke e bërë copa-copa bajrakun e halldupëve!

Të gjithë të rintjtë ishin shtangur: nuk kuptionin se ç'po ndodhte. Panë se si plaku fanatic Qato Lala nxori eshkën me urorrin. E ndezi dhe ja dha nipçes duke i bërtitur:

— Na, veri flakën, bëje shkrumb të mallkuarin bajrak!

Kalamani sikur po luante me babagjyshin: fryu-fryu e dikush i dha edhe një shkrepse të ndezur: lëverja sëpari filloi të vjellë tym të zi, pastaj u dhanë gjuhëra flake. Fytyra e plakut aty për aty po merrte herë një çehre, herë një tjetër.

Të rintjtë nuk po kuptionin se ç'po ngjiste me plakun, por dukej se ai po jetonte çaste të një çgënji mi të tmerrshëm që shpërtheu më në fund me një britmë të fuqishme:

— Gënjeshtar! Tradhëtar! Mos të trettë dheu aty ku ke rënë! Gënjeshtar! Tradhëtar! — skërmitti dhëmbët. Pastaj, duke shkelur mbi hirin e bajrakut të halldupërisë, duke vështruar vëngër folenë e mashtrimit, xhaminë, i tha të nipit të vogël:

— Shko me ata! Ata e kanë me vete të vërtetë, drejtësinë!

## KU MË PASKA PA?

— Ju ku e kini librin? — i foli mësuesi i ri i gjuhës një nxënëseje të tij të klasës së pestë.

Vajza e vogël uli kokën dhe sytë iu mbushën me lot.

— Përse qan, mos të humbi?

— Jo, jo... ma rrëmbeu babagjyshi!

Për një copë herë mësuesit iu ngritën leshrat e kokës: «Si është e mundur?! Jo, s'ka mundësi, deri sa ai e dërgon në shkollë, deri sa ajo mëson kaq mirë!... S'ka mundësi ta pengojë pér të lexuar libra jashtë klase...»

— Mos qaj! Do të vij të flas me babagjyshin tënd! — e përkëdheli mësuesi vajzën e vogël.



Mësuesi bashkë me kolegun e tij, Tomorrin, u nisën pér shtëpi të nxënëses së tyre. Me që ishte rasti i parë që po shkonin në një shtëpi të këtij fshati, e ndjenin veten pak të ndrojtur, pasi ende nuk i njihnin njerëzit e fshatit, zakonet e tyre. Pastaj, atë babagjyshin e vajzës e përfytyronin si një bablok plak e të egër, a më mirë të themi

si një plak të mbytur në trashtinën shekullore. Pra duhej të silleshin me shumë takt me të, për çdo gjë. Duhej të tregonin pjekurinë e tyre si arësimtarë, si përfaqësonjës të së resë.

Ishte ndaj të ngrysur. Majat e maleve të Thannës e të Kali-Baçit kishin mbi kokë nga një kësulë mjegulle.

Të dy mësuesit trokitën me ndrojtje në derë.

— Erdhën mësuesit! Erdhën mësuesit! — u dëgjuan zëra fëmijësh.

U hap dera. Burra e gra, që ndodheshin në dhomë, u ngritën në këmbë. Sa hap e mbyll sytë, u shtruan qilimat e postajet prej lëkure. Të gjithë u vunë në lëvizje. Njeri ua mori palltot, tjetri këpucët, që i kishin lënë te dera. Ndërsa pranë oxhakut qëndronte i ndenjur një plak i shkuar nga mosha, me një llullë të madhe prej shqopi në gojë.

«Pa tjetër ai duhet të jetë!» — menduan mësuesit.

E përshëndetën plakun dhe u ulën në çiltetë prej lëkure pranë zjarrit.

Dy kërcunj të mëdhenj, të vënë në oxhak, nxirrin një flakë shumë të bukur.

— Po si jeni, si shkoni, a jeni mërzitë ndopak? — Shyqyr që na kujtuat një herë! — e nisi muhabetin i pari plaku.

Sakaq përpëra arësimtarëve dhe burrave të shtëpisë, që ishin aty u vunë pagurkat me raki e pjatat me meze.

Mësuesit përgjigjeshin për çdo gjë me buzën në gaz. I dëgjonin me këershëri historitë e gjyshit, Herë-herë qeshnin, herë-herë kuvendorin me zjarr, se fjala sillte fjalën. Edhe mësuesit e rinj ku drejt-përsëdrejti, ku tërthorazi në atë kuvend familjar e të ngushtë sillnin fjalën e jetës së re, fjalën e Partisë.

— Po ajo cuca ime, si shkon me mësime? — py-  
eti papritur plaku.

— Shumë mirë, éshtë vajzë e zgjuar!

— Seç kishte dje një libër dhe...

— Po, po, ua kam dhënë unë pér ta lexuar jashtë  
klase! — u përgjegj sakaq mësuesi ynë i gjuhës, du-  
ke i hedhur një sy me qëllim kolegut tē vet.

— Na ndodhi një historizë me atë libër! Trego-  
ja, baba, këtyre! — ndërhyri një burrë i ri, siç du-  
ket i jati i vajzës.

— Eh, or bir, jemi mplakur shumë e ngando-  
njëherë nuk dijmë se ku jemi e se si jemi... Pleqë-  
ria i ka fajet!... E që thoni ju, o shokë mësues,...  
— vazhdoi plaku tregimin e tij.

Fytyra e tij filloj tē marrë ngjyra tē ndryshme  
nën dritën e llambës tē varur aty mbi oxhak. Zëri i  
ngadalshëm dhe mimika pasqyronin dlrësinë e tij.  
Arësimtarëve u dukej sikur po i jetonin vetë ato  
skena tē së kaluarës:



«... — Moj cucë, ç'e ke atë libër?

Libër, babagjysh, libër, ma ka dhënë mësuesi  
i gjuhës që ta lexoj jashtë klase. Të gjithëve na ka  
dhënë nga një...

— Ej, pa le ta shof njëherë...

— Urdhëro, babagjysh, po me kujdes mos e  
ndragish...

Babagjyshi e mori librin dhe me vështirësi  
shqiptoi fjälët: L...u..l..i i v.o...c...ë..rr. Pas-  
taj e largoi nga sytë. E çfletësoi, por nuk lexonte  
dot asgjë. Atëhere ja zgjati së mbesës:

— Pa le tē tē dëgjojmë ty ç'thotë ky libër, se unë nuk shof.

Vajza e mori librin. E çfletësoi me tē shpejtë. Gjeti skicën «Legjenda e Misrit» dhe filloi tē lexojë.

Plaku gjithë veshë e sy po dëgjonte... Vajza vazhdonte me atë zérin e saj tē kulluar e plot zjarr. Plaku dalëngadalë filloi tē zhytej nē tē thella nga fjalët që dëgjonte, nga fjalët që i përpinte.

— Ashtu ishte, ashtu ishte! — pëshpëriste shpesh herë. — Me tē vërtetë ashtu ishte!

«Misér! Misér!

«Lajmi se do tē shpérndahesh misri, duel nga zemra e dheut, rrodhi nëpër dejt e thellë deri te gjymtyrat e mpita tē dheut, që quhet shtet dhe bani tē dridhen nga gëzimi frymorët...»

— Ashtu ishte! — pëshpëriste plaku pranë buxhakut. Pëshpëriste nē mënyrë tē pavetëdijshme. Ndërsa flaka e zjarrit ngjitej lart e më lart.

Dhe vajza vazhdonte tē lexonte.

Dhe plaku vazhdonte tē dëgjonte.

«... E përpara depos së misrit bahet frigacak. Bahet servil, frigacak! Pse?...»

Plaku buzëqeshi me ironi.

Vajza vazhdonte me ndjenja:

«... Njashtu e do ligji, nëpunësi! Përndryshe s'ka misér. Si urdhnon, zotni!...»

— Si urdhnon, zotni! — pëshpëriti plaku padashje.

Vajza e pa me habi babagjyshin e saj dhe prap vazhdoi me duf:

«... Por ja hedh mallkimin e pamëshirshëm: — Mos i shkel, he tē shitoftë Zana!»

Plaku u trëmb. Kërcëu nē këmbë:

— Ku më paska pa? Ku më paska ndigjue? — foli dhe i rrëmbeu atë libër së mbesës.

Së mbesës në dorë i mbeti një fletë e grisur nga libri.

— Babagjysh, pse ma grise librin? Mos ma merr se më bërtet mësuesi!...»

— Atëhere humbëm burrninë për një kokërr misër, kurse sot... Ehu, — vazhdonte të fliste plaku dhe, pa u dhënë rëndësi fjalëve të mbesës, as fletës që kishte grisur padashur, e futi librin në gji. «Duhet të ma lexosh edhe një herë, edhe shumë herë...» — psherëtinte ai me ngashërim.

Fjalët e matura e plot dhimbje të plakut, e ajo fytyra e tij e dërrët i bëri mësuesit të gëzuar e krenerë. U vështruan sy më sy si t'i thoshin njeri tjetrit: «Pa shih, me librin që ja kemi dhënë kësaj nxënëseje jashtë klase kemi bërë diçka më tepër se sa mund të bënim me gojë!»

— Allahile, si keni qenë e si jeni, o burra! — u kujtua të pyeste përsëri plaku e thithi përsëri llullën e madhe prej shqope bërë siç duket nga duart e tij të plasaritura. Shtullunga tymi shpérndau nga goja e nga hunda...

Kësula prej mjergulle në majat e maleve të Kali-Bacit e të Thanës tanimë ishte çdukur. Hëna e plotë me yjet ndriçonin fshatin atë natë vjeshte.

## ËNDERRA TË PËRTËRIRA

— Na plasi kjo farmakologjia, Skënder!

— Si të gjithë që e kanë kaluar, edhe ne do ta kalojmë, o Bashkim.

— Po a mësohet në këtë ditë kaqë të bukur? Shikoje diellin sa i nxeh të që është, tamam ditë pér t'u larë.

— Unë po e heq këmishën.

— Edhe unë ashtu do të bëj, po ç'e do se, do të piqemi në diell pa u freskuar në këtë liqen kaq të qetë, që duket sikur të thotë: «Ç'rrini e mësoni kaq shumë, hajdeni edhe pak këtu, freskohuni, se ujët është shëndet!»

— Jepe një herë farmakologjinë e pastaj eja zhytu në liqen e pastroje tërë farmakun, që të është futur në tru. Por tashti fillojmë të mësojmë se koha po na ikën kot.

— Fillojmë!

Ditën e bukur e çfrytëzojnë vetëm çiftet e rinj, që vijnë e shëtisin nëpër gjelbërimin e këtij parku të madh, as çamarokët e vegjël të kopshteve, që vijnë e blegërijnë disa orë të mira të ditës në barin e lartë dhe të njomë; as familjet e ndryshme, që vijnë e pushojnë ditëve të pushimit, larg shtëpive të tyre, buzë liqenit artificial, nën freskinë e bukur të fidaneve të reja, që posa kanë ma-

rrë formën e një peme të vërtetë. Por vijnë edhe studentët vullnetmirë, që duan të çfrytëzojnë ajrin e pastër. Edhe këta dy të rinj kanë dalë që në pikë të mëngjezit, duke lënë atë furrikun e bibliotekës së heshtur, kanë vajtur larg, shumë larg, prapa liqenit artificial, në kodrat e Saukut, për të mësuar me zë, për të shijuar edhe rrezet e diellit, edhe gjelbërimin e pemëve, edhe ajrin e freskët dhe të pastër.

Këta dy të rinj janë shokë klase, posa kanë mbaruar mësimet e vitit të tretë të fakultetit të mjesësisë dhe kanë filluar provimet.

— Bashkim, ç'e humbe kështu, si Xhaferi simiten, pse s'e ke mëndjen këtu?

— Po çuditem me atë vajzën atje tej, që po afrohet e vetme buzë liqenit. Duket sikur kërkon njeri. Mos vallë na kërkon ne?

— Leri shakatë tani, të mbarojmë edhe këtë faqe e pastaj çlodhemi pak. Po deshe shkojmë deri në buzë të liqenit.

— Më duket se do të lahet. Shih si e heq trikon!

— Po t'i ketë marrë erë koka, kushedi! — ndodhin edhe gjëra të tilla.

— Shiko, shiko po futet në ujë, pa hequr këpucët. Fustani po i laget ajo s'e ngre fare me dorë. Po shkon thellë, më thellë! Ç'po bën ashtu? Mos po ndodh ndonjë gjë?

— Mos do të mbytet?

Për një çast të dy e humbën. Brofën në këmbë e, ashtu siç ishin në të mbathura, ia nisën vrapi.

Ajo, pa i vënë re, po vazhdonte të shkonte thellë e më thellë.

Me shpejtësi të madhe të dy dy djemtë u hodhën në ujë e ia nisën notit.

Ajo i pa. U zhyt për të mos dalë kurrë. Ata iu

afruan me not, u zhytën, e ngritën përpjetë. Ajo klithi!

— Largohuni! Mos më prekni me dorë! — goja iu mbush, u përpëlit pak dhe u përmbysh përsëri. Studentët e kapën me zor, njeri nga flokët, tjetri nga fustani e me vështirësi të madhe e nxorrën në breg. Ajo shpëtoi. Ishte e zalisur. Barkun e kishte të mbushur plot me ujë. Ata e vunë mbi gjunjët e tyre, e përmbyshen në shpinë, me kokën poshtë. Uji filloi t'i rrjedhë nga goja. Sytë nuk po i hapte, frymë nuk po merrte. E shtrinë mbi bar sa gjatë gjërë, i filluan frymëmarrjen artificiale. Nuk vonoi shumë, ajo hapi sytë.

— Shpejt, Bashkim, lajmëro në qytet!

— Është larg! — ngurroi një herë Bashkimi, po përsëri u nis.

— Më trego, pse deshe të mbytheshe?!

— Çfarë të të them?! — tha vajza dhe filloi të dridhej. Sigurisht që kishte të ftotë. Djali e kuptoi.

— Na, merr këmishën dhe xhaketën time, vishi! Shko prapa ferës dhe teri rrobat.

Vajza s'pranoi. U ngrit në këmbë, nuk mori as këmishën e as xhekëtën e djaloshit, por me të dy duart kapi jakat e fustanit dhe i çori me forcë. Gjoksi iu çgarganjesh. C'po ndodhë valle? Djali zgurdulloi sytë, u ngrit në këmbë e belbëzoi me vete i habitur:

— Ç'është ky veprim i kësaj vajze fatkeqe?

— Shikomë tashti! — tha ajo.

Oshëtima e fortë e një shuplakë u ndje tej e tej. Ajo ra në këmbët e djaloshit.

— Ti më shpëtove, pse më rreh tashti?

— Rregullohu shpejt!

Një heshtje e gjatë i tronditi të dy. Vajza e re sikur erdhi pak në vete. U kthyesh prapa menjë-

herë e u përpoq të mbulonte gjoksin me pëllëmbët e duarve. Djali me zor po e përmblidhte veten. Me kë kishte të bënte?

— Ku e ke shtëpinë?

— Në parajsë!

— Kujtova se në ferr!

— Në ferr jam tashti, prandaj dua të vete atje, në parajsë!

— Ç'bën kështu, ti s'je në vete! Si je katan-disur... kështu, ti një vajzë e mirë, e bukur, të flasësh në këtë mënyrë? Të duash të mbytesh?

— Ah, paske mëshirë ti për mua?!... Çudi! Paska mashkull të ketë mëshirë për mua?

— Nuk je në rregull, mblidhe veten! Pse je bërë kështu?

— S'të pëlqejet? Jam e keq? Pse më more? Pse më gënjeve?

— Cfarë po flet kështu?

— S'më do? Lëshomë atëhere!

— Skënder, ku jeni? — thirri Bashkimi.

— Kush?... Cfarë?... Po vijnë?... Kaq shpejt?... Shpejt të largohemi! Aman! Aman, të lutem shumë, të gjitha do t'i tregoj, po shpëtomë! Hajde të fshihemi!

Vajza nuk ishte në vete. Ajo kishte nevojë të domosdoshme për mjekun. Ai po mësonte për mjek, por ende nuk kishte arritur t'i dallonte simptomat e kësaj sëmundjeje. Ç'duhej të bënte? T'u nënshtrohej lutjeve të asaj vajze fatkeqe, apo t'i thërriste ndihmës së shpejtë. Atë po e kërkonin. Bashkimi po cirrej duke bërtitur. Duket që e kishte harruar vendin. Ç'të bënte? Duhej shpëtaruar njeriu! Prandaj, e shtyri atë me forcë dhe bërtiti:

— Hej, Bashkim! Hajdeni këtu, ja ku jemi!

\* \* \*

Ditët po rrokulliseshin. Nga provimet studentët tanë shpëtuan. Kishin edhe një muaj praktikë. Bashkimi do ta bënte në qytetin K, ndërsa Skënderi këtu në Tiranë, në spitalin nr. 1 Kështu që Skënderi shkonte e shihte pothuajse përdita të sëmurën në pavionin e nevrologjisë, atje ku ishte shtruar. Ishte në një dhomë të vogël, e vetme, krejt e vetme.

Një javë të tërë ajo qëndroi në kllapi të plotë. Nuk e përbante dot veten. Nuk njihte asnjeri. Kishte harruar çdo gjë. Por më vonë filloi të kujtonte si në të dhërr skena të errëta. Por shpëtimtarët e saj ende nuk i kujtonte dot. Shumë shokë e shoqë erdhën dhe e vizituan. Madje një djali i ri, pak i zverdhur, i vinte pothuaj se përdita. Por ajo ende nuk ishte në vete. Nuk e njihte.

Një ditë prej ditësh, Skënderi, posa mbaroi praktikën, i vajti në dhomë. Ajo po flinte. Ai djalili, që vinte gjithmonë, ishte ulur pranë krevatit të saj e po e shikonte i menduar. Sa hyri Skënderi, ai menjëherë u ngrit në këmbë, pasi kujtonte se mos ky ishte mjeku. Pas një heshtjeje të shkurtër, Skënderi e pyeti:

— Çfarë e kini këtë?

Djali për një çast ngurroi, e mblodhi pak veten dhe shtoi:

— Motër e kam! — A do të shpëtojë?

— Besoj se e kaloi rrezikun, — u përgjegj Skënderi.

Ata sytë e fjetur të vajzës dalëngadalë po fillonin të lëviznin; fytyra e saj e zbetë, që posa kish

filluar tē skuqej, po fillonte tē gjallérohej; ata flokët e zeza e tē shpupurisura mbi jestëkun e bardhë sikur filluan tē lëviznin, qerpikët iu përpëliten. Ajo hapi sytë. Një drithmë e menjëherëshme i kaloi nëpër trup. Dy damarë tē fortë iu mavijosën në qafë. Vetullat e holla e tē zeza sterë iu ngrysën. Pulsi filloi t'i rrahë me tē fortë. Nofullat e saja lëvizën. Një zë i fortë kumbues oshëtiu në atë dhomë tē vogël e plot dritë.

— Shporru këtej! Ik! Mos t'i pafsha më kurë sytë! — filloj tē çirrej ajo.

Një drithmë tē madhe ndjenë tē dy tē rinjtë. Skënderi sikur kuptoi diçka tē paqartë.



Doktori i saj, një burrë mesatar e i shëndoshë, me flokë tē pakta, tē drejta e tē zeza, tē ngjitura pas kokës, me atë fytyrë kuqalashe e tē rrumbullakët, e me atë zërin e tij karakteristik si tē gruas, ia ndaloj vizitat pér çdo njeri. Vetëm Skënderin, si student tē tij, e lejonte tē vinte e ta shihte vazhdimesht. Ndërsa djaloshi i ri, çdo pasdreke priste me ankth përgjigjet e padëshëruara tek dera e spitalit. Madje një grua e vjetër nga mosha, me një fytyrë topolake e tē mavijosur, me rrudha tē shumta e me sy tē përlotur priste, e pështetur pas hekurave tē derës së madhe tē spitalit, doktorin, që e pyeste pér tē sëmurën. Edhe një vajzë e re u përpoq ta takonte një herë tē sëmurën, por mundimi i vajti kot, se doktori na qënkish i lig.

Sa hynte Skënderi brenda, (tashti me tē ishte njohur mirë) ajo tregohej e dashur, e qeshur, sha-

kaxheshë; po kur ikte ai, atë sikur e brente diçka përbrenda. I ziente një duf i papërmabjatur dhe desh t'i hapej një shoku, t'i qante hallin, por e keqja ishte se nuk i besonte as vetes.

Një ditë javë, posa mbaroi praktikën, Skënderi u vërsul me të shpejtë në dhomën e saj. E gjeti të ulur në krevat, duke krehur flokët e gjata e të zeza, me një krëhër të madh e të bardhë. Së hyri Skënderi, ajo i hodhi prapa qafës flokët e shpupurisura dhe kërceu në këmbë e gëzuar. Fytyra i kishte marrë një nur të qeshur, gjoksi i hidhej përpjetë. Përpara Skënderit qëndronte një peri e vërtetë e veshur me një rrobdëshambër të zakonshëm, por që i ishte ngjitur kaqë shumë, sa që i jepte formën e vërtet të trupit me atë belin e saj shumë të hollë. Buzët e saj të kuqe prej natyre lëvizën me shkathësi:

— Skënder, e muart vesh që nesër do të dal nga spitali?

— Po, po, më tha doktori qëpari, kur hyra në praktikë.

— Sa e lumtur që jam sot! Nuk e di se ç'më ka hipur një gëzim i çfrenuar. Kam qejf të dal e të bredh, të bredh lart e poshtë, të bëhem edhe një herë çilimi ashtu si isha dikur. Të luaj me litar, me kuklla, me top, të grindem me shoqet e mijë të vogla. E çfarë s'kam qejf të bëj?

— Tani u shërove krejt, prandaj i kërkon të gjitha këto.

— Po ju doktorët këtë zanat keni, që të shëroni njerëzit e sëmurë.

— Vërtet, ashtu është. Ndjen një gëzim të spjegueshëm kur e sheh të sëmurin tënd të ngrihet, të shërohet, kur e sheh të gëzuar.

— Po ju, Skënder, a u gëzuat për mua që do të dal nesër?

— ... Po... edhe... jo!

— Sii, po edhe jo?

— Po, se u shëruat. Ndërsa jo, sepse ende ju nuk më besoni mua.

Ajo ftyra e qeshur e vajzës, sikur u pre pak; sytë e saj të bukur me ata qerpikët e gjatë dhe të rrallë, sikur iu errësan pak: i ra një çehre e kuqe. Buzët e njoma i lëvizte si me turp.

— Vërtet, Skënder, ashtu është! Unë nuk i kam besuar njeriut, e ndoshta ky është një gabim i madh për mua. Ju, Skënder, më jeni gjetur kaq shumë në këto ditë të vështira të jetës sime, më jeni gjetur më shumë se vëlla, më shumë se shok dhe më shumë se prind. Unë nuk shpresoja që të kishte njerëz kaq të mirë sa ju dhe e kuptoj tashti që nuk mendoja drejtë dhe ndoshta ky ka qenë shkaku i krizave të njëpasnjëshme nervore që më kanë zënë. Unë do t'jua hap zemrën juve, pikërisht si një mjeku të ardhëshëm, si një të riu që e ka jetën përpëra, si një njeriu që me sjelljen e tij fisnike, me optimizmin e madh që ka ndaj qëllimeve të tij, më dha edhe mua krahë për të fluturuar, m'i përtériu përsëri èndërrat e mia:

\*

\*

\*

«— E desha dhe e dua. Nuk di, tashti që do të jetoj, a do ta dua apo jo. Kjo s'ka rëndësi. Bashkë ishim në shkollë të mesme. Atje u dashruam. Atje provova dashurinë që èndërrroja. Desha atë djale që më pëlqente. E desha shumë, më

donte shumë. Së paku kështu më thoshte e kështu më dukej mua. Sa e lumtur që isha atë natë, kur ai më shtrëngoi në krahët e tij! E ku thua ti? Në shkallët e errëta të apartamentit tim, kur po më përcillte një natë nga kinemaja. Ç'gjëra të bukurë ëndërrova atë natë! Ëndërrova ëndërrat e një vashëze të re. Sa e lumtur që isha atëhere!

— Më kërko në shtëpi, hajt të fejohemi! — i thosha gjithmonë. Por ai nuk pranonte.

— Jemi akoma të vegjël, të mbarojmë një herë shkollën, pastaj shohim për më tutje. Mjafton që ti më do dhe unë të dua, prandaj s'kanë rëndësi formalitetet familjare! — Kështu ma mbushte mëndjen. E atëhere, të lumtur, hidheshim në krahët e njeri tjegrit. Një herë ai më tha:

— Lili, sa më pëlqen të të shoh gjithnjë të veshur, me fustan nejloni, me këpucë të bardha e me taka të larta, me triko prej leshi deve!...

Unë u preka. Nuk e di se si, më erdhi rëndë. Ai duke e ditur gjëndjen time, me të ardhurat e një studenteje, si mendonte të vishesha aq mirë? Pastaj ai shikoka pasurinë, e jo njerinë! — Kështu arësyetova në atë çast. Atë natë u zumë. I fola rëndë. Një javë ndejtëm pa folur, pastaj folëm, po sikur më dukej më i ftohtë. Fatkeqësia më e madhe nuk qëndronte këtu, po gjetkë, se atë ma rrëmbeu shoqja ime më e ngushtë, Shega! Ajo, së cilës i kisha hapur tërë zemrën time; ajo që krenohej se kishte një shoqëri të tillë, kaq të mirë si ne të dy. Me lëvizje lozonjare, me bukurinë e saj, me shkathësinë që kishte, Shega ma rrëmbeu atë, Yllin. Unë nuk dija gjë. As edhe që më shkonte ndër mend një gjë e tillë.

Prindërit e mi e morën vesh dashurinë time

me Yllin. Për çudi, ai djalë nuk u pëlqeu atyre. Më thanë të hiqja dorë, unë nuk desha. Më dhanë një burrë tjetër më të «pjekur», unë nuk e pranova. Më shanë, më rrahën, por unë nuk hoqa dorë nga mendimi im. Atëhere prindërit vendosën që të më lagonin nga shkolla, pastaj edhe nga Tirana e të më çonin në Shkodër, që të jetoja tek kushërinjtë e mi. Nga kjo u detyrova që të ikja nga shtëpia dhe të jetoja në konvikt.

Edhe tek ajo, Shega, kisha besimin më të madh. Atëhere prindrit nuk deshën të më shihnin me sy për këtë turp të madh që bëra. Nga ajo vajzë e qeshur dhe çapkëne që isha, fillova të bëhem se-rioze. Vetëm atyre ua qava hallin. Ajo, Shega, shoqja ime më e ngushtë më shau rëndë, dhe sikur filloi të largohet, por për atë gjëmë as që më shkonte ndonjëherë në mënd. Ndërsa ai më premtonte se sa të mbaronim shkollën, do të mar-toheshim. Megjithëse kisha besim të madh tek ai, përsëri ndjeja një frikë të paspjegueshme. Dhe një ditë mora mandatën: shoqes sime më të ngushtë i kishte plasur bomba në dorë. Ajo kishte mbetur me barrë me dashnorin tim. S'kishte gjëmë më të madhe për mua. U bëra si e marrë. Nuk dija si të veproja. Kujt t'ia qaja hallin? Prindërit më urrenin kaq shumë, sa që nuk donin të më shihnin me sy. Se i turpërova. Atë, dashnorin tim, ma rrëmbyen, e kush? Shoqja ime më e ngushtë! Kujt t'ia qaja hallin? Prindërvë që nuk më donin, apo shoqeve që nuk u besoja? S'dija ç'të bëja, kisha filluar t'i ureja të gjithë. Nuk desha të shihja njeri përpara meje.

Një ditë ai erdhi për t'u rrëfyer. Isha kaq e nevrikosur, sa që nuk doja ta shihja me sy. E humba lumturinë time. E përzura me të thirrura

të tmerrshme! E shava shumë rëndë! E qëllova shumë keq!

— Shko merre atë, se do të bëhesh baba së shpejti! — i thashë.

— Ty të dua, tjetër nuk marr! — më tha.

— Ç'faj ka fëmija? Apo ai është fruti i epsheve të dashnorit tim hipokrit e të shoqes sime xhe-loze?! — Largoju! Shporru këtej! Mos t'i pafsha më sytë!

Ai u largua nga dhoma e konviktit ku rrija unë. Isha e vetme dhe pikërisht atëhere pësova krizën e parë nervore. U bëra si e çmëndur, fillova të qaja me të madhe, qava aq shumë, sa që kur erdhën shoqet e mia, më gjetën të zalisur. Megjithë lutjet e tyre, unë nuk u tregova asgjë.

Pas një javë, erdhi ajo. Nuk ishte më ajo e para, ajo çapkëne e bukur, e qeshur, me ato gërshtat e saj të gjata. Nuk ishte më ajo shoqja ime e parë, ajo bjondina e shkathët me ata sytë e saj të kaltër, por... ishte një njeri tjetër, me fytyrë shumë të zbetë, me sy të përlotur, sa që me ta parë, më erdhi shumë keq. Sa më pa, m'u hodh në qafë dhe filloi të qajë me ngashërim.

Nuk dija ç'të bëja. Si të veproja! Në fillim e ureja pa masë. Tashti më vinte keq. Edhe ajo ishte një viktimi si unë, ndoshta ajo vuante më shumë.

— Pse qan përpara meje? Ti bëre gabim, jo se deshe, por se të gënjeu ai maskaraj, ai i poshtëri. Ai na gënjeu të dyjave! Aman, të lutem, mos qaj përpara meje! — e u shkrimë në vaj.

— Jo, jo ai nuk më gënjeu. Ai nuk donte! Unë e kam fajin! Unë, që mos qofsha kurrë, unë ju shkatërrova të dyve. Unë mundohesha që ta bëja

për vete! «Vallë a i kisha ato aftësi, që ta gllabëroja atë djalë!» — dhe ndodhi ajo që ndodhi.

— Domethënë ai s'ka faj!

— Unë, që i pësova të gjitha këto fatkeqësira, të lutem ma fal, mos ma merr babanë e foshnjës së ardhëshme.

Një perde e turbullt më doli përpara syve, një rrënqethje më pushtoi të térën: ajo dhëmshuri që më erdhi pak më parë, filloi të më kthehet në një urrejtje përbuzëse:

— Domethënë ti paske ardhur të më kërkosh me lajka babanë e foshnjës së ardhëshme. Mos vallë unë ta rëmbeva atë? Ik... ik... ik menjëherë!

— dhe ajo iku.

Megjithëse e shava Shegën, përsëri më vinte keq për fatkeqësinë e saj si një femër dhe më tepër më vinte keq për atë vogëlushin e mjerë. Si të veproja? Dhe menjëherë e gjeta zgjidhjen, atë zgjidhje që ma ndaluat ju me Bashkimin!»

— Pse, kë do të kënaqje me mbytjen tënde mizore?

— Nuk e ke provuar dashurinë.

— Atëhere mëso të rrosh edhe kur jëta ka vësh-tirësi që të duken të pakapërxyeshme.

— S'janë fjalët e tua!

— Janë fjalët e atij, që edhe në ato kondita të vështira, pa sy e pa duar, dijti të jetojë. Ndërsa ti që ke sy e duar, që ke shkollë e punë nuk ditë jetosh?

— I kisha të gjitha, po njeri që të më përkrahte s'kisha.

— Familjes ja qave hallin, ajo s'të kuptoi, po shoqërisë ia qave hallin? — jo!

\* \* \*

Dielli posa ka mbuluar edhe majat më të larta të Dajtit. Një freski e hollë përkëdhel fletët e gjelbra të pemëve. Një mugëtirë e bardhë e mbulon Tiranën. Njerëzit fillojnë të gumëzhijnë. Para pak kohësh ishte vapë, kishte qetësi. Tani është freskët, ka zhurmë. Llambat e neonit zëvëndësojnë rrezet e diellit. Qyteti është në lëvizje.

— Skënder, ti je?

— U Lili! — po ku humbe kështu? Sa paske ndryshuar! Paskeni edhe fëmijë, sa i bukur që është!

Dy shokë të vjetër takohen rastësisht pas disa vjetësh në bulevardin e madh të Tiranës, nën dritën e llambave të neonit.

Pas shumë muhabetesh të ngrohta dhe pas shumë shakarash me çamarokun e vogël, që të tre vajtën në lulishten e Parkut të Rinisë dhe u ulën në një tavolinë. Pasi porositën ato që deshën për të ngrënë, Skënderi e pyeti Lili:

— Lili, unë jam kureshtar të di ngjarjen tuaj të mëvonëshme dhe besoj se ju nuk do të ndruheni, ashtu siç u ndrojtët në spital.

Lili qeshi dhe shtoi:

— Atëhere isha kalama nga mendja, ndërsa tashi ti sikur jam më e pjekur, se kam edhe Benin, apo jo?

Qeshën të dy bashkë. Ndërsa Beni po merrej me një pastë që ia kishte bërë buzët tërë krem.

«— Atëhere, kur dola nga spitali, shokët e mi po jepnin provimet e fundit të fakultetit gjuhëletërsi, — filloi të më tregojë Lili. — U largova

nga ju me një besim të patundur në veten time dhe iu drejtova dekanatit. Ata më ndihmuani shumë. Më dhanë një plan individual për të dhënë provimet. Pikërisht në këtë kohë, organizata e rinisë së fakultetit organizoi një mbledhje me temën: «Si duhet t'i përballojmë vështirësitë e papritura!» Mbledhja u bë vetëm me shokët e kursit tim. Kishte ardhur edhe një i deleguar nga komiteti i rinisë së qytetit.

Pas fjalës së sekretarit të rinisë, e mora fjalën unë. Shokët më dëgjonin me vëmëndje të madhe. Unë fola me kartra të hapura. Tregova gjithshka që më kishte ndodhur dhe gjeta atë që më premtuat ju. Gjeta dashurinë e shokëve. Gjeta përkrahjen morale të tyre. Të gjithë më ndihmuani me fjalët më të mira. Madje, më vonë, disa erdhën e mësuan bashkë me mua, për të më ndihmuar në provimet, se kisha mbetur prapa.

Mbledhja i dënoi ata të dy. Por, megjithatë, edhe mua më kritikuani shumë rreptë për gjestin që desha të bëja. Përkundrazi, në një fatkeqësi të tillë unë nuk duhej të bëja atë që mendova, por të mbaja lart personalitetin tim si fémër.

Pasi mbarova provimet, mora diplomën. Ky ishte gëzimi im më i madh, pas asaj furtune të fortë që më zuri. Dëshira ime u pranua. Më emëruan si pedagoge të letërsisë në qytetin X. Atje gjeta shokun e jetës, që dijti të më kuptojë mjaft mirë dhe bashkë krijuam këtë krijesë, gugushin tonë. Shikojeni sa i bukur që është! Sa mirë që flet! Pëllumbi im i vogël! Tek të gjithë vete, nuk ka frikë nga asnjeri. Të gjithë i do.

## POSTJERI I LAGJES SONË

E njihni xha Lilon, është postjeri i lagjes sonë. Është burrë i vjetër. Së shpejti del në pension. Por në të ecur nuk tregon i vjetër. Ecën më shpejtë se një i ri. Është i shkurtër dhe me çantën e madhe e të fryrë nga letrat, që ka varur në qafë, duket pak si komik, — por atij s'i bën përshtypje! As njerëzve të lagjes sonë nuk i bën përshtypje, pasi janë mësuar me të, edhe ai është i mësuar me ta. Ndonjë çilimi është munduar ndonjëherë ta vejë në lojë, sidomos kur hedh këmbët e tij të vogla të futura në ato këpucët e mëdha e me qafa, por kjo ka zgjatur vetëm një cast, sepse dashje pa dashje postjeri ynë është futur edhe në shtëpinë e atij çilimi...

Do të thoni ju sejeta e postjerit, puna e postjerit është monotone; se ai merr letrat nga posta, i ndan sipas rrugëve dhe shtëpive, i bën stivë dhe i shpërndan familje më familje, po kështu bën edhe të nesërmen, i merr letrat nga posta, i ndan sipas rrugëve dhe shtëpive dhe i shpërndan familje më familje. Dhe kjo jo një e dy ditë, një e dy muaj, por tërë jetën, — pra në dukje kjo është një punë monotone, por në fakt...

\* \* \*

I numëronte dhe lexonte me radhë adresat e secilit zarf.


- Kjo éshtë e Askeriut,
- Kjo éshtë e Zylyfit,
- Sulejmanit, këtij gjithnjë i vijnë letra.
- Zylyfit, shih dy letra i paskan ardhur këtij! — dhe i vuri pranë njera tjetrës.
- Novruzit.. .
- Qaniut, ky e ka shtëpinë në fund të lagjes,
- e nxori më një anë për ta vënë të fundit... .
- Hatixhesë, po, po Hatixhesë, tashti jam i qetë, nuk do të kaloj me frikë nga shtëpia e saj; ja sot do t'i shpie letër nga i biri — dhe lexon adresën e dërguesit, — po, po i biri éshtë, qerataj, me zor i dërgon një letër në gjashtë muaj, ndërsa Hatixheja përdita pret letër nga ai, dhe qan pastaj, po, ka të drejtë, ajo éshtë nënë.

Ja edhe Kristaqit i ka ardhur, ta shoh, po, po, nga i vëllaj, e kishte të sëmurë. Kushedi se si e ka tani. Me siguri më mirë! Duket, që ka dalë nga spitali.

Dhe vazhdon të numërojë, t'i ndajë letrat simbas lagjeve, rrugëve, numërave të banesave. I mbështjell me ngadalë, i fut në çantën e madhe dhe niset.

Ecën ashtu, me çantën e fryrë në krahë, dhe me çapin e tij të shpejtë troket në çdo derë, herë këtu e herë atje.

- Tungjatjeta, xha Lilo, kemi ndonjë letër?
- Sot jo, nesër patjetër do të të sjell!
- Ka ndonjë Thanasi?



«Postjeri i lagjes sonë».

- Po, po, ka, cila je ti, e bija?!
- Po, xhaxhi!
- Urdhéro e merre!
- Faleminderit, xhaxhi! — zgjat dorën dhe merr letrën. E rrrotullon nëpër duar për të parë se nga i vjen — ndërsa xha Liloja largohet me të shpejtë, si i lehtësuar nga fjala e ngrohtë e asaj fëmije të vogël.

«Po Xakut, s'e vura re, i ka ardhur letër apo jo? Jo, s'i ka ardhur! Po unë ç'ti them atij, ka merakun e djalit, — e ka fejuar, — po se ç'u ka hipur një grindje dhe... ajo vajza, sikur nguron... nuk do të vejë në atë fshat ku punon i biri. Pret se mos ai bén transferimin. Më vjen keq për Xakun. Është burrë i mirë. E ka shumë me qejf këtë vajzë... Por, ç'ti bësh një vajze të përkëdhelur?... Unë, që e njoh mirë atë djalë, e di se ç'është ai... Po... kur të vijnë mëntë... Ç'ti bëj Xakut...»

— Kjo është shtëpia e Vangjelisë. Edhe kjo s'ka letër sot. E ka vajzën në aksion. Ka fëmijë shumë të edukuar. E shkreta! Pret çdo javë letër. Del e më pret te porta. Është e ve. I shoqi i është vrarë në krye të detyrës. Edhe ajo di ta mbajë mirë veten. Fëmijën e mban shumë mirë. Of, harrova fare, dje i solla kësaj letër. Vajza i shkruante shumë mirë nga aksioni. Më dha edhe raki. Sa m'u lut e shkreta për të më bërë një kafe... Harrova fare që kishte letër dje. E humbasim mëndjen ne të vjetrit.

Shikon letrën që ka në dorë: «Kjo është e Dhoksisë». Sikur e njohu nga shkrimi, pa e parë adresën e dërguesit: «Ja dërgon Fährmani nga Berati». Kanë dy vjet që jetojnë larg njeri tjetrit. Buda-

llaçkë kjo, që s'vete atje. Nuk e kuptoj q'i pël-qen këtij qyteti, kur s'e ka burrin me vete. Shko atje, o t'u mbylltë, edhe në majë të shkëmbit po të jesh me burrin, je shumë mirë. Bën q'bën dhe më vete në komitet, vete andej e vetë këndeja, për transferim. — Ka ca gra që vuajnë nga mëntë. ... Kanë hak. S'kanë parë se si kemi jetuar ne. i paskan siguruar atje edhe apartamentin dhe më rri këtu me një dhomë qorre... Hej, vuajnë njerëzit për kokë!»

Shpërndan një letër këtu, një letër aty.

— Falemnderit, xhaxhi! — i thotë njeri.

— Falemnderit, xha Lilo! — i thotë tjetri.

— Urdhëroni një cigare!

— Urdhëroni brenda të pimë nga një raki!

— Të të bëjmë një kafe, xha Lilo!

Dhe xha Liloja kënaqet në shpirt për fjalët e ngrohta të këtyre njerëzve.

Dhe vazhdon të shpërndajë letrat.

«Paska letër edhe Mendushi!» Ky gjithnjë rri i ngrysur, s'i flitet me gojë fare. Kur të shikon të akuzon, sikur ta kem fajin unë, që s'i dërgojnë letra. — dhe ja zgjat zarin me dorën e tij të vogël.

Mendushi e shikon nga lart poshtë. Buzëqesh nën dhëmbë, merr letrën me të shpejtë dhe, pa thënë asnjë fjalë, zhdukët brenda në dhomë. Xha Liloja u mërzit shumë. Ai vërtet e ka për detyrë të shpërndajë letrat, por... Ai është i vjetër në moshë dhe kërkon nga njerëzit fjalë të mira. I bëhet qejfi që njerëzit e lagjes së tij, ku ai shërbën, të jenë të mirë.

— Ta marrë djalli ku më doli Rroku përpara!

— Hajde, bujrum, bujrum në shtëpi. Sot më

dukesh i qeshur; më ke sjellë letër nga djali?...

— Po, po!

— Hajde të pimë një kafe!

— Falemnderit, kam punë, shikoje, çantën e kam plot,

— Mor, po hajde brenda, se punët nuk mba-rojnë kurrë, — dhe e rrëmbeu me zor brenda.

— Nga djali ma ke sjellë letrën-ë?

— Po, po, nga ushtria.

— Sebije, bëna shpejt nga një kafe, se do të shkojë Liloja. Çile, ma lexo shpejt letrën, se nuk më durohet... Ti, Lilo, mos u mërzit, ja sa ta dëgjoj pak letrën...

«I dashur baba!» — lexon vajza. Liloja i zënë ngushtë rri në gjëmba. Rri dhe dëgjon. Do që të iki, po nuk mund, se ia di huqet Rrokut, sidomos kur i vinë letra nga i biri...

«Mëso, baba, se sot bëmë qitje dhe unë dola shkëlqyeshëm. Me të tre fishekët godita në shenjë...»

— Bravo, djalë i babës, — bërtiti Rroku. E solle kafenë, moj? Kam djalë, jo shaka. Më ndroi. Edhe unë kur isha si ai, qëllaja në shenjë. Edhe tashti po të jetë nevoja...

Xha Liloja e shihte me vërejtje Rrokun dhe gëzohej që i kishte sjellë një letër të mirë, që i biri e kishte nderuar. Pasi piu kafenë, u ngrit.

— Jo, do të rrish për drekë.

— Tashti e tepërove, Rrok, kam shumë punë.

U ngrit, hapi me të shpejtë derën dhe hodhi këmbët futur në këpucët e mëdha në shkallët e vogla të asaj shtëpie përdhese.

— Atëhere, kur të dalësh në pension, do të mbaj për drekë! — tha Rroku me të madhe

— Aha, unë nuk dal kurrë në pension! — ktheu kokën, buzëqeshi me atë fytyrën e tij të vogël. Pastaj, pa brënda në çantë. Nxori një pako tjetër me letra. E qmbështolli. «Këto vijnë të gjitha nga kombinati Mao Ce Dun, janë vajzat që kanë vajtur atje, si vullnetare!» I qmbështolli letrat dhe filloi të këndoje me zë të ulët.

*Lajme t'bukra, sa të doni  
Tufa-tufa do t'ju sjell,  
Pa përtim unë shkoj kudo,  
Shpërndaj letra me shpejtësi  
Posta... Posta, shoqe!*

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqja
Një lapidar pranë piramidës .....	3
Shpëtimtarët .....	11
Ushtar Semani .....	27
Merrmëni dhe mua .....	37
Plaka Nushë .....	42
Unë jam e lirë .....	60
Cuca e pavionit .....	71
Në orën e hartimit .....	84
Ditëlindja e Dëshpërimes .....	92
«Burrneshë e nanës!» .....	103
Gjyshi dhe nipi .....	109
Ku më paska pa? .....	115
Endërra të përtërira .....	120
Postjeri i lagjes sonë .....	134

*53177*